

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Korrik 2022/ Nr. 7

28-30 QERSHOR 2022
Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori
pjesë në Samitin e NATO-s në Madrid



Përmbajtja

Numri 7

TAKIMI

- 10** Ministri Peleshi: Projekti i ri i Porto Romanos do të ofrojë infrastrukturë të dedikuar ushtarake për FA-të dhe NATO-n

INTERVISTË ME KOLONELE SALLAKUN

- 22** Familjet ushtarake, histori suksesi dhe sakrifice

ADNAN QATIPI

- 28** Antifashisti i orëve të para, komandant i Armës së Tankeve dhe udhëheqës i shquar i Organizatës së Veteranëve të LANC-it

SHKENCË

- 44** Kontributi shqiptar në panteonin e vlerave botërore

PORTRET

- 50** Nikolin Pici, gjurmë në fotografinë ushtarake shqiptare

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 SAMITI I MADRIDIT

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s në Madrid

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s, që u zhvillua këto dy ditë në Madrid, Spanjë, si pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga kryeministri Edi Rama...



6 BAJRAM BEGAJ ZGJIDHET PRESIDENT

Nga 24 korriku, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

Ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm zgjidhet President i Republikës së Shqipërisë dhe nga 24 korriku, Komandant i Forcave të Armatosura...



8 NGA 1 KORRIKU RRITEN ME 30 % PAGAT

Ministri Peleshi: Rritje historike e pagës së ushtarakëve, mirënjohës kryeministrit Edi Rama për vlerësimin e FA-së

Nisur nga data 1 korrik i gjithë personeli ushtarak i Forcave të Armatosura do të marrë një rritje page prej 30%. Lajmi u bë i ditur në një konferencë për mediat nga ministri...



28 Intervistë me gjeneral brigade Editson Zarka

E drejta e informimit dhe sigurisë kombëtare në optikën e transparencës së publikut

Gjeneral brigade Editson Zarka përfundoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", dhe më tej në Akademinë Ushtarake...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 7/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

**Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:**

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





SAMITI I MADRIDIT, 28-30 QERSHOR 2022

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s në Madrid

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në Samitin e NATO-s, që u zhvillua këto dy ditë në Madrid, Spanjë, si pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga kryeministri Edi Rama. Mbajtja e këtij Samiti 3 - ditor u vlerësua si një moment historik, për vendimet mjaft të rëndësishme që u morën për orientimin e kursit të sigurisë dhe mbrojtjes në një situatë delikate sigurie, ku Rusia dhe Kina vijojnë të sfidojnë rendin botëror të bazuar në rregullat ndërkombëtare.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili vlerësohet si një rajon me rëndësi strategjike për Aleancën. Në këtë Samit u theksua fakti





se vendet e tij që aspirojnë për anëtarësim në strukturat euro-atlantike, do të kenë mbështetjen nga Aleanca. Presidenti i SHBA-ve, Joe Biden dhe sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Jens Stoltenberg vlerësuan veçanërisht rolin e Shqipërisë si aleate e NATO-s.

Qeveria shqiptare shprehu vlerësimin e saj për marrëveshjen e arritur mes Suedisë, Finlandës dhe Turqisë, që i hap rrugë anëtarësimi të dy vendeve nordike në NATO. Kryeministri Edi Rama propozoi nga ana e tij që Kosova të ftohet menjëherë në mekanizmin e Partneritetit për Paqe, duke kërkuar nga vendet që



Një vëmendje e veçantë iu kushtua rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili vlerësohet si një rajon me rëndësi strategjike për Aleancën. Në këtë Samit u theksua fakti se vendet e tij që aspirojnë për anëtarësim në strukturat euroatlantike, do të kenë mbështetjen nga Aleanca.

Presidenti i SHBA-ve, Joe Biden dhe sekretari i Përgjithshëm i Aleancës Jens Stoltenberg vlerësuan veçanërisht rolin e Shqipërisë si aleate e NATO-s.

nuk e kanë njohur të vlerësojnë qëndrimin e tyre.

Kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të NATO-s miratuan Konceptin e ri Strategjik të Aleancës, duke përcaktuar prioritetet kryesore dhe qasjet për adresimin e sfidave për dekadën e ardhshme. Ndryshe

nga Koncepti Strategjik i vitit 2010, i cili e cilësonte Rusinë si "partner strategjik", koncepti i ri e paraqet atë si "rreziku më i madh i drejtpërdrejtë i Aleancës", ndërsa Kinën si një vend në rritje dhe me politika ambicioze për të sfiduar interesat dhe sigurinë e Aleancës.





sh-shef i Shtabit të Përgjithshëm zgjidhet President i Republikës së Shqipërisë dhe nga 24 korriku, Komandant i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Bajram Begaj,

leadershipi vizionar nën drejtimin e të cilit u realizuan transformime në strukturat e FA-së, drejt arritjes së përsosmërisë së sistemit akademik ushtarak, modernizimit të infrastrukturës në sisteme dhe pajisje, me një karrierë të gjerë ushtarake dhe jo vetëm.

Për audiencën e gjerë kush është z. Bajram Begaj?

Gjeneralmajor Bajram Begaj ka lindur më 20 mars 1967, në Rogozhinë. Në vitin 1989, gjeneralmajor Begaj ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, Dega Mjekësi e Përgjithshme dhe është titulluar oficer aktiv në specialitetin "Mjekësi" në vitin 1998.

Përpara se të merrte detyrën e shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, për një periudhë trevjeçare ka shërbyer në detyrën e komandantit të Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes.

Begaj, i cili ka një karrierë më shumë se 30-vjeçare në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, prej vitit 2020 shërben në rolin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Më parë ai ka shërbyer në disa poste të rëndësishme si Komandant i Komandës së Stërvitjes dhe Doktrinės. Gjatë karrierës së tij ushtarake, gjeneralmajor Bajram Begaj ka shërbyer në pozicione të ndryshme drejtuese në Forcat e Armatosura, si: zëvendës drejtor i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"; drejtor i Përgjithshëm i Spitalit Ushtarak Qendror Universitar; drejtor i Inspektoratit Shëndetësor, kryeinspektor dhe këshilltar i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së; shef i Njesisë Mjekësore Ushtarake dhe zëvendës drejtor i Spitalit Universitar të Traumës, si

Peleshi: I bindur se në krye të shtetit kemi zgjedhur një njeri me vlera qytetare, që do të dijë të mbrojë Kushtetutën dhe ligjin

Me rastin e zgjedhjes së z. Bajram Begaj në postin e presidentit të Republikës së Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi do t'i dërgonte një mesazh urimi ku mes të tjerash do shprehte për zemërsisht bashkëpunimin e tyre.

"Urime të përzierme Bajram Begajt në detyrën më të lartë, si President i Republikës së Shqipërisë. Pata kënaqësinë të punoja me gjeneralmajor Begajn si shef i Shtabit të Forcave të Armatosura dhe jam besimplotë që atë bashkëpunim të mirë do të vazhdojmë ta kemi edhe si President dhe Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. I bindur se në krye të shtetit kemi zgjedhur një njeri me vlera qytetare, që do të dijë të mbrojë Kushtetutën dhe ligjin. Suksese Presidentit të ri të vendit!

Bajram Begaj zgjidhet president
i 9-të i Republikës së Shqipërisë

Nga 24 korriku, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura



dhe detyra të tjera në strukturat e Forcave të Armatosura.

Gjeneralmajor Begaj ka ndjekur kualifikime dhe specializime të ndryshme në fushën ushtarake dhe atë mjekësore, në institucionet arsimore brenda dhe jashtë vendit. Ai



ka përfunduar Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, Shkollën e Thelluar Pasuniversitare të Mjekësisë dhe specializimin pasuniversitar në profilin Gastrohepatologji, pranë Fakultetit të Mjekësisë Tiranë.

Gjithashtu ka ndjekur kursin e menaxhimit spitalor dhe kursin e lidershipit mjekësor strategjik, në SHBA, Kursin e Lartë Ndërkombëtar të Menaxhimit të Mbrojtjes, pranë Institutit të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes në Shkollën Pasuniversitare të Marinës në SHBA, Seminarin e Lartë Ekzekutiv pranë Qendrës Marshall, Gjermani, si dhe kurse e kualifikime të tjera ushtarake.

Gjeneralmajor Bajram Begaj, ka përfunduar "Doktoratën në Fushën e Mjekësisë", pranë Fakultetit të Mjekësisë si dhe mban titullin "Profesor i Asociuar" në Mjekësi. Njëkohësisht është vlerësuar me medalje të ndryshme për arritje gjatë karrierës së tij ushtarake.



Ministri Peleshi: Rritje historike e pagës së ushtarakëve, mirënjohës kryeministrit Edi Rama për vlerësimin e FA-së



NGA 1 KORRIKU RRITEN ME 30 % PAGAT E USHTARAKËVE



Nisur nga data 1 korrik i gjithë personeli ushtarak i Forcave të Armatosura do të marrë një rritje page prej 30%. Lajmi u bë i ditur në një konferencë për mediat nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave.

“Sot kemi bërë rritjen historike të pagës dhe unë për këtë jam shumë krenar. Jam shumë mirënjohës gjithashtu që premtimi i kryeministrit sot është jetësuar në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Të gjithë ushtarakët nga ushtari i parë dhe deri tek gradat më të larta nga data 1 korrik, në bazë të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, do të kenë një pagë 30% më të lartë, çka do të thotë që paga minimale në Forcat e Armatosura është më shumë se 51 mijë lekë të reja. Shtuar këtu pastaj edhe pagesa shtesë të trajtimit ushqimor dhe trajtime të tjera sipas vështirësive”, -sqaroi ministri Peleshi.

Shtesë në pagë do të kenë edhe punonjësit e strukturës ushtarake të Mbrojtjes Kibernetike, sektor që ka marrë një vëmendje

të shtuar kohët e fundit, sipas ministrit Peleshi.

“Kemi miratuar edhe një aneks, një listë me rreth 38 pozicione apo struktura brenda forcave të Armatosura që marrin shtesë mbi këtë shtesën e pagës. Mund të veçoj atë që është e para në listën e shtesave edhe që merr shtesën më të lartë, është Struktura Ushtarake e Mbrojtjes Kibernetike. Përveç shtesës 30 % do të marrë dhe 20 mijë lekë të reja shtesë mbi këtë pagë për shkak të rëndësisë që ky domain i ri, pra mbrojtja kibernetike ka marrë sot në Shqipëri dhe në të gjithë botën, sidomos edhe pas ndryshimit të të gjithë skemës së sigurisë, pas 24 shkurtit pra agresionit rus në Ukrainë”, -u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi bëri të ditur se shtesa mbi pagat janë parashikuar edhe për funksione apo pozicione të tjera të trupave komando, të trupave speciale, të mjekëve që shërbejnë brenda forcave të Armatosura dhe shumë të tjera.

Sipas Ministrit të Mbrojtjes ky është një premtim i bërë realitet tashmë, që i jep trajtim dinjitoz dhe prestigj Forcave të Armatosura si dhe për t'i hapur rrugën më shumë prurjeve të reja.



Meetings of NATO Ministers of Defence

15-16 VI 2022

Réunions

TAKIMI I MINISTRAVE TË MBROJTJES TË VENDEVE TË ALEANCËS SË ATLANTIKUT TË VERIUT

Ministri Peleshi: Projekti i ri i Porto Romanos do të ofrojë infrastrukturë të dedikuar ushtarake për FA-të dhe NATO-n

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin e ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës së Atlantikut të Veriut që u mbajt në selinë e NATO-s, në Bruksel. Në qendër të diskutimeve të këtij takimi ishte forcimi

i mëtejshëm i Aleancës dhe vijimi i mbështetjes për vendet partnere të NATO-s, në një kohë që agresioni rus në Ukrainë ka kaluar 100 ditë nga nisja e tij. Këtij takimi iu bashkuan edhe ministrat e Mbrojtjes së Ukrainës, Gjeorgjisë, Suedisë, Finlandës, si dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit European.

Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbro-

jtjes Niko Peleshi u shpreh se vendi ynë do të mbështesë dhe kontribuojë në rritjen dhe përforcimin edhe me kapacitete ushtarake të kufijve të Aleancës, në interes të mbrojtjes dhe ruajtjes së popullsisë së saj. Ministri Peleshi foli për projektin e ri të Porto Romanos që do të ofrojë edhe infrastrukturë të dedikuar për Forcat e Armatosura dhe Aleancën



e NATO-s. "Ne e vlerësojmë infra-strukturën tonë kritike, jo vetëm nga perspektiva kombëtare, por edhe nga ajo e Aleancës. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh vendndodhjen gjeografike, porti i Durrësit shërbeu si një qendër pritjeje e stërvitjes "Defender Europe 2021" gjë që dëshmon se është një pikë

e tij ministri i Mbrojtjes Peleshi. Ai tërhoqi vëmendjen në lidhje me efektet që lufta e Rusisë ndaj Ukrainës mund të sjellë në rajonin e Ballkanit. Ministri i Mbrojtjes theksoi rëndësinë që ka në këtë situatë përsheptimi i procesit të integritetit Euro-Atlantik të vendeve të rajonit. Gjithashtu ministri Peleshi tha se



strategjike që lidh detin Adriatik dhe Detin e Zi që njihet ndryshe edhe si Korridori 8", -u shpreh në fjalën

është i rëndësishëm dërgimi i një mesazhi të fortë se siguria e rajonit të Ballkanit mbetet interes jetik për Aleancën dhe se Rusia me "levat" e saj nuk duhet të lejohen të destabilizojnë mbarë rajonin.



Ministrat e vendeve të Aleancës u pritën më herët në një darkë pune nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, i cili vlerësoi mbështetjen e pakursyer që vendet aleate dhe partnere të NATO-s kanë dhënë në kapacitete ushtarake, ndihmë financiare dhe asistencë humanitare. Gjithashtu, Ai theksoi se Aleanca është dhe mbetet e vendosur për të vazhduar mbështetjen për Ukrainën, si dhe mbetet optimiste se kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të Aleancës do të miratojnë një Paketë Asistence Gjithëpërfshirëse gjatë Samitit të Madridit, që është planifikuar të zhvillohet më 29-30 qershor.

Ministri i Mbrojtjes, vizitë zyrtare në Greqi

Niko Peleshi: Sfidat e sigurisë së përbashkët intensifikojnë bashkëpunimin mes palëve

Peleshi shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vijueshme që Greqia i ka dhënë Shqipërisë, jo vetëm gjatë procesit të anëtarësimit në NATO, por edhe në përpjekjet që vendi ynë po bën për hapjen e negociatave me Bashkimin European.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi zhvilloi një vizitë dyditore në Greqi, me ftesë të homologut të tij Nikolaos Panagiotopoulos. Biseda mes dy ministrave u përqendrua te sfidat aktuale të sigurisë, me fokus të veçantë mbi situatën në Ukrainë, pasojat e mundshme mbi sigurinë në rajon, procesin e integritetit Euro-Atlantik dhe angazhimet e përbashkëta në kuadër të NATO-s dhe rajonit.

Takimi ndërmjet dy delegacioneve u zhvillua në një frymë tepër miqësore, ku u ndanë mendimet dhe idetë e tyre për të zhvilluar dhe intensifikuar më tej bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes, duke u fokusuar në fushat e arsimimit dhe edukimit ushtarak, shëndetësi, stërvitjet e përbashkëta si dhe angazhimet në rajonin e Ballkanit.

Peleshi shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vijueshme që Greqia i ka dhënë Shqipërisë, jo vetëm gjatë

procesit të anëtarësimit në NATO, por edhe në përpjekjet që vendi ynë po bën për hapjen e negociatave me Bashkimin European.

Të dy ministrat vlerësuan kontributet respektive në angazhimet në kuadër të Aleancës si edhe shprehën gatishmërinë për të mbështetur vendimet dhe angazhimet që priten të konfirmohen në Samitin e NATO-s në Madrid, Spanjë. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi rikonfirmoi vijimin e angazhimeve të vendit tonë në NATO, duke vënë në dukje shtimin e kontributeve të Shqipërisë në kuadër të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, në eFP (enhanced Forward Presence), në Letoni si dhe angazhimin për të kontribuar me një togë në eFP Bullgari.

Nga të dyja palët u dënua njëzëri agresioni i paprovokuar i Rusisë në Ukrainë, ndërsa shprehën qëndrimin e tyre ndaj ndikimeve të kësaj situate në Ballkan, Europë e më gjerë. Ministri Peleshi u shpreh se: "Sfidat tona të sigurisë mbeten të përbashkëta, të pandashme dhe të gjithanshme. Ato vijnë nga çdo drejtim dhe mund të cenojnë sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë dhe më gjerë. Nuk duhet të humbasim vëmendjen nga rajoni i Ballkanit Perëndimor dhe krahu jugor i Aleancës".

Ministria e Mbrojtjes së Shqipërisë vlerësoi kontributin e Forcave të Armatosura greke që prej fillimit në misionin e KFOR-it, në Kosovë, si një kontribut të madh për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Sipas ministrit Peleshi, mbështetja e pjesëmarrjes së Kosovës në iniciativat rajonale (SEDM, etj.) do të jetë një hap tepër i rëndësishëm në shërbim të rritjes së besimit, paqes, stabilitetit dhe prosperitetit në rajon.





Ministri Peleshi: Shqipëria drejt anëtarësimit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së, një hap i rëndësishëm për forcimin dhe bashkëpunimin në nivel evropian

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Haki Çako, pritën në një takim në ambientet e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Komisionerin Europian për Mbrojtjen Civile, Janez Lenarčič.

Takimi u zhvillua në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian (Union Civil Protection Mechanism/ UCPM).

Ky takim u zhvillua pas takimit të z. Lenarčič me kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ku u shpreh vullneti i vendit tonë për t'u bërë pjesë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian.

Më pas, ministri i Mbrojtjes dhe Komisioneri Europian për Mbrojtjen Civile të BE-së iu drejtuan ambienteve të Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile.

Gjatë këtij takimi, Peleshi u theksoi se anëtarësimi në këtë mekanizëm është një hap i rëndësishëm për forcimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin në nivel evropian dhe

përmirësimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë. Ministri i Mbrojtjes informoi Komisionerin Europian për Mbrojtjen Civile mbi zhvillimet e fundit dhe reformimin e sistemit të Mbrojtjes Civile në rang kombëtar me synim përballimin sa më efikas të krizave në shkallë të gjerë.

Gjithashtu, ministri i Mbrojtjes shprehu mirënjohjen mbi kontribu-

tin dhe solidaritetin e treguar nga Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i BE-së në momente të vështira që ka kaluar vendi ynë gjatë tërmetit të vitit 2019, pandemisë COVID-19 dhe zjarreve në stinën e verës.

Gjatë këtij takimi u theksua fakti se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe këtij mekanizmi në fushën e mbrojtjes civile do të vazhdojë të forcohet në të ardhmen.



Zhvillohet stërvitja detare “GrupEx - 22”

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi:

Ambicia jonë, investime të mëdha në fushën e infrastrukturës, të gatshëm për “Defender 2023”

Për dy ditë më radhë, efektivë të Forcës Detare në Forcat e Armatosura zhvilluan në bregdetin e vendit stërvitjen “GrupEx - 22”. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i pranishëm në nisje të kësaj stërvitjeje, e cilësoi të rëndësishme atë, veçanërisht në këtë moment të rritjes së standardeve të Forcave të Armatosura.

Gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi foli për një plan ambicioz që Ministria e Mbrojtjes dhe qeveria ka për Sigurinë Kibernetike: “Për Forcën Detare kemi gjithashtu ambicie dhe plane ashtu siç i kemi ndarë me komandantin për të shtuar flotën tonë në një të ardhme afatmesme, për të rritur kapacitetet tona të mirëmbajtjes. Jemi në proces të identifikimit në mënyrat më të mira se si mund të kemi një përgjigje më të mirë të të gjitha nevojave për mirëmbajtje, por edhe siç e thashë, të ndërtimit, blerjes së anijeve të tjera siç i kemi në objektivat e kapaciteteve”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Z. Peleshi u shpreh se parashikohen investime të mëdha në fushën e infrastrukturës dhe këto po diskutohen dhe planifikohen edhe me programin qeveritar si pjesë e projekteve të mëdha për Shqipërinë. Ministri i Mbrojtjes vuri në dukje përvojën që Forcat e Armatosura të Shqipërisë morën pikërisht një vit më parë nga stërvitja më e madhe “Defender 2021”. “Vlen të kujtoj që para një viti, në të gjithë territorin e Shqipërisë është zhvilluar stërvitja “Defender-21”; një komponent i rëndësishëm i saj ka qenë edhe në det dhe besoj që kemi marrë mësim, kemi rritur ndërveprueshmërinë në një përmasë që kurrë më parë nuk e kemi pasur shansin. Kështu që jemi tani edhe më gati për t’u bërë një vend pritës, jo vetëm në tokë, por edhe në ajër, edhe në det për vitin tjetër, “Defender-23” edhe në vazhdim”, theksoi ministri Peleshi.

Ndërsa komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra shpjegoi qëllimet e kësaj stërvitjeje,



që kanë të bëjnë edhe me shërbimin konkret ndaj komunitetit. “Pas kësaj stërvitjeje, anijet do të shpërndahen në të gjithë bregdetin shqiptar; nga Shëngjini deri në Sarandë, në të gjitha portet e hapura, por edhe bazat e Forcës Detare me qëllim që t’i përgjigjemi situatave të sezonit për shkak të rritjes së fluksit të turistëve, të përdorimit edhe të paligjshëm të detit. Anijet do të jenë me kohë në rajon për t’iu përgjigjur të gjitha situatave”, - u shpreh kundëradmiral Agastra.

Kjo stërvitje kishte si synim vlerësi-

min dhe certifikimin e grupeve të anijeve patrulluese si njësi zbatuese, testimin e aftësive organizative dhe komanduese të komandantëve të grupeve, planëzimin e Shtabit të Flotiljes Detare si dhe kryerjen e qitjeve me armatimin e anijeve. Në stërvitjen “GrupEx-22” dhe qitjet bregdetare morën pjesë 11 anije të Flotiljes Detare, 3 anije të klasit “Archangel” si edhe Grupi i Bordingut. Stërvitja dhe qitjet bregdetare u zhvilluan në përputhje me dokumentet stërvitore si dhe ato të NATO-s.



Ish-piloti dhe komandanti Shefqet Lata nderohet me titullin “Qytetar nderi i Bashkisë Mat”

Në qytetin e Burrelit u zhvillua ceremonia e nderimit dhe dorëzimit të titullit “Qytetar nderi” për ish-pilotin dhe komandantin e ish-regjimenteve të Gjadrit dhe Rinasit z. Shefqet Lata.

Në këtë aktivitet morën pjesë prefekti i Qarkut Nexhbedin Shehu, kryetari i Bashkisë Mat, Agron Malaj, kryetari i Këshillit të Bashkisë Mat Elisa Gjasta, kryetari i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, përfaqësues të Komandës së Forcës Ajrore, 15 anëtarët e këshillit të Bashkisë Mat, pilotë-veteranë të Forcës Ajrore si dhe miq, shokë e familjarë të z. Shefqet Lata. Ceremonia u hap me vendimin e Këshillit të Bashkisë Mat duke u pasur me fjalën e pilotit veteran Agim Matraku, i cili prezantoi karrierën dhe kontributin e z. Shefqet Lata si pilot dhe drejtues në vite, i disa prej njësive kryesore të Forcës Ajrore.

Kryetari i Bashkisë Agron Malaj përshëndeti dhe dorëzoi titullin “Qytetar nderi i Bashkisë Mat” z. Shefqet Lata, me motivacionin “Për merita të veçanta si pilot ushtarak dhe komandant njësie në aviacionin ushtarak shqiptar për rreth 30 vjet duke u bërë shqiponja matjane e ajrit”.

Ceremonia u përshëndet nga Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehu dhe nga kryetari i shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, i cili i dorëzoi z. Shefqet Lata “Certifikatën e Mirënjohjes” për kontributin e veçantë në armën e aviacionit, si pilot i talentuar, kuadër i devotshëm dhe drejtues në vite i dy regjimenteve luftarakë.

Në emër të Komandës së Forcës Ajrore, fjalën përshëndetëse e mbajti nënkolonel Silvana Lahi, shefja e bashkëpunimit civilo-ushtarak. Ajo transmetoi urimet e Komandantit të Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj duke theksuar se: “Shefqet Lata i dashuruar me ëndrrën për të kapur qiejt, pasi mbaroi Akademinë e Aviacionit dhe viteve të para të fluturimit në Bazën Ajrore Kuçovë, përzgjidhet dhe dërgohet me studime jashtë vendit për t’u bërë pjesë e një plejade pilotësh të aftë të drejtonin avionët luftarakë, ku ka treguar aftësi të jashtëzakonshme profesionale dhe karakterin e një piloti të veçantë dhe të guximshëm. Si drejtues dhe komandant i dy ish-regjimenteve të aviacionit në Gjadër dhe Rinas, ai ka treguar jo vetëm aftësi drejtuese por edhe marrëdhënie të shkëlqyera me var-tësit, të reflektuara këto në respekt, komunikim dhe mbështetje, vlera kaq të domosdoshme për një lidhësi të suksesshëm. Marrja e titullit “Qytetar



nderi i Bashkisë Mat” i një ish-anëtar të komunitetit të Forcave Ajrore nuk është vetëm respekti që i bëhet sot Shefqetit por është një kënaqësi dhe krenari që Forcat Ajrore kanë pasur në gjirin e tyre pilotë dhe drejtues kaq të

vlerësuar dhe të respektuar si Shefqet Lata”. Ceremonia u mbyll me kujtime dhe përshëndetjet e rastit nga shokët kolegët e ish-pilotit Lata dhe me një foto të përbashkët me të gjithë të pranishmit.

Këshilli i Qarkut Gjirokastrë nderon me titullin “Mirënjohje e Qytetit” ish-pilotin dhe komandantin Harilla Rebi

Në qytetin e Gjirokastrës u zhvillua ceremonia e nderimit dhe dorëzimit të titullit “Mirënjohje e Qytetit” për ish-pilotin dhe komandantin e tre ish-regjimenteve të Rinasit, Gjadrit dhe Kuçovës z. Harilla Rebi.

Në këtë aktivitet morën pjesë prefekti i Qarkut Gjirokastrë Odise Kote, kryetari i Bashkisë Gjirokastrë Flamur Golemi, përfaqësues të Komandës së Forcës Ajrore, kryetari i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, përfaqësues të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, pilotë-veteranë të Forcës Ajrore si dhe miq, shokë e familjarë të z. Harilla Rebi. Ceremonia u hap me kujtimet e pilotit veteran Agim Matraku, i cili prezantoi mes emocionesh gjithë karrierën dhe kontributin e z. Harilla Rebi si pilot dhe drejtues i disa prej njësive kryesore të Forcës Ajrore. Në emër të Komandës së Forcës Ajrore, fjalën përshëndetëse e mbajti nënkolonel Silvana Lahi, shefja e bashkëpunimit civilo-ushtarak. Ajo transmetoi urimet e komandantit të Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, duke theksuar se: “Shpesh kur flitet për historikun e aviacionit dhe



drejtuesve të saj, emri i komandant Harillës nuk ndahet nga ai i drejtuesve të spikatur, duke mbetur në kujtesën e pilotëve dhe teknikëve, një ikonë e aviacionit ushtarak. Si drejtues dhe komandant i tre regjimenteve të aviacionit që ai ka drejtuar në Gjadër, Kuçovë dhe Rinas, ka treguar jo vetëm aftësitë më të shkëlqyera të një lidhësi por edhe fisnikërinë qytetare në marrëdhëniet me njerëzit. Komandant Harilla ishte figura dhe mishërimi më i mirë i ushtarakut model që udhëhiqej nga moto, se mbi të gjitha është “Atdheu-Detyra-Nderi”. Figura e ish-komandantit dhe pilotit Harilla Rebi është sot një emër i respektuar dhe një model për brezat e rinj të pilotëve që shërbejnë në Forcën Ajrore”. Ceremonia u mbyll me dorëzimin nga kryetari i Bashkisë të titullit “Mirënjohje e qytetit” z. Harilla Rebi si dhe “Certifikata e Mirënjohjes” dorëzuar nga gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi kryetar i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë.



Zhvillohet “Dita e vizitorëve të shquar” e stërvitjes “Adrion Livex-22”

Në përfundim të stërvitjes “Adrion Livex-22” e zhvilluar në Split, Kroaci është zhvilluar “Dita e vizitorëve të shquar”, në të cilën morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare kroate, sllovene, greke, italiane, malazeze dhe ato shqiptare.

Qëllimi i stërvitjes ishte përmirësimi i ndërveprimit të marinave “Adrion” në kryerjen e operacioneve detare si operacionet e ndalimit detar, kërkim-shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det.

Një pikë tjetër e rëndësishme e stërvitjes ishte trajnimi i ekuipazheve në përdorimin e procedurave standarde të funksionimit sipas manualeve të NATO-s.

Në stërvitjen e zhvilluar në Split Kroaci, Forca Detare mori pjesë me anijen e klasit Iliria “Lissus” P-133.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes u trajtua rëndësia mbi bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon. Gjithashtu u diskutua mbi rëndësinë e vijimit të iniciativës “Adrion”, për rritjen e sigurimit detar të rajonit, për forcimin dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së operacioneve të kërkim-shpëtim në det.

Në “Ditën e vizitorëve të shquar” mori pjesë komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili pas përfundimit të stërvitjes realizoi dhe një vizitë në bordin e Anijes “Lissus”, gjatë takimit përshëndeti efektivin e anijes dhe u shpreh falënderimet për përfaqësimin dinjitoz në këtë stërvitje. Gjithashtu diskutoi për ecurinë e stërvitjes dhe mundësinë e përmirësimit të kapaciteteve operacionale në të ardhmen.

Kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj, komandanti i ri i Flotiljes Detare

Në bazën detare të Pashali-manit u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandantit të Flotiljes Detare. Në ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra.

Kapiten i rangut I Sabri Gjinollari në fjalën e tij vlerësoi arritjet dhe përkushtimin e treguar nga efektivi i Flotiljes në kryerjen e detyrave të ngarkuara gjatë tetëmbëdhjetë muajve të drejtimit të Flotiljes prej tij.

Ndërsa kapiten i rangut I Engjëll

Sinanaj në fjalën si komandanti i ri i Flotiljes Detare siguroi që Flotilja Detare do të vazhdojë të qëndrojë në pararojë të Forcës Detare dhe do të kryejë me sukses të gjitha detyrat që do t'i ngarkohen.

Komandanti i Forcës Detare në fjalën përshëndetëse vlerësoi punën e kryer nga efektivi në zbatim të misionit dhe detyrave kushtetuese si dhe kërkoi prej tyre angazhim më të madh në përballimin e ngarkesës gjatë sezonit të verës.

Zhvillohet Konferenca Përfundimtare për stërvitjen “Imponimi - 2022”

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua konferenca përfundimtare për zhvillimin e stërvitjes “Imponimi - 2022”.

Konferenca u drejtua nga komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, i cili theksoi rëndësinë e kësaj stërvitjeje dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet shtetërore me interesa të përbashkëta në det. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Shtabit të Forcës Detare, Grupit të Dytë të Anijëve Patrulluese të Flotiljes Detare, Forcës Ajrore, Forcës Tokësore, si dhe përfaqësues të institucioneve detare që do jenë pjesëmarrës në këtë stërvitje me personel e mjete, konkretisht: Qendra Operacionale Ndërinstitucionale Detare, Policia Kufitare e Migracionit dhe Kapitanerisë së Portit Detar Durrës.

Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje është rritja e ndërveprueshmërisë së Forcës Detare me strukturat e Forcave të Armatosura dhe atyre ligjzbatuese për kryerjen e operacioneve të ndalimit detar si dhe zbatimit të ligjshmërisë detare.



Forca Tokësore, pjesëmarrëse e "Efes-22" në Izmir, Turqi

Në Izmir, Turqi, u zhvillua një nga stërvitjet më të mëdha të vendeve anëtare dhe atyre partnere të NATO-s, e koduar "Efes-22".

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte zhvillimi i mëtejshëm i aftësive dhe kapaciteteve ushtarake të trupave "joint", për të mbuluar dhe realizuar të gjitha detyrat që mund t'iu caktoheshin, duke ruajtur nivelin e gatishmërisë luftarake. Në këtë stërvitje të përmasave të mëdha, vendi ynë u përfaqësua me një togë këmbësorie nga Batalioni I i Këmbësorisë i Forcës Tokësore. Gjatë stërvitjes, trupat tona treguan nivel të lartë profesionalizmi dhe disipline në realizimin e çdo detyre të caktuar sipas skenarëve të stërvitjes.

Ndër temat kryesore që u zhvilluan gjatë kësaj stërvitjeje ishin: zbarkim

nga ajri; qitje me mortaja dhe armë kundërtanke, veprime luftarake nga deti, zbarkim me mjete amfibe etj.

Këtë vit stërvitja "Efes-22", bëri së bashku mbi 10 000 trupa nga 37 shtete, duke përfshirë ndër të tjerë Shqipërinë, Libinë, Italinë, Azerbajxhanin, Bosnje-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Pakistanin, Kazakistanin, Kirgistanin, Shtetet e Bashkuara dhe Francën.

Pjesëmarrja e trupave të Forcës Tokësore në stërvitjen "Efes-22", vjen në vijim të disa stërvitjeve ndërkombëtare që po zhvillohen këtë vit nga kjo Forcë, në kuadër të plan-kalendarit të stërvitjeve vjetore. Synimi i tyre është rritja e aftësive operacionale dhe ndërvepruese e këtyre forcave në një mjedis operacional ndërkombëtar.

"Miqësi nëpërmjet Sportit" (Friendship through Sport)

Kampionati i Futbollit në Forcat e Armatosura, 2022

Forca Tokësore fiton kupën e kampionatit të futbollit në FARSH

Në mjediset e Garnizonit "Skënderbej", në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia përfundimtare e Kampionatit të Futbollit të Forcave të Armatosura për vitin 2022, në të cilën morën pjesë tetë ekipet më të mira të futbollit në FA, duke filluar nga Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Akademia e Forcave të Armatosura, Komanda Logjistike, ASNI, Policia Ushtarake dhe AISM.

Ceremonia u përshëndet nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, ku të pranishëm ishin ekipet pjesëmarrëse si dhe komandantët e forcave, gjeneralë, oficerë dhe ushtarakë të tjerë etj. Në përshëndetjen e saj drejtuar pjesëmarrësve në këtë aktivitet sportiv, gjeneralmajor Shehu vuri theksin se këto aktivitete i shërbejnë rritjes së frymës së kolektivitetit dhe shpirtit të garës, tipare këto që karakterizojnë Forcat e Armatosura, për arritjen e synimeve dhe objektivave për realizimin e detyrave. "Sfidat që i paraqiten ushtarakëve dhe FA-ve për përmbushjen e detyrave kërkojnë përgatitje të lartë fizike, të motivuar, ndjenjë të lartë solidariteti dhe kondicion të mirë fizik, gjë që e treguan edhe në këtë aktivitet sportiv dhe për këtë jam shumë mirënjohës për çdonjërin nga ju", -tha ndër të tjera gjeneralmajor Shehu. Kampionati i futbollit është një aktivitet sportiv i përvitshëm, i cili përveç rëndësisë që ka në përgatitjen fizike të trupave, përcjell dhe mesazhin "Miqësi nëpërmjet Sportit" (Friendship through Sport). Kampionati aktivizoi mbi 150 efektivë/futbollistë që të gjithë efektivë ushtarakë dhe civilë të FA-së. Vendin e parë në kampionatin e futbollit të FARSH për vitin 2022 e fitoi ekipi i komandës së Forcës Tokësore, vendin e dytë Forca Detare, vendin e tretë Akademia e Forcave të Armatosura, e cila fitoi dhe kupën e "FAIR-PLAY". Në mbyllje të aktivitetit sportiv u shpërndanë certifikata dhe medalje për fituesit.

Certifikohen 12 komando të kursit "Lufta në Qendrat e Banuara"

U zhvillua në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS) të Forcës Tokësore (FT), ceremonia e përfundimit të Kursit të "Luftës në Qendrat e Banuara" (LQB), i zhvilluar me efektivët e Batalionit Komando.

Në aktivitetin, i cili u hap me një mësim tregues nga personeli komando, pjesë e kursit LQB, ku ata demonstruan disa nga temat e zhvilluara gjatë kursit, mori pjesë edhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i ROS kolonel Arben Zani, përfaqësues nga Shtabi i FT dhe i ROS.

Gjatë zhvillimit të demonstrimit, gjeneral brigade Kingji u njoh nga instruktorët turq të cilët zhvilluan këtë trajnim, mbi ecurinë, problematikat dhe temat kryesore që ata trajtuan me kursantët komando.

Me tej, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji, duke përshëndetur të pranishmit, falënderoi të gjithë kursantët për angazhimin, disiplinën, profesionalizmin dhe vendosmërinë e treguar gjatë gjithë periudhës së kursit LQB.

Duke e vlerësuar si një nga kurset më të mira profesionale për trupat komando, ai u shpreh i bindur se me përfundimin e këtij kursi, efektivët janë më të kompletuar dhe më të përgatitur nga ana profesionale, për t'iu përgjigjur çdo sfide apo situatë.

Komandanti i Forcës Tokësore, shprehu përgëzimet dhe mirënjohjen e tij edhe për instruktorët ushtarakë turq, të cilët organizuan dhe drejtuan kursin LQB. Gjeneral brigade Kingji e vlerësoi punën e mirë nga ana e tyre duke iu akorduar edhe Certifikatat e Mirënjohjes.

Ceremonia vijoi me ndarjen e certifikatave për kursantët dhe u mbyll me një foto të përbashkët.

Kursi i "Luftës në Qendrat e Banuara", u zhvillua për rreth pesë javë në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale. I konsideruar si një nga kurset me ngarkesë të lartë psikologjike dhe fizike, kursi i LQB nga 24 pjesëmarrës certifikoi vetëm 12 në përfundim të tij.

INTERVISTË
ME GJENERAL
BRIGADE
EDITSON
ZARKA



Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari

E drejta e informimit dhe sigurisë kombëtare në optikën e transparencës së publikut

Gjeneral brigade Editson Zarka përfundoi studimet në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej", dhe më tej në Akademinë Ushtarake, në degën "Radiolokacion Zbulim i Largët", duke u titulluar oficer aktiv në radhët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Ai gjithashtu ndoqi studimet universitare në Fakultetin e Drejtësisë (Dega Juridik) në Universitetin shtetëror "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, të cilat i përfundoi në vitin 2003.

Gjeneral brigade Editson Zarka ka kryer një sërë kursesh kualifikimi si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në vitin 2000 ai kreu studimet në Kursin e Karrierës së Kapitenëve në Shkollën e Policisë Ushtarake, në Ft. Leonard Wood, në SHBA. Në vitin 2003 ai përfundoi Kursin e Menaxhimit të Mbrojtjes për Shoqëritë Demokratike, në Kolegjin Mbretëror të Shkencave Ushtarake, në Angli. Në vitin 2008 përfundoi Kursin Ekzekutiv për Studime të Avancuara të Sigurisë, në Qendrën Europiane për Studimet e Sigurisë "George Marshall", në Gjermani. Në vitin 2009 përfundoi Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSH), ndërsa në vitin 2012 përfundoi Kursin e Lartë të Oficerit (KLO) në Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu",



gjenral brigade Editson Zarka u emërua Komandant i Shkolllës së Trupës dhe Qendrës së Stërvitjes Individuale në Bunavi, Vlorë. Në periudhën Mars 2018-Mars 2019, ai u emërua Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5/8), në SHPFA. Më tej, në periudhën Prill 2019-Gusht 2020, ai kreu detyrën e zëvendëskomandantit (Komandant në detyrë) të Forcës Ajrore. Në periudhën Shtator 2020-Nëntor 2021 ai kreu një sërë detyrash të tjera si Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Burimeve të Mbrojtjes dhe zëvendësdyrejtor, në J-5/8, SHPFA; Shef i Departamentit të Liderimit dhe Shkencave Shoqërore në Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, Akademia e Forcave të Armatosura; dhe Drejtor i Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes. Në datën 26 Nëntor 2021 ai u promovua në gradën "Gjenral Brigade" nga Presidenti i Republikës.

Gjenral brigade Editson Zarka ka qenë i përfshirë në përgatitjen e dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke qenë pjesë e grupeve të punës në hartimin e dokumenteve të

Tiranë. Në vitin 2013 përfundoi Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes në Akademinë e Forcave të Armatosura, në Tiranë. Gjenral brigade Editson Zarka ka fituar titullin "Master Shkencor" në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes pranë Akademisë së Mbrojtjes, në Tiranë. Ndër kurset e tjera afatshkurtra janë ato që lidhen me programet e NATO/PfP-së, Armë-Kontrollit, gjuhët e huaja (anglisht, frëngjisht dhe italisht) si dhe kurse për emergjencat civile, drejtësinë ushtarake, politikat e sigurisë kombëtare, rajonale etj.

Gjenral brigade Editson Zarka gjatë karrierës së tij ka kryer detyra të ndryshme në pozicione shtabi dhe drejtimi duke filluar nga nivele taktike e duke kaluar gradualisht në nivele operative e strategjike. Në periudhën 2000-2009 ai ka punuar në pozicione kyçe të planifikimit dhe integritimit në NATO/PfP, duke kontribuar në përgatitjen e planeve dhe programeve të bashkëpunimit tilla si Planin Individual të Partneritetit (IPP), Konceptin e Kapaciteteve Operacionale (OCC), Procesin e Planifikimit dhe Rishikimit (PARP) të mbrojtjes, Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) etj. Në vitin 2009, pas pranimit të vendit tonë në NATO, ai u emërua zëvendësdyrejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes (J-5) në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHPFA). Pas kësaj ai kreu detyra të tjera të rëndësishme si Drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes (J-3/7), Drejtor i Drejtorisë së Jetësimi të Prioriteteve dhe Monitorimit, në Ministrinë e Mbrojtjes. Në periudhën korrik 2014-korrik 2017, u emërua Drejtor i Koordinimit dhe Integritimit (COI), në Drejtorinë e Partneriteteve Ushtarake (MPD), në Komandën Strategjike të Aleancës për Operacionet (SHAPE), Mons, Belgjikë. Me përfundimin e kësaj detyre, në korrik 2017

Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes, Strategjisë Ushtarake, Planit Afatgjatë të Zhvillimit të Forcave, Programit Buxhetor Afatmesëm etj. Ai ka përgatitur gjithashtu materiale referuese për tema të ndryshme që lidhen me fushën e sigurisë dhe mbrojtjes duke qenë lektor në akademi, qendra trajnimi, konferenca shkencore, seminare e workshope të ndryshme si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Gjenral brigade Editson Zarka ka publikuar një sërë artikujsh në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes kryesisht në fushën e planifikimit ushtarak, standardizimit, bashkëpunimit ushtarak, stërvitjet dhe trajnimin, politikave të sigurisë rajonale, kombëtare etj.

Gjenral brigade Editson Zarka si një studiues dhe trajtues i mirë i çështjes së 'Të drejtës së informimit publik dhe sigurisë kombëtare për një njohje më të gjerë dhe për lexuesit, vjen në këtë intervistë për të na dhënë një panoramë të marrëdhënies së informimit publik dhe FA-së, si dhe çështjes së sigurisë kombëtare sidomos në këto kohë trazirash në Europë.

Gjenral Zarka, cili ishte ndikimi i përpjekjeve postkomuniste të reformave të mbrojtjes mbi marrëdhëniet civilo-ushtarake?

Marrëdhëniet civilo-ushtarake kanë shënuar hapa pozitivë pas periudhës postkomuniste, si rezultat i një numri reformash transformuese që kanë përfshirë institucionin e sigurisë dhe mbrojtjes. Ky proces është bërë hap pas hapi dhe ka njohur zhvillimet e veta, në periudha të ndryshme të zhvillimit të vendit dhe vetë forcave tona të armatosura. Ajo që ia vlen të përmendim

është fakti i transformimit të kontrollit civil demokratik mbi forcat e armatosura, ose e thënë më gjerë, mbi forcat e sigurisë së një vendi, të cilat japin llogari dhe kontrollohen nga Parlamenti.

Cili ishte ndikimi i reformave për anëtarësimin në NATO mbi mbikëqyrjen e politikave të mbrojtjes?

Vendi ynë iu nënshtrua një serie reformash në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, duke marrë pjesë në programet e drejtuara nga NATO si Partneriteti për Paqe, Procesi i Planifikimit dhe Rishikimit të Mbrojtjes (PARP), dhe më i rëndësishëm Plani i Anëtarësimit në NATO (MAP). Ky i fundit u shtri në pesë fusha kryesore, përfshirë mekanizmat e mbikëqyrjes të sektorit të sigurisë, politikave të mbrojtjes etj. Ajo që është e rëndësishme të nënvizohet është fakti se politikat e mbrojtjes të vendit tonë u bënë në përputhje me politikat e NATO-s, duke sinkronizuar punën në drejtim të legjislacionit, standardizimit, objektivave afatmesme e afatgjatë, si dhe pjesëmarrjes në forumet kryesore të NATO-s. Të gjitha këto patën impakte të drejtpërdrejta në vendin tonë, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat tona të Armatosura.

Cilat janë sfidat aktuale të mbikëqyrjes së politikave të mbrojtjes?

Politikat e mbrojtjes shprehin në thelb politikën shtetërore të një vendi për arritjen e objektivave të caktuara. Sfidat aktuale të saj janë përballimi i kërcënimeve dhe rreziqeve të reja që i kanosen komunitetit ndërkombëtar, sigurisë euro-atlantike, sigurisë rajonale, kombëtare e më gjerë. Konflikti i armatosur në Ukrainë ka rritur ndjeshëm impaktin në Aleancën e NATO-s, Bashkimin Europian dhe të gjitha vendet, të cilat janë ndikuar në një formë ose një tjetër nga ky konflikt. Mbikëqyrja e politikave të mbrojtjes bëhet në përputhje me mekanizmat e mbikëqyrjes parlamentare dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur.

Integrimi i konceptit të kontrollit demokratik në planet e reformave të mbrojtjes?

Mendoj që ky koncept ka qenë i shkrirë në planet e reformave të mbrojtjes, për vet dimensionin që paraqet si koncept. Pavarësisht kësaj, është bërë një punë e mirë ndër vite për njohjen e konceptit, duke shfrytëzuar eksperiencën më të mirë të vendeve perëndimore, si dhe atë të institucioneve arsimore apo qendrave të ndryshme që e trajtojnë më gjerësisht këtë aspekt. Këto reforma i shërbejnë demokratizimit të forcave të armatosura, përshtatjes së tyre me mjedisin e sigurisë, si dhe pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare, duke rritur ndërveprimin dhe standardizimin me forcat aleate.

Kontrolli demokratik dhe transformimi i Forcave të Armatosura?

Siç e përmendëm edhe më parë, kontrolli demokratik ushtrohet kryesisht nga organet e zgjedhura siç është Parlamenti me komisionet e tij, sidomos Komisioni i Sigurisë, Komisioni i Politikës së Jashtme, apo komisionet përkatëse që kanë të bëjnë me aspektet e buxhetit të mbrojtjes, planeve të modernizimit, pjesëmarrjes në operacionet ndërkombëtare etj. Në republikat parlamentare, parlamenti është sovran dhe i kërkon llogari ekzekutivit për hartimin, zbatimin dhe rishikimin e politikës së sigurisë dhe të mbrojtjes. Kontrolli demokratik dhe transformimi i forcave të armatosura shkojnë dora dorës në shoqëritë demokratike. Transformimi kryhet si proces i domosdoshëm për të pasur struktura sa më operacionale dhe për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë. Hapat e këtij transformimi duhet të kryhen nën mbikëqyr-

jen dhe kontrollit demokratik të tyre.

Cili është roli i shoqërisë civile dhe i institucioneve të mbrojtjes?

Shoqëria civile luan një rol të veçantë në shoqëritë demokratike, institucionet e shtetit përfshirë atë të mbrojtjes. Aktivitetet që organizon kjo shoqëri ndihmojnë në rritjen e transparencës, në proceset e konsultimit publik, si edhe në të drejtën e informacionit për aspekte të veçanta, ku përfshihet sfera e veprimtarisë së institucionit të mbrojtjes. Institucionet e mbrojtjes kanë rol kryesor zbatimin e kushtetutës për mbrojtjen e integritetit territorial, pavarësisht të vendit, si dhe përmbushjen e detyrimeve kombëtare e ndërkombëtare, si pjesë e aleancës Euro-Atlantike, apo detyrimet për zbatimin e marrëveshjeve e konventave ku vendi ynë bën pjesë.

Cilat janë zhvillimet e kohëve të fundit në mjedisin e sigurisë?

Mjedisi i sigurisë karakterizohet nga të panjohurat dhe zhvillimet krejtësisht të paparashikueshme, daljen e autorëve të rinj, të cilët, si kurrë ndonjëherë më parë, arrijnë të krijojnë probleme apo rreziqe për sigurinë kombëtare, rajonale dhe globale. Krimi organizuar, terrorizmi, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, trafiqet e paligjshme, ndryshimet klimaterike, krimi kibernetik, janë disa nga kërcënimet dhe rreziqet që kërcënojnë sigurinë kombëtare. Mjedisi i sigurisë është shumë kompleks, sidomos në ditët që po kalojmë sot me ngjarjet në Ukrainë nga pushtimi rus. Ky konflikt ka ndikuar drejtpërsëdrejti në vendimmarrjet e institucioneve ndërkombëtare të sigurisë, si dhe në të gjitha vendet, të cilat preken si ekonomikisht, po ashtu edhe në fusha të tjera përfshirë fushën e mbrojtjes. Në këtë kuadër lind si domosdoshmëri rishikimi i mbrojtjes, për t'i bërë ballë kërcënimeve të reja, për modernizimin e forcave dhe blerjen e armëve dhe sistemeve bashkëkohore.

Cilat janë rreziqet dhe kundërveprimet e reja?

Rreziqet e sigurisë janë ato tradicionale dhe jo-tradicionale, përfshirë sfidat e reja në fushën kibernetike, gjeo-hapësinore e më gjerë. Zhvillimi i teknologjisë ndikon drejtpërdrejt edhe në zhvillimin e metodave të reja në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Vendet përgatisin strategji dhe plane periodike të cilat i evidentojnë këto kërcënime dhe rreziqe, si dhe marrin masa për reagimin dhe kundërveprimin ndaj tyre, në mëvetësi ose në përbërje të organizatave rajonale, apo koalicioneve të vullnetit të përbashkët, në përputhje me ligjin dhe të drejtën ndërkombëtare. Ndryshimi i vazhdueshëm i këtij mjedisi kërkon ndryshimin e strategjive dhe planeve të mbrojtjes për t'iu përgjigjur më mirë sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve. Vend të rëndësishëm zë bashkëpunimi reciprok, krijimi i kapaciteteve të përbashkëta për pjesëmarrje në operacione luftarake dhe jo-luftarake, përfshirë emergjencat civile dhe katastrofat natyrore.

A është e nevojshme mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë?

Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë është një kërkesë shumë e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e këtij sektori, përfshirë institucionin e mbrojtjes. Kjo është një kërkesë kushtetuese në shtetet demokratike, e cila kontrollon veprimtarinë e strukturave të sigurisë, siguron transparencë më të gjerë për publikun, kontrollon shpenzimet që bëhen në këto organe, në përputhje me ligjin, projektet e miratuara, sidomos në drejtim të shpenzimeve për blerjet ushtarake e me gjerë.

Cilat janë parimet kryesore të qeverisjes demokratike në fushën e sigurisë?

Politika e sigurisë kombëtare parashtrohet, para së gjithash, qëndrimin e qeverisë ndaj sigurisë dhe mënyrën si mendohet që të arrihet kjo siguri. Parimet kryesore të qeverisjes lidhen me kontrollin civil demokratik në fushën e sigurisë, transparencën, llogaridhënien, informimin publik, përmbushjen e detyrimeve kushtetuese etj., pjesëmarrja në organizatat ndërkombëtare, ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e parimeve në fushën e sigurisë. Ndër to mund të përmendim parimet për përdorimin e forcës, zgjidhjen paqësore të konflikteve, ruajtja e integritetit territorial, mosndërhynjen në punët e brendshme të një shteti tjetër, respektimin e të drejtave të njeriut, bashkëpunimin midis shteteve, si dhe përmbushjen e detyrimeve të së drejtës ndërkombëtare.

Si lidhet shoqëria civile me fushën e sigurisë ose si mund t'i komunikohen publikut çështjet e sigurisë?

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në fushën e sigurisë. Ajo adreson problematika të cilat janë në interes të publikut të gjerë dhe organet e sigurisë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë. Roli dhe veprimtaria e saj është e ndryshme dhe e larmishme. Shoqëria civile mund të përpiqet aktivisht dhe të japë ndikimin e vet tek vendimmarrjet dhe politikat në fushën e sigurisë. Komunikimi me publikun bëhet me një serë mekanizmesh dhe mjetesh. Konsultimi publik, debatet parlamentare, informimi pro-aktiv nëpërmjet faqeve zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave të vartësisë, adresimi i kërkesë-ankesave nëpërmjet portaleve të ndryshme të informimit publik janë disa nga mekanizmat e komunikimit me publikun e gjerë.

Cili është roli i grave në fushën e sigurisë?

Barazia gjinore është një shqetësim publik i cili ka marrë një vëmendje të madhe ndërkombëtare në dekadat e fundit. Gratë përbëjnë gati 50% të popullsisë botërore, kështu që ato kanë dhe duhet të kenë të drejta të barabarta me burrat dhe kanë shumë për të dhënë që të kontribuojnë për zgjidhjen e çështjeve të sigurisë. Roli i grave është i qenësishëm në fushën e sigurisë, pjesëmarrjen e tyre në proceset e paqes, operacionet paqeruajtëse, operacionet humanitare, rindërtimin dhe rehabilitimin, si dhe për çarmatimin, çmbilizimin dhe integrimin. Vendi ynë ka bërë hapa konkretë në këtë drejtim. Zbatimi i rezolutës së 1325 i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara kërkon, krahas të tjerave, edhe përfaqësimin e tyre në pozicione kyçe në strukturat e MM dhe FARSH, përfshirë pjesëmarrjen e tyre në operacionet ndërkombëtare. Në këtë kategori futet përfaqësimi i tyre në postet jashtë vendit, ku vendi ynë është pjesë e strukturave të ndryshme të sigurisë dhe mbrojtjes. Rritja e rolit të grave në proceset e vendimmarrjes së politikës sigurisë dhe zbatimin e saj, ka sjellë hapa shumë pozitivë në këtë drejtim.

Cila është etika profesionale në këtë fushë?

Etika profesionale është një komponent i rëndësishëm në fushën e sigurisë. Ajo është bërë pjesë e veprimtarisë së forcave të sigurisë. Vlerat morale, besnikëria, detyra, respekti, kuraja profesionale, besimi, rritja e profesionalizmit, dedikimi, barazia, fryma e bashkëpunimit janë elementë përbërës të etikës profesionale të strukturave të sigurisë.

A mund të krijojnë ushtarakët organizata ushtarake?

Kjo fushë është diskutuar edhe më herët, duke pasur parasysh disa vende perëndimore, të cilat kanë organizata të tilla dhe që i shërbejnë më mirë komunitetit ushtarak për të adresuar çështje të ndryshme. Një përvojë e mirë është edhe ajo e strukturave të ministrisë së brendshme që kanë një organizatë të tillë. Liria për t'u organizuar në shoqata ushtarake është një e drejtë kushtetuese, e cila ndihmon konsolidimin e vlerave demokratike edhe në radhët e Forcave të Armatosura. Duke respektuar dhe mbrojtur sa më shumë të drejtat dhe liritë themelore të ushtarakëve aq më shumë ndikojmë në rritjen e dinjitetit dhe përmbushjen e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura. Krijimi kuptohet që duhet të bëhet brenda kontekstit kushtetues e ligjor, duke marrë përvojat më të mira të vendeve demokratike.

Si mund të kontrollohet fusha e sigurisë?

Mekanizmat e kontrollit në fushën e sigurisë janë të shumta, të cilat zbatohen edhe në vendin tonë. Ato përfshijnë fushën e llogaridhënies para parlamentit, kontrollin e buxhetit, prokurimet e mëdha, pjesëmarrjen në operacionet ndërkombëtare, projektet në fushën e infrastrukturës ushtarake etj. Kontrolli mund të jetë i jashtëm, ose i brendshëm. Në kontrollin e jashtëm futet kontrolli parlamentar, kontrolli i lartë i shtetit, inspektimet e ndryshme, avokati i popullit, kontrolli në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat ndërkombëtare për realizimin e objektivave të përbashkëta etj. Ndërsa kontrolli i brendshëm përfshin inspektimet dhe verifikimet e ndryshme, auditet, kontrolli për fusha dhe aspekte të veçanta, të cilat bëhen të strukturuar me plane konkrete, në përfundim të të cilave përgatiten raporte për pasqyrimin e gjendjes dhe rekomandimet për përmirësimin e tyre.

Si është rregulluar mobilizimi ushtarak dhe shërbimi alternativ në vende të ndryshme?

Mobilizimi ushtarak dhe shërbimi alternativ në vende të ndryshme është i ndryshëm. Pikë së pari kjo varet nga forma e qeverisjes në këto vende, shtete demokratike, apo autokratike. Edhe vendi ynë kaloi nga një sistem totalitar para viteve '90 në një vend demokratik pas këtyre viteve. Mobilizimi ushtarak është i sanksionuar me ligj dhe bëhet në kushte të caktuara të gjendjes së jashtëzakonshme, apo të luftës. Ndërsa shërbimi alternativ është një mundësi që u jepet shtetasve të kryejnë shërbimin ushtarak në kushte më lehtësuese dhe jo drejtpërdrejt me armë. Shumica e vendeve përfshijnë në ligj të drejtën e qytetarëve për të mos pranuar të mbajnë armë, domethënë kundërshtimin e ndërgjegjshëm dhe mundësinë e kryerjes së shërbimit alternativ. Këtu futen puna në institucionet e ndihmës shoqërore siç janë spitalet, infermieritë, institucionet për njerëzit me aftësi të kufizuara etj., dhe nganjëherë në organizatat jo qeveritare, apo ato ndërqeveritare etj.

Cilat rrethana e justifikojnë fshehtësinë?

Transparenca dhe informimi i publikut mbeten parime bazë të punës së strukturave të sigurisë. Në të njëjtën kohë mbrojtja e të drejtave të njeriut, ruajtja e privatësisë, ruajtja e raportit midis sigurisë publike dhe sigurisë së individit janë elementë të rëndësishëm të punës së forcave të sigurisë. Fshehtësia është e lidhur drejtpërsëdrejti me sigurinë e vendit dhe sigurinë publike. Në demokraci, shërbimet e fshehta të informacionit kërkohen të jenë efektive, asnjëherë, t'i përmbahen etikës profesionale, dhe të veprojnë brenda mandatit të tyre të ligjshëm. Vetëm në këto rrethana ajo mund të justifikohet në veprimet e ndërmarra në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

INTERVISTË ME KOLONELE MAJLINDA SALLAKUN

Familjet ushtarake, histori suksesi dhe sakrifice

Intervistoi:
Shefe e Sektorit të Botimeve
Anjeza Musollari

Majlinda Sallaku, vajza nga qyteti i bukur i Çorovodës, vendosi të ndjekë Akademinë Ushtarake "Skënderbej", si ëndërr të hershme të fëmijërisë së saj.

Majlinda përfundoi me arritje të larta studimet, dhe nisi jetën si ushtarake, ku njëkohësisht do të gjente dhe dashurinë e saj të përjetshme, bashkëshortin dhe babanë e fëmijëve të saj. Përkrah bashkëshortit të saj, (të ndjerit) gjeneral Ndrëhim Sallakut, ata do të vazhdonin udhëtimin e tyre jetësor dhe profesional mes dashurisë dhe sfidash.

Që prej ditës së parë kur veshi uniformën e deri sot ajo ngelet e shenjtë në familjen e tyre. Majlinda, duke iu përkushtuar me dashuri profesionit të zgjedhur, punës së palodhur, ngjiti shpejt, me meritë shkallët e karrierës. Pasi kreu Akademinë e Luftës të Forcave Tokësore në Stamboll vazhdoi të përfaqësojë diplomacinë ushtarake të Shqipërisë në Republikën e Turqisë. Rasti i Majlindës e bashkëshortit të saj, gjeneral Ndrëhim Sallakut është një ndër shembujt më të bukur, më domethënës, kur çifti ka ndjekur hap pas hapi njëri-tjetrin, duke u kuptuar dhe mbështetur pa kushte, sepse profesioni që zgjedhën është profesion që kërkon sakrificë edhe në jetën familjare.

Dhe jeta ushtarake e tyre ka kaluar përmes sprovas, mungesash të gjata, apo edhe festime ditëlindjesh të munguara. Vështirësi që nuk i stepën, vështirësi që i motivuan të jenë ku ishte detyra, aty ku flamuri i Shqipërisë duhet të valëvitet krenar.

Sot kolonele Majlinda vazhdon aktivitetin e saj, me dinjitet dhe përkushtim si përfaqësuese e diplomacisë ushtarake të Shqipërisë, në shtetin turk, por sot pa këshilltarin e saj profesional, pa shokun e sfidave, pa babanë e fëmijëve të saj, pa gjysmën e saj më të mirë. Por e fortë dhe dinjitoze ajo vazhdon përpara për familjen dhe detyrën ndaj atdheut, për



të cilën të dy bashkëshortët Sallaku iu përkushtuan me dashuri dhe devotshmëri.

Për të folur për një pjesë të jetës dhe profesionit ushtarak vjen për lexuesit në një intervistë ndryshe kolonele Majlinda Sallaku.

Si nisi rrugëtimi juaj drejt uniformës ushtarake?

U lindi në Berat, dhe u rrita me shumë dashuri dhe përkushtim të madh nga prindërit e mi në qytetin e bukur të Corovodës, në një familje me tre fëmijë. Pasi përfundova gjimnazin "Ramiz Aranitasi", duke menduar të rrezikoj dhe asnjëherë të mos frikësohesha dhe familja ime të ndihej krenare për mua, 33 vite më parë në moshën 18-vjeçare nisi rrugëtimi im drejt uniformës ushtarake, rrugë e gjatë plot sfidë e sakrifica.

A ishte një ëndërr e juaja kjo?



Gjithmonë më ka pëlqyer të thyej atë akullin e hershem për femrat, ku profesioni ndahej në "profesion për burra" dhe "profesion për gra". Ishte ky një motivim dhe një ide e guximshme për kohën, ku duhet të përballeshe me sfidën që jeta mund të të sillte përpara. Veshja e uniformës ushtarake ishte një ëndërr, jo vetëm e imja, por e gjithë atyre vajzave që e shikonin uniformën si simbol krenarie, si një pjesë e rëndësishme e të qenit ushtarak dhe në profesionin e ushtarakut.

Sa e vështirë ishte të gjeje veten në një ambient ku përqindja e meshkujve është në raport të zhdrejtë me atë të femrave?

Asokohe ishte krijuar ideja që ushtria ishte vetëm për djem, duke qenë se përqindja e meshkujve ushtarakë ishte në raport të zhdrejtë me atë të femrave, vështirësitë ishin më të dukshme. Ishte ideja e femrave të dobëta fizikisht, që nuk ishin të përgatitura për ushtri, gjë e cila nuk ishte e vërtetë.

Ne ishim partnerë të barabartë me meshkujt, ne na bashkonte

qëllimi, pasioni, sakrifica, që të arrinim të bëheshim ushtarakë të suksesshëm, pa dallim gjinie.

Si ndihet një femër nën uniformën e gjelbër?

Për mua një femër nën uniformën e gjelbër nuk përbën aspak vështirësi, por një privilegj. Është nder por edhe një sakrificë.

A është sukse si i saj tek durimi, që ajo ka më shumë se mashkulli? Çfarë ka një femër më të fortë se një mashkull?

Që të jesh ushtarak i suksesshëm një nga karakteristikat duhet të jetë durimi, por nuk mendoj që sukse si i një vajze ushtarake në krahasim me një mashkull është vetëm tek durimi. Këmbëngulja për të arritur qëllimet është një "armë" në duart e një femre të fortë.

Sipas jush, cilat janë parimet në drejtim të suksesit për një grua bashkëkohore?

Mendoj që parimet në drejtim të suksesit për një grua janë ADN e suksesit, themeli mbi të cilin çdo grua duhet të mbështetet. Morali, performanca, përgjegjshmëria, besi-

mi tek ajo që do të arrish, guximi tek ajo që beson, duke mos u tërhequr, duke u mbështetur fort tek familja, kanë qenë parimet e mia.

A është objektivizmi i grave një përditshmëri reale?

Mendoj se po, përpjekja për të vendosur një "status quo", atë të të quajturit profesionist, ka bërë që shumë vajza, gra apo nëna të kenë karrierë të shkëlqyer në të gjitha fushat: ekonomi, inxhinieri, arsim, mjekësi, shkencë, politikë, pse jo dhe në ushtri.

Cilat janë sfidat me të cilat një grua duhet të përballë në jetën sociale, për të ruajtur ekuilibrat e saj në jetën private dhe profesionale?

Unë, si ndër të shumtat gra që kanë veshur rrobat e ushtarakes, jam munduar të ruaj ekuilibrat në jetën private dhe profesionale.

Misioni i të qenit nënë është sfida më e madhe, të qenit të dy të profesionit ushtarak është një sfidë akoma më e madhe, ndarjet e gjata me Çimin, bashkudhëtarin e jetës sime, në misione dhe shpesh udhëtimet e papritura, puna pa orare, e unë e vetme të përmbushja me sukses rritjen dhe edukimin e fëmijëve, të përballesha me problemet shtëpiake, e më pas me paragjykimet e njerëzve: "...pse ti rri vetëm këtu?", e të tjera si këto. Unë mendoj se të duash familjen në të gjitha dimensionet duhet të sakrifikosh dhe për mua sakrifica është sfida e madhe.

Sot, që bashkëshorti im nuk jeton më midis nesh, unë kam arritur të kuptoj që përgjegjësia e veprimeve të mia ka qenë ekuilibruese dhe profesionale.

Cilat mendoni se kanë qenë arritjet më të mëdha gjatë këtyre viteve?

Gjatë këtyre viteve kam shënuar arritje të mëdha si në aspektin personal dhe në atë profesional, të cilat më bëjnë sot më shumë se kurrë të jem krenare. Unë dhe bashkudhëtarin e jetës time, si fryt i dashurisë, krijuam familjen tonë të mrekullueshme, aty unë shikoj gjithë përkushtimin, sakrificën e bashkëshortit tim dhe timen, të fëmijëve të mi, që u rritën, u edukuan dhe ecën duke u bërë pjesë e pandarë e sakrificës sonë në profesionin e vështirë të ushtarakut. Unë jam krenare për këtë.

Në aspektin profesional, arritjet janë fryt i sakrificave dhe përkushtimit 30-vjeçar, unë udhëhiqem nga parimi "yes I can" dhe mendoj se përfshirja e një femre në drejtime, në vendimarrje, në diplomaci është një nga arritjet më të mëdha, që me profesionalizëm jam munduar të mbroj interesat ushtarake dhe të sigurisë së vendit.

Po sfida juaj më e madhe?

Realizimi i të gjitha shkallëve të karrierës ushtarake, plotësimi i detyrës kombëtare, kjo e lidhur ngushtësisht me sfidën e bashkëshortit tim, i cili gjithë jetën ia kushtoi ushtrisë. Sfidë që përpjekjet e tij të bëhen realitet, që familja jonë të jetë gjithmonë e bashkuar, me çdo lloj sakrifice dhe përkushtimi, ashtu si gjithmonë, pasqyrë e të gjithë asaj që ne ëndërruam, besuam, ndërnuam dhe transmetuam së bashku.

Një vit pa bashkëshortin tuaj, babanë e fëmijëve, humbje të tilla e tjetërsojnë jetën, si kanë qenë për ju ditët pa praninë e "shtyllës së familjes"?

Situatë e trishtë, dhimbje shkatërruese për mua dhe familjen time. U pushtova nga pikëllimi, jeta më përballi me goditje e stuhi të madhe, Çimi për mua nuk ishte vetëm bashkëshort, por bashkunderhytar, shok, e gjithçka në jetë.

A keni mundur të ktheni dhimbjen në forcë, kjo dhe për faktin se jeni forca e tre fëmijëve tuaj Klezia, Mandri dhe Ejona, të cilët, si çdo fëmijë, duan buzëqeshjen e ngrohtë të nënës së tyre?

Jam mjaft e vetëdijshme për faktin e pamohueshëm që jeta ka një fund për çdo qenie njerëzore, por largimi i tij i papritur më ka lënduar shumë. Pas humbjes së njeriut më të çmuar në jetën time, jam përpjekur të jem e fortë para tre fëmijëve të mi, duke marrë frymë thellë...

Tani po përballem me një sfidë akoma më të madhe, atë të gjetjes së forcës së nevojshme për të mbajtur dhe vazhduar me vendosmëri çdo gjë që arritëm dhe do të arrinim së bashku. Këtë do ta bëj si nënë e tre fëmijëve, motiv ky për të qëndruar e fortë dhe për të arritur objektivat që kishim së bashku. Ishte, është dhe do të jetë njeriu më i rëndësishëm për mua, familjen dhe shoqërinë. Jam krenare për të.

Ëndrra e një nënë në karrierë për fëmijët e saj, është përm-bushur?

Përmbushja e ëndrrës së një nënë për fëmijët nuk është më një ëndërr, falë përkushtimit tim dhe shokut tim të jetës, është tashmë një realitet ku plotësohet çdo ditë dhe jam shumë krenare për këtë.

Familja Sallaku do vazhdojë ta trashëgojë uniformën ushtarake?

Siç e thashë edhe më lart, unë jam nënë e tre fëmijëve Klezia, Mandri dhe Ejona. Klezia ka studiuar për

dhe mami, do bëhem ushtarake që të plotësoj ëndrrën time dhe në të njëjtën kohë të vazhdoj në rrugën e lënë përgjysmë nga babi.

Mesazhi juaj për të gjitha vajzat e reja që aspirojnë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura?

Profesioni i ushtarakut është tepër fisnik e i vështirë, bart sakrificë dhe rreziqe për të cilat duhet të jemi gjithmonë të përgatitur. Është shumë i vështirë, sidomos për vajzat dhe gratë në uniformë, por me durim, guxim, përkushtim dhe



marrëdhënie ndërkombëtare, ndër-sa Mandri ka studiuar për turizëm. Ejona, vajza jonë e vogël shpesh herë thotë: "unë do bëhem si babi

vendosmëri i arrin objektivat për të qenë i suksesshëm në jetë.

Zgjidhni me zemër këtë profesion dhe përpikuni të shihni pozitivet në gjithçka!

"Shembeni këtë mur!"

NGA PETER ROBINSON

(Si e kundërshtuan këshilltarët kryesorë sfidën e Reganit ndaj Gorbaçovit - por dolën të humbur)

"Pas meje qëndron një mur që rrethon sektorët e lirë të këtij qyteti, pjesë e një sistemi të gjerë pengesash që ndan të gjithë kontinentin e Europës. . . Duke qëndruar para portës së Brandenburgut, çdo njeri është një gjerman, i ndarë nga njerëzit e tjerë. Çdo njeri është një berlinez, i detyruar të shikojë një plagë... Për sa kohë që kjo portë është e mbyllur, për sa kohë që kjo plagë e një muri lejohet të qëndrojë, nuk është vetëm çështja gjermane ajo që mbetet e hapur, por çështja e lirisë për të gjithë njerëzimin...

Sekretar i Përgjithshëm Gorbaçov, nëse kërkon paqe, nëse kërkon prosperitet për Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, nëse kërkon liberalizim, eja këtu te kjo portë.

Zoti Gorbaçov, hape këtë portë!

Zoti Gorbaçov, prishe këtë mur!"

(Nga fjala e Ronald Reagan, në Portën e Brandenburgut, 12 qershor 1987)

Në prill të vitit 1987, kur më caktuan të shkruaj fjalimin, ishin duke u zhvilluar festimet për 750-vjetorin e themelimit të Berlinit tashmë. Mbretëresha Elizabeth e kishte vizituar tashmë qytetin. Mikhail Gorbachev do të pritej brenda pak ditësh.

Edhe pse Presidenti nuk kishte planifikuar të vizitonte vetë Berlinin, ai do të ishte në Europë në fillim të qershorit, fillimisht për të vizituar Romën, më pas për të kaluar disa ditë në Venecia për një samit ekonomik. Me kërkesë të qeverisë së Gjermanisë Perëndimore, orari i tij u rregullua për t'i lejuar të ndalonte në Berlin për disa orë gjatë kthimit nga Italia për në Shtetet e Bashkuara.

Më thanë vetëm se Presidenti do të fliste në Murin e Berlinit, se ai kishte të ngjarë të tërhiqte një audiencë prej rreth 10 000 dhe se, duke pasur parasysh mjedisin, ai ndoshta duhet të fliste për politikën e jashtme.

Më vonë, atë muaj kalova një ditë e gjysmë në Berlin me ekipin e avancuar të Shtëpisë së Bardhë përpara ardhjes së Presidentit, ekspertë të logjistikës, agjentë të Shërbimit Sekret dhe zyrtarë të shtypit, të cilët shkonin në vendin e çdo vizite presidenciale për të bërë rregullimet përkatëse. Gjithçka që duhej të bëja në Berlin ishte të gjeja material për fjalën e Presidentit. Kur takova diplomatin e amerikan të rangut të lartë në Berlin, supozova se do të më jepte diçka.

Një burrë trup-shëndoshë dhe me syze të trasha, diplomati dukej i shqetësuar e i hutuar gjatë gjithë bisedës sonë, sikur vetë perspektiva e një vizite nga Ronald Reagan e bënte nervoz. U ndal në disa udhëzime të imta, por pothuajse të gjitha "çfarë nuk duhej", pra, plot me ide për çka Presidenti nuk duhet të thoshte. Më informoi se, berlinezët perëndimorë, me prirje më të majta nga të gjithë gjermano-perëndimorët, ishin intelektualisht dhe politikisht të sofistikuar. Prandaj, Presidenti do të duhet të kishte kujdes. Asnjë goditje e gjoksit. Asnjë përplasje sovjetike. Dhe asnjë deklaratë nxitëse për Murin e Berlinit. Berlinezët perëndimorë, shpjegoi diplomati, ishin mësuar prej kohësh me strukturën që i rrethonte.

Pasi u ndava nga diplomati, disa anëtarëve të ekipit dhe mua na bënë një fluturim mbi qytet me një helikopter të ushtrisë amerikane. Edhe pse gjithçka që ka mbetur nga ai mur sot (2003) janë thjesht

gurë shtrimi që tregojnë se ku qëndronte, në 1987 struktura që dominonte Berlinin. I ngritur në vitin 1961 për të frenuar rrjedhën e gjermano-lindorëve që kërkonin t'i shpëtonin sistemit komunist duke ikur në Berlinin Perëndimor, muri, 3.6 m i gjatë, rrethoi plotësisht Berlinin Perëndimor. Nga ajri, muri dukej se ndante dy mënyra të ndryshme të ekzistencës.

Në njërin anë të murit shtrihej lëvizja, ngjyra, arkitektura moderne, trotualet e mbushura me njerëz, trafiku. Nga ana tjetër shtrihej një lloj zbrazëtie. Ndërtesat shfaqnin ende shenja nga granatimet gjatë luftës. Makinat dukeshin të pakta dhe të rrënuara, këmbësorët të veshur keq. Kur helikopteri qëndroi pezull mbi Burgun Spandau, strukturën e rrëmujshme me tulla në të cilën Rudolf Hess ishte ende i burgosur, ushtarët me pushkë mbi supe në postet e rojeve të Gjermanisë Lindore përtej burgut, na ngulën sytë nga dylbitë. Vetë muri, i cili nga Berlinit Perëndimor ishte dukur një strukturë e thjeshtë betoni, ana e Berlinit Lindor e veshur me poste roje, vrapime qensh dhe rresht pas rreshti me tela me gjemba u shfaq nga ajri si një kompleks i ndërlikuar. Piloti na tërhoqi vëmendjen te gropat e zhavorrit të gërmuar. Nëse një roje gjermano-lindore do të linte dikë t'i kalonte për t'u arratisur në Berlinin Perëndimor, na tha piloti, roja do të detyrohej t'i shpjegonte gjurmët komandantit të tij.

Atë mbrëmje, u shkëputa nga ekipi i avancuar për t'u bashkuar me një duzinë berlinezë për darkë. Mikpritësit tanë ishin Dieter dhe Ingeborg Elz, të cilët ishin tërhequr në Berlin pasi Dieter përfundoi karrierën e tij në Bankën Botërore në Uashington, D.C. Edhe pse nuk ishim takuar kurrë, kishim miq të përbashkët dhe Elz ishte ofruar për të organizuar

këtë darkë për të dhënë një ndjenjë për qytetin e tyre. Ata kishin ftuar berlinezë të sferave të ndryshme të jetës dhe pikëpamjeve politike - biznesmenë, akademikë, studentë, shtëpiakë.

Ne biseduam për një kohë për motin, verën gjermane dhe koston e banimit në Berlin. Më pas tregova atë që më tha diplomati, duke shpjeguar se pas fluturimit tim mbi qytet atë pasdite e kisha të vështirë ta besoja. "A është e vërtetë?" - e pyeta. "A jeni mësuar me murin?"

Elz dhe të ftuarit e tyre i hodhën sytë njëri-tjetrit të shqetësuar. Mendova se e kisha dëshmuar veten si një amerikan i pacipë dhe pa takt në atë masë sa diplomati kishte frikë se edhe Presidenti mund të dukej i tillë. Pastaj një burrë ngriti dorën dhe tregoi me gisht. "Motra ime jeton njëzet milje në atë drejtim", -tha ai. "Unë nuk e kam parë atë për më shumë se dy dekada. Mendon se mund të mësohem me këtë?", -foli edhe një tjetër. "Çdo mëngjes në rrugën e tij për në punë - shpjegoi ai, -kaloja pranë një kulle roje. Çdo mëngjes, një ushtar më shikonte me dylbi. Ai ushtar dhe unë flasim të njëjtën gjuhë. Ne ndajmë të njëjtën histori. Por njëri prej nesh është kujdestar i kopshtit zoologjik dhe tjetri është një kafshë, dhe kurrë nuk jam i sigurt se cila është cila".

Ezonja e shtëpisë shpërtheu. Një grua e hirshme, ajo papritmas ishte zemëruar. Fytyra e saj ishte skuqur. Bëri grusht njëren dorë dhe e goditi në pëllëmbën e tjetrës. "Nëse ky Gorbaçovi është serioz me fjalët e tij për glasnost dhe perestrojkën, -tha ajo, -ai mund ta provojë këtë. Ai mund ta heqë qafe këtë mur".

Duke u kthyer në Shtëpinë e Bardhë, i thashë Tony Dolan, në atë kohë drejtor i shkrimit të fjalimeve presidenciale, se kisha ndërmend të përshtatja komentin e Ingeborg Elz, duke i bërë thirrje për të shembur Murin e Berlinit si pasazh qendror të fjalimit. Toni më mori me vete për te drejtori i komunikimit, Tom Griscom, për t'ia paraqitur atij idenë. "Të dy juve duhet të mendonit dhe të punonit shumë për të më penguar të them jo, -thotë Griscom, -por kur më treguat për udhëtimin, veçanërisht për çka keni

mësuar nga disa gjermanë se sa shumë e urrenin murin, mendova me vete: "E dini, duke bërë thirrje që muri të shembet, thjesht mund të funksionojë".

Kur u ula të shkruaja, do të doja të isha në gjendje të them se e gjeta veten aq të frymëzuar sa fjalët thjesht më erdhën vetë. Por nuk ndodhi kështu. "Zoti Gorbaçov, prishe këtë mur!" As që mund ta kuptoja si duhet. Në një draft shkrova: "Zotëri Gorbaçov, rrëzoje këtë mur!", duke përdorur fjalën "zotëri" sepse mendova disi se kjo do t'i pëlqente audiencës gjermane të Presidentit dhe do ta "rrëzonte" sepse ishte e vetmja folje që më erdhi në mendje. Në draftin tjetër kam ndërruar "rrëzoje" me "hiq", duke shkruar: "Zotëri Gorbaçov, hiqe këtë mur", sikur të ishte një lloj përmirësimi. Deri në fund të javës nuk kisha bërë asgjë tjetër veç një draft të parë, edhe pse e konsideroja banal. Unë ende mund të dëgjoja kërcitjet e çizmeve kauboj të Tony Dolan-it ndërsa ai ecte nëpër korridor nga zyra e tij në timen për ta hedhur atë draft mbi tavolinën time.

"Nuk është mirë", -tha Toni.

"Çfarë nuk shkon me të?", -e pyeta.

"Sapo të thashë. Nuk është mirë."

Javën në vijim punova një draft të pranueshëm. Kishte nevojë për përpunim, pjesa për reduktimin e armëve, për shembull, duhej ende të plotësohej, por ai përcaktoi elementët kryesorë të fjalimit, duke përfshirë sfidën për të shembur murin. Të premten, më 15 maj, fjalimet për udhëtimin e Presidentit në Romë, Venecia dhe Berlin, përfshirë draftin tim, iu përcollën Presidentit dhe të hënën, më 18 maj, fjalim-shkruesit iu bashkuan Presidentit në Zyrën Ovale. Fjalimi im ishte i fundit që diskutuam. Tom Griscom i kërkoi Presidentit komentet e tij mbi draftin tim. Presidenti u përgjigj thjesht se i pëlqente.

"Zoti President, - i thashë, - në udhëtimin paraprak mësova se fjalimi juaj do të dëgjohet jo vetëm në Berlinin Perëndimor, por

në të gjithë Gjermaninë Lindore. Në varësi të kushteve të motit, shpjegova, radiot do të ishin në gjendje ta çonin fjalimin deri në lindje, Moskën vetë. A ka ndonjë gjë që dëshironi t'u thoni njerëzve në anën tjetër të Murit të Berlinit?"

Presidenti përkuli kokën dhe mendoj. "Epo, -u përgjigj ai, -është ai pasazhi për shembjen e murit. Ai mur duhet të bjerë. Kjo është ajo që do të doja t'u them atyre".

Kalova disa ditë duke u përpjekur të përmirësoja të folurit. Unë supozoja se duhet të pranoj se në një moment e kam nxjerrë në të vërtetë "Z. Gorbaçov, shemb këtë mur", duke e zëvendësuar me sfidën, në gjermanisht, për të hapur Portën e Brandenburgut, "Zotëri Gorbaçov, machen Sie dieses Tor auf" (Hape këtë portë).

"Përse e bërë atë?", -pyeti Toni.

"Do të thotë që nuk e kupton?" -iu përgjigja. "Meqenëse audienca do të jetë gjermane, Presidenti duhet t'i thotë në gjermanisht idetë e mëdha."

"Piter, -tha Toni, duke tundur kokën, -kur jeni duke shkruar për Presidentin e Shteteve të Bashkuara, jepini atij në anglisht idenë e tij të madhe". Toni futi përsëri shprehjen dhe idenë siç ishte: "Z. Gorbaçov, shembe këtë mur".

Tre javë para mbajtjes së tij, fjalimi iu shpërnda Departamentit të Shtetit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Të dy u përpoqën ta shuanin atë. Ndihmës sekretari i shtetit për çështjet e Europës Lindore e sfidoi fjalimin me telefon. Një anëtar i lartë i stafit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare protestoi kundër fjalimit. Diplomati i rangut amerikan në Berlin e kundërshtoi fjalimin me kablo. Drafti ishte naiv. Do të krijonte shpresa të rreme. Ishte i patakt. Ishte provokues pa nevojë. Departamenti i Shtetit (Ministria e Punëve të Jashtme) dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare dorëzuan draftet e tyre alternative, në ditarin tim shënohet se nuk ishin më pak se shtatë, duke përfshirë një të tillë, shkruar nga diplomati në Berlin. Në secilën prej tyre mungonte thirrja për të shembur murin.

Në parim, Departamenti i

Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare nuk kishin asnjë kundërshtim ndaj thirrjes për shkatërrimin e murit. Drafti i paraqitur nga diplomati në Berlin, për shembull, përbante rreshtin: "Një ditë, ky mur i shëmtuar do të zhduket". Nëse linja e diplomatit ishte e pranueshme, fillimisht pyesja veten, çfarë nuk shkante me timen? Pastaj pashë edhe një herë linjën e diplomatit. "Një ditë?" Një ditë edhe luani do të shtrihej me qengjin, por ju nuk do të donit të mbanit frymën. "Ky mur i shëmtuar do të zhduket?" Çfarë do të thoshte kjo? Se muri do të ngrihej dhe do të rrëzohej vetë? Muri do të zhdukej vetëm kur sovjetikët ta rrëzonin ose të linin dikë tjetër ta rrëzonte për ta, por "ky mur i shëmtuar do të zhduket" e injoroi fare çështjen e veprimit njerëzor. Ajo që Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare po thoshin, në fakt, ishte se Presidenti mund të vazhdonte dhe të bënte një thirrje për shkatërrimin e murit, por vetëm nëse ai përdorte një gjuhë kaq të paqartë dhe eufemiste, sa të gjithë mund ta kuptonin menjëherë se në fakt ai nuk do të thoshte atë.

Javën që Presidenti u nis për në Europë, Tom Griscom filloi të më thërriste në zyrën e tij sa herë që Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare parashtrojnë një kundërshtim të ri. Çdo herë, Griscom më kërkoi t'i tregoja atij pse besoja se Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare ishin gabim dhe se fjalimi, siç e kisha shkruar unë, ishte i drejtë. Kur arrita në zyrën e Griscom në një rast, gjeta Colin Powell, në atë kohë Zëvendës Këshilltar për Sigurinë Kombëtare, duke më pritur. Unë isha një 30-vjeçar që nuk kisha pasur kurrë një punë me kohë të plotë jashtë shkrimit të fjalimeve. Powell ishte një gjeneral karriere. Pasi dëgjova Powell-in të recitonte të gjitha argumentet kundër fjalimit në mënyrën e tij të mësuar me forcë, megjithatë, dëgjova veten duke recituar të gjitha argumentet në favor të fjalimit në një mënyrë po aq të fuqishme. Mezi mund ta besoja tonin tim të zërit. Powell dukej ca i befusuar dhe i

tërhequr.

Disa ditë përpara se Presidenti të nisej për në Europë, Tom Griscom mori një telefonatë nga shefi i shtabit, Howard Baker, duke i kërkuar Griscom të shkonte në zyrën e tij. Unë hyra brenda dhe ishin senatori Baker (Baker kishte shërbyer në Senat përpara se të bëhej Shef i Stafit) dhe Sekretari i Departamentit të Shtetit, vetëm ata të dy. Sekretari i Departamentit të Shtetit George Shultz e kundërshtoi fjalimin. Ai tha: "Unë me të vërtetë mendoj se linja për shembjen e murit do të jetë një fyerje për zotin Gorbaçov", -kujton Griscom. "I thashë atij se fjalimi duhet të kishte një shenjë në këtë pjesë. 'Zoti Sekretar', -i thashë, -Presidenti ka komentuar për këtë linjë-ide të veçantë dhe ai është i kënaqur me të. Dhe mund t'ju pretoj se kjo linjë do të ketë jehonë". Sekretari i Shtetit qartësisht nuk ishte i lumtur, por e pranoi. Mendoj se kjo e mbylli temën.

Nuk ndodhi kështu.

Kur grupi udhëues arriti në Itali (unë mbeta në Uashington), Sekretari i Departamentit të Shtetit e kundërshtoi fjalimin edhe një herë, këtë herë Zëvendëshefit të Kabinetit Kenneth Duberstein. "Shultz mendoi se linja ishte shumë e ashpër ndaj Gorbaçovit", -thotë Duberstein. Më 5 qershor, Duberstein e uli Presidentin në kopshtin e pasurisë ku ai po qëndronte, e informoi për kundërshtimet ndaj fjalimit, më pas i dha një kopje të fjalimit, duke i kërkuar që të rilexonte pasazhin qendror.

Reagan kërkoi këshillën e Duberstein. Duberstein u përgjigj se ai mendonte se linja për shembjen e murit dukej e mirë. "Por unë i thashë atij: Ti je President, kështu që duhet të vendosësh, dhe më pas, -kujton Duberstein, -ai, me atë buzëqeshjen e tij të mrekuellueshme të njohur në fytyrën e tij, tha: "Le ta lëmë siç është".

Ditën që Presidenti mbërriti në Berlin, shteti dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare paraqitën një draft tjetër alternativ. "Ata ishin ende kështu pikërisht në mëngjesin e fjalimit", -thotë Tony Dolan. Nuk do ta harroj kurrë, megjithatë, në

limuzinë në rrugën për në Murin e Berlinit, Presidenti i tha Duberstein se ishte i vendosur të jepte pikërisht linjën e diskutueshme dhe shtoi duke buzëqeshur: "Çunat në Departamentin e Shtetit do më vrasin, -tha ai, -por kjo është gjëja e duhur për të bërë."

* * *

Ekziston një shkollë mendimi sikur Ronald Reagan arriti të dukej mirë vetëm sepse kishte fjalimshkrues të zgjuar që i vendosnin fjalët në gojë. Por Jimmy Carter, Walter Mondale, Bob Dole dhe Bill Clinton kishin të gjithë shkrimtarë të zgjuar.

Pse kishte vetëm një Komunikues të Madh?

Sepse fjalim-shkruesit e Ronald Reganit nuk përpiqeshin kurrë të fabrikonin imazh, vetëm për të prodhuar një vepër që përputhej me standardin që vetë Regani kishte krijuar tashmë. Politikat e tij ishin të qarta. Ai i kishte artikuluar ato për dekada, derisa u bë President, ai shkroi vetë shumicën e materialit të tij.

Kur dëgjova Frau Elz-in të thoshte se Gorbaçovi duhet të hiqte qafe murin, e kuptova menjëherë se Presidenti do t'i ishte përgjigjur vërejtjes së saj. Dhe kur Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare u përpoqën të bllokonin draftin tim duke paraqitur drafte alternative, ata e dobësuan çështjen e tyre. Fjalimet e tyre ishin të zbehta. Ata ishin burokratikë. Atyre u mungonte bindja. Njerëzit që i shkruan ato nuk kishin vjedhur, si unë, nga Frau Elz dhe nga Ronald Reagan.

Peter Robinson, autor dhe ish-shkrues i fjalimeve të Shtëpisë së Bardhë, është anëtar në Institutin Hoover në Universitetin e Stanfordit. Në 1983, Robinson iu bashkua stafit të Presidentit Ronald Reagan, duke shërbyer pothuajse pesë vjet si shkrimtar fjalimesh dhe asistent special i Presidentit, një përvojë që ai e rrëfen në librin e tij të vitit 2003, "Si Ronald Regani ndryshoi jetën time". Robinson i dha shefit ekzekutiv më shumë se 300 fjalime, duke përfshirë fjalimin e Murit të Berlinit të vitit 1987.

Përshtati: Zeno Jahaj

Adnan Qatipi, antifashisti i orëve të para, komandant i Armës së Tankeve dhe udhëheqës i shquar i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it

Adnan Qatipi është vlerësuar me shumë urdhra dhe medalje. Organizata e Veteranëve të LANÇ të Shqipërisë i ka dhënë titullin “Kryetar Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it”.



Nga Sali Onuzi

Adnan Qatipi lindi më 24 dhjetor 1925, në një ditë të acartë të dimrit, në Selanik, rrugës për në emigracion drejt Edrenesë, Turqi, ku familja ishte nisur tek të afërm të saj. Por lindja e tij dhe moti i keq, kish bërë që familja e Haxhi Qatipit të kthente mbrapsht për në Tiranë, ku ajo kish ardhur nga Dibra e madhe, e shpërngulur që më 1913, për t'u shpëtuar masakrave të ushtrisë serbe. Gjyshin e Adnanit, Bexhet Agollin, ish-kryetar i komunës së Dibrës, serbët e kishin masakruar në zyrën e tij, po atë vit.

Rritur me një rini plot halle e vështirësi ekonomike, ku babai punonte si telefonist i linjave të jashtme të Tiranës dhe e ëma, Firnetja ishte shtëpiake. Por vdekja e të atit, kur Adnani ishte vetëm 10 vjeç, ishte një goditje e rëndë për fëmijërinë e tij. Në ditët e para të prillit 1939 ai do të ishte pjesëmarrës në demonstratat e fuqishme në të cilat populli i thjeshtë, punëtor, nxënës e student, kërkonin armë për të kundërshtuar pushtimin fashist.

Pas 7 prillit 1939, e la përfundimisht shkollën, sado që e kish dashur shumë dhe kish qenë një nxënës i përparuar në mësimet. Kishte filluar punën si elektrikist (ku shpejt do të merrte titullin “usta”)

dhe ishte aktivizuar si i ri antifashist në grupet e punëtorëve. Në fund të tetorit 1941 arrestohet dhe vetëm më 16 shkurt 1942 del nga burgu. Po atë ditë vjen në lagjen “Xhamia Sherif” Gogo Nushi, udhëheqës i Lëvizjes së Luftës ANÇ në kryeqytet. E kish sjellë Myslym Keta, shoku i tij i fëmijërisë, rritur bashkë me Adnanin në një rrugicë, në një shkollë e punë si elektrikist. Të dy do të merrnin pjesë në të njëjtin grup edukativ dhe po bashkë në të njëjtin njësit gueril të kryeqytetit, siç do të shkonin bashkë të pandarë në aksione e luftime. Ata të dy do të përbënin një çift guerilësh, trima, të guximshëm dhe të suksesshëm. Ku ish njëri, ish dhe tjetri.

Të dy bashkë me Lym Ketën (Hero i Popullit) dhe katër të tjerë, në fund të tetorit 1942 u dërguan në zonën e Dajtit (Tujan-Qafë Krrabë) ku me një punë ilegale intensive (natën në shtëpinë e fshatarëve e ditën në pyll), duke lëvizur një nga një e dy nga dy, e duke iu shmanjur post-komandave të shumta në Linëz, Lanabregas, Priskë dhe Ibë, bashkë me të tjerë, arritën të krijonin çetën e parë partizane të zonës që në fillim të vitit 1943 dhe më 23 gusht edhe batalionin “Dajti”, në të cilin Adnan Qatipi do të caktohej Komisari i njësitit të tretë të tij me komandant Shemsi Hakën, dëshmor i atdheut, të cilin e kujtonte gjithnjë me respekt të madh dhe se hiqte nga goja.

Që prej andej, nga Dajti, Adnan Qatipi, Myslym Keta dhe shokët e tyre, me urdhër do të depërtonin ilegalisht në Tiranë e do të bënin aksione të panumërta që ngjallnin në popull shpresë për lëvizjen nacionalçlirimtare dhe frikë e panik të pa përshkuar në radhët e pushtuesve fashistë e të bashkëpunëtorëve të tyre. Po Adnan Qatipi, kur binte fjala për këto aksione,

skuqej dhe fliste vetëm për Myslym Ketën dhe shokët e tij.

Nga fundi i shtatorit 1943, Adnan Qatipi me Myslym Ketën dhe me 76 partizanë do të shkëputej nga batalioni "Dajti" për tu inkuadruar në fshatin Ballhaxhias të Pezës në Brigadën e III sulmuese, ku do të caktohej nënkomandant i batalionit të tretë. Ka qenë një kohë shumë e vështirë kur pushtuesit e rinj gjermanë sulmuan në befasi forcat partizane që po mbledheshin në zonën e Pezës për të përruar Brigadën e III sulmuese. Në kulmin e përlshjes me forcat partizane, gjermanëve u vjen një "përforsim" i ri prej 14 vetash, të cilët sapo arrijnë te mulliri hapin zjarr të befasishtë kundër forcave gjermane. Ishin Adnani, Myslymi, Sulejman Cenoieri, Hysen Manushi dhe shokët e tyre të veshur me uniformë gjermane, praktikë të cilën ata e kishin përforsuar gjatë luftës në kryeqytet. Në atë betejë të vërtetë nga forcat e Brigatës së 3-të sulmuese u vranë rreth 50 gjermanë. Herman Frank, komandanti i forcave gjermane në këtë operacion, e ka përshkruar këtë humbje si katastrofë të vërtetë.

Në luftimet e Arbanës Adnan Qatipi plagoset rëndë në krahun e majtë (ishte invalid i luftës dhe anëtar i kryesisë së shoqatës së invalidëve të LANC-it) dhe po atë ditë transportohet e futet ilegalisht në Tiranë për kurim. Pas 12 ditësh nëpërmjet Kavajës, Adnani i shoqëruar nga një prej shokëve të tij më të ngushtë, Qamil Poda (me të cilin do ta lidhnin gjithashtu Ushtria dhe veprimtari shoqërore, sidomos udhëheqja në krye të Komitetit Kombëtar të Veteranëve), arrijnë Brigadën në Pezë dhe marrin pjesë në luftime shumë të ashpra e tepër të vështira të saj për të çarë në qafën e Çismës, rrethimin e egër gjerman në fund të nëntorit 1943 dhe për të kaluar në zonën e Dajtit. Prej andej kryejnë një marrshim të gjatë në Lurë e Dibër të Poshtme dhe kthehen në Gurabardhë e Shëngjergj, në stanet e të cilit një grup i brigadës kaloi dimrin e vështirë. Veteranë e banorë pjesëmarrës në një veprimtari përkujtimore me rastin e 55-vjetorit janë dëshmitarë se me ç'fjalë zemre Ad-

nan Qatipi falënderoi gratë dhe burrat e Shëngjergjit për mbështetjen që ata i dhanë brigadës së tretë në ato ditë të rënda.

Në muajt e parë të vitit 1944 Br.3 sulmuese kalon në zonën e lirë



të Korçës, ku u kompletua dhe mori pjesë në përballimin e operacionit armik të qershorit 1944, duke operuar më sukses në Përmet, Këlcyre, Zagori etj. Në korrik Adnan Qatipi është me forcat e Brigadës që kalon Shkumbinin dhe vendoset në periferi të Tiranës, në anën e Dajtit, në fshatrat Priskë, Gurrë etj., prej nga ndërmarrin goditje e aksione të forta e të njëpasnjëshme në kryeqytet. Kthimi në territorin e luftës së kryeqytetit kish qenë për Adnanin, Lymin dhe shokët e tyre "guerilas" një kënaqësi e veçantë, që nuk do të zgjaste shumë, pasi Brigada e tyre do të merrte urdhër e do të marshonte drejt Matit e Lumës dhe, më 16 tetor 1944, do të çlironte Tropojën.

Me detyrën e zëvendëskomandantit të batalionit në Brigadën e 3 sulmuese, Adnan Qatipi, si gjithë partizanët e Brigadës do të kalonin kufirin shtetëror plot emocion dhe

do të merrnin pjesë në luftën për çlirimin e Kosovës nga Juniku, Peja e deri përtej në Senicë të Sanxhakut.

Nga fundi i vitit 1945 bashkë me Br.3s Adnan Qatipi kthehet në Korçë. Ishte vetëm 20 vjeç nga të cilët 6 vjet i kishte kaluar në LANC, dhe i kish kaluar me sukses, si rrallë kush, që prilli 1939, duke kaluar në të gjithë fazat e rritjes së tij nga grupet edukative, te njësitet guerile, te puna në terren, te çeta, batalioni e Brigada që nga partizan i thjeshtë e deri komandant batalioni. Kish provuar dhe burgun dhe plagosjen. Kish luftuar edhe në qytet edhe jashtë tij, edhe në jug edhe në veri, edhe në Shqipëri këndej Drinit dhe në atë, matanë Drinit. Ai ishte padyshim njëri nga heronjtë e gjallë të kësaj lufte, pavarësisht se titulli i "Heroit të Popullit" për çudi nuk jepej më pas vitit 1991.

Më 1945, Adnan Qatipi ka mbyllur njërin nga periudhat më të vështira e më heroike të jetës së vet dhe do të fillonte pas çlirimit atë të ushtarakut profesionist. Kish edhe ndryshime të gjendjes civile, ish fejuar dhe martuar me një shoqen e tij të luftës, Brankën, po aq e bukur, e vendosur, trime dhe e dashuruar pas tij. Ia kishin çuar në batalion si infermiere për të luftuar kundër tifos dhe kish mbetur e "tifosur" nga dashuria e komandantit të tij.

Edhe pas çlirimit Adnan Qatipi nuk u nda nga Ushtria. Pasi punoi në divizionin e 8-të në Korçë, si inspektor në vitet 1945-1947, shkon për studime të larta në Akademinë e tankeve në Bashkimin Sovjetik, të cilën e përfundoi me diplomë shkëlqyer.

Që në vitin 1951 emërohet komandant i regjimentit të takeve "Vojo Kushi" në Tiranë, ku u shqua për nivele të larta organizimi dhe drejtimi profesional, duke vënë njësinë në radhën e më të dalluarve në shkallë ushtrie, në disiplinë, në stërvitje e gatishmëri luftarake. Komandanti i regjimentit nuk shkëputej as vetë nga ushtrimet dhe stërvitja. Kërkues ndaj vetes dhe vartësve dhe shumë i dashur e i respektuar prej tyre. Ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, gjenerallejtënant Petrit Dume shkruan në karakteristikën e tij fjalët: "Oficer besnik, trim,

energjik dhe i ndershëm". Në vitet 1958-1960 dërgohet përsëri për studime jashtë shtetit.

Edhe kur u krijua Brigada e parë e Tankeve në vitin 1963, kolonel Adnan Qatipi do të ishte përsëri komandant i saj. Heqja e gradave në Ushtri më 1966, i hoqi edhe Adnan Qatipit mundësinë e yllit të merituar të gjeneralit. Më pas ai do të kalonte në Drejtorinë e tankeve në Ministrinë e Mbrojtjes me detyrën e drejtorit të saj. Me punën e tij shembullore, Adnan Qatipi ka qenë organizatori dhe drejtuesi i Armës së Tankeve të ushtrisë sonë për më shumë se një dekadë.

Në vitet 1969-1973 ai emërohet drejtor i Drejtorisë së Industrisë Ushtarake, ku dha një kontribut të shënuar për ngritjen e shumë uzinave mekanike si në Poliçan, Mjekës e në Gramsh, të cilat kanë luajtur një rol të madh në modernizimin e armatimit dhe të bazës materiale luftarake të ushtrisë sonë në ato vite.

Por jeta e Adnan Qatipit në Ushtri do të ndërpritej në mënyrë absurde nga një akt i padrejtë në vitin 1974, që e radhiste atë në të ashtuquajturën "kastë ushtarake" dhe e nxirrte jashtë radhëve të Ushtrisë. Po ai kudo që punoi edhe në terren, (drejtor i SMT në Lushnjë) shkëlqeu me punën e tij. Adnan Qatipi kishte një jetë në Luftë dhe në Ushtri. Asgjë nuk mund ta shkëpuste nga jeta e saj, të cilën ai e ndoqi më gjithë zemër e shpirt ndër dekada. Do të vinte dita, më 1997 dhe ky akt absurd do të shfuqizohej. Kjo nuk qe një rastësi. Në kohën e ringritjes së Ushtrisë shqiptare, Ministria e Mbrojtjes u kujtua që të korrigjonte edhe këtë padrejtësi.

Më 1981 Adnan Qatipi del në pension, por nuk do të shkëputej nga jeta e veprimtarit shoqëror. Ai ishte një figurë e njohur, e nderuar dhe e respektuar e shoqërisë civile shqiptare. Fjala e tij dëgjohej me vëmendje kudo ku ai ishte i pranishëm. Ai do të zgjidhej kryetar i Organizatës së Veteranëve të Tiranës dhe nënkryetar i Komitetit kombëtar, më 1997 edhe në Këshillin Bashkiak të kryeqytetit. Në fillim të viteve 1991 e më pas Adnan Qatipi me shokët Pirro Dodbiba e Qamil Poda, në krye të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it, do të bënin një punë të madhe për reformimin e kësaj organizate në kushtet e një shoqërie demokratike pluraliste, duke i dhënë asaj një rol të

rëndësishëm, të cilin ajo (me 30 mijë anëtarët e saj) e tregoi në luftën e vendosur për mbrojtjen e demokracisë e të zhvillimeve të shoqërisë shqiptare.

Në udhëheqje të Organizatës së Veteranëve të LANÇ, Adnan Qatipi ka bërë një punë të madhe për mbrojtjen e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, kundër çdo shtrembërimi të saj nga grupe të caktuara me prirje antihistorike, duke argumentuar në konferenca, mbledhje e takime, karakterin antifashist e atdhetar të LANÇ, kundër së ashtuquajturës "luftë civile", duke mbrojtur fort veprimtarinë politike e luftarake të formacioneve të Ushtrisë NÇ, duke përkujtuar me respekt datat historike të saj, në veçanti 29 nëntorin 1944, ditën e çlirimit, të cilin pushteti i atëherëshëm u përpoq ta denigronte deri në harrim. Aso kohe u bë e njohur edhe në Europë deklarata e fortë e Adnan Qatipit se: "Askush nuk mund ta fshijë kujtimin e luftës heroike të popullit tonë kundër fashizmit nga librat e historisë dhe nga kujtesa jonë. Askush nuk ka të drejtë ta bëjë këtë. Ne do të qëndrojmë besnikë ndaj traditës sonë antifashiste".

Për rreth një dekadë, prej vitit 2001 deri në vitin 2002, Adnan Qatipi ka punuar me pasion e ndershmëri për Statusin e Veteranit të LANÇ, me pjesëmarrjen e tij në hartimin e kërkesave të Organizatës për Statusin, në korrigjimin e mangësive të ligjit të Kuvendit Popullor deri në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, në ndihmën për Komisionin Qendror, Departamentin e Veteranëve dhe komisionet e rretheve.

Në vitin 2003, Adnan Qatipi u zgjodh në krye të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it, ku ai kontribui aq shumë. Ka qenë një gjetje shumë e rëndësishme dhe e bukur ideja e tij për institucionalizimin e Pasardhësit të Veteranit të LANÇ-it, që u mirëprit gjerësisht nga breza më të rinj, ide që fitoi shumë pikë edhe në organizatat ndërkombëtare të Veteranëve, si një nismë origjinale e veteranëve shqiptarë për të siguruar trashëgiminë atdhetare të veteranëve të LANÇ-it.

Me kohë veprimtaria e figura e Adnan Qatipit ishin bërë të njohura dhe për organizatat e veteranëve të Europës e më tej. Për kontributin e tij të shquar ai ishte zgjedhur anëtar i udhëheqjes së tyre e deri zëvendës president i FIR (Federata Internacio-

nale e Rezistencës). Në Kongresin e 15-të të saj, në janar 2010, Adnan Qatipi për meritat e tij u zgjodh anëtar i Kryesisë së Nderit të FIR-it.

I përkushtuar për të ndjekur jetën e shoqërisë shqiptare ai ishte një përfaqësues dhe një udhëheqës i shquar i veteranëve të LANÇ-it. Që herët Adnan Qatipi dhe shokët e tij prisnin në Tiranë, luftëtarët ilegalë të UÇK-së, të cilët i njihnin me Luftën ANÇ dhe ndiqnin me shpirt e zemër luftën e tyre heroike. Në mars 1999 Adnan Qatipi do të ishte nga iniciatorët dhe organizatorët e grupit të ish-gjeneralëve që vizituan Divizionin e Kukësit, duke dhënë një shembull me efekt moral të pazëvendësueshëm. Menjëherë pas Çlirimit të Kosovës, ai do të ishte në krye të një delegacioni të Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës, që do t'i dorëzonte Divizionit të Kukësit dhe komandantit të tij, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe Ministrit të Luftës të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, distinktivin e argjendët të Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Luftës Nacionalçlirimtare, si shenjë nderimi e respekti për brezin e ri të luftëtarëve të kombit shqiptar. Të gjithë këto takime ai i ndjente thellë dhe e përjetonte emocionalisht.

Adnan Qatipi ishte një prind dhe një gjysh shembullor. Ai i gëzohej pa masë nipit të tij të dashur Gertit, që studioje në Akademinë ushtarake të Modenas në Itali. Adnan Qatipi dhe e shoqja e tij, Branka, kishin tre fëmijë: Çlirimin, Arianën dhe Fatosin.

Adnan Qatipi u nda nga jeta më 1 shtator 2010, pas një sëmundjeje të shkurtër dhe të rëndë. Ai u përcoll me nderime të merituar nga veteranët, invalidët, familjet e dëshmorëve të atdheut, pasardhësit, ushtarakët në rezervë, në pension e në detyrë, në tërësi nga shoqëria shqiptare këndeje e andej Drinit dhe më gjerë. FIR (Federata Internacionale e Rezistencës), organizatë me një prestigj dhe me një rrezatim të madh, në nekrologjinë e saj e vlerësonte Adnan Qatipin si "përfaqësuesi i madh i luftës antifashiste në Europë".

Adnan Qatipi është vlerësuar me shumë urdhra dhe medalje. Organizata e Veteranëve të LANÇ të Shqipërisë i ka dhënë titullin "Kryetar Nderi i Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it".

Irfete Spahiu, gruaja e parë gjeneralmajore dhe Inspektore Gjenerale e FSK-së

Irfete Spahiu është gruaja e parë në Kosovë që mban gradën "Gjeneralmajor". Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka graduar Spahiun gjeneralmajore në FSK. "Kam dekretuar zonjën Irfete Spahiu nga grada Gjeneral Brigade në Inspektore Gjenerale. Ky gradim është nder edhe përgjegjësi. Nga gratë dhe burrat në uniformë familjet tuaja e tona e republika e Kosovës presim shumë nga ju. Gjeneralmajorja e parë në ushtrinë tonë jam e bindur që do të vazhdojë të punojë me nder dhe të na bëjë krenarë", -tha presidentja Osmani.

Por kush është gjeneralmajorja më e re e Ushtrisë së Kosovës?

Një vajzë e re në të njëzetat, ende pa i përfunduar studimet e drejtësisë dhe të ekonomisë të cilat po i ndiqte paralelisht në Universitetin e Prishtinës, do të gjuante për herë të parë me revole në një zonë përreth kullës që i takonte familjes së komandantit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) Adem Jashari, në Drenicën e marsit të vitit 1996.

Prej atyre gjuajtjeve ajo e kuptoi se plumbat e parë të shkrepur nga zjarri do të ishin edhe lajmëtarët për fundin e një jete të së kaluarës dhe fillimit të një jete krejtësisht të re për të. Jetë për të cilën do të betohej të mos e tradhetojë kurrë.

E njëjta revole me të cilën i kishte shkrepur po ata plumba do të vendosej para saj në Kullën e Jasharëve, aty ku edhe do të thoshte fjalët e betimit të saj.

"Si pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave të pushtuara të Shqipërisë dhe bashkimin e tyre, do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që më çdo kohë, pa kursyer as jetën time, të luftoj për t'i mbrojtur interesat e shenjta të atdheut", këto do të ishin vargjet e para që Irfete Spahiun në vitin 1996 do ta bënin ndër të para ushtarë të UÇK-së. "Nëse e shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës, dhe nëse tradhetoj qoftë i humbur gjaku im. Betohem!".

Prej këtij betimi ajo do t'i bashkohej deri në fund luftës për çlirimin dhe mbrojtjen e popullit të Kosovës, që po shtypej e persekutohej nga ushtria Jugosllave.

Por asokohe Irfete Spahiu nuk e dinte se 6 marsi përherë do të mbetej datë historike për të dhe gjithë Kosovën.

Irfete Spahiu mbante gradën gjeneral brigade nga 6 marsi i vitit 2018, duke u bërë e para grua me këtë gradë në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ajo ka udhëhequr Komandën e Doktrinës dhe Stër-



vitjes të FSK-së në Ferizaj. Spahiu është juriste dhe ekonomiste. Është fëmija i parë i dy prindërve mësues në pension.

Në vitet '90 ajo ka punuar në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, si bashkëpunëtore profesionale. Karrierën ushtarake e ka filluar më 6 mars 1996, kur ka dhënë edhe betimin në UÇK.

Në prill të vitit 1998 në Zonën Operative të Drenicës, Spahiu ishte një ndër pesë eprorët e parë të kësaj zone dhe e vetmja grua në këtë pozitë. Pas luftës, në vitin 2000, ajo u gradua si kolonela e parë dhe e vetmja grua me këtë gradë, duke u bërë një ndër 34 eprorët e parë të Trupave Mbrojtëse të Kosovës.

Më pas në FSK, Spahiu shërbeu për tre vjet e gjysmë si drejtore e departamentit për personelin, kurse nga viti 2012 mori detyrën e zëvendëskomandantit të FSK-së. Spahiu është në përfundim të dy doktoraturave, të dyja në fushën e ekonomisë dhe financave.

Samiti i G7: Do të heqim gradualisht varësinë tonë nga energjia ruse, pa kompromentuar qëllimet tona klimatike dhe mjedisore

Charles Michel, President i Këshillit European dhe Ursula von der Leyen, Presidente e Komisionit European, përfaqësuan BE-në në samitin e këtij viti të G7-ës të organizuar në Schloss Elmau, Bavari, Gjermani, më 26-28 qershor 2022.

Samiti i G7 ishte një mundësi për të dërguar një sinjal të fuqishëm uniteti në këto kohë të trazuara.

“BE dhe G7 ndajnë të njëjtat qëllime: ndalimi i makinës së luftës së Rusisë, duke mbrojtur ekonomitë tona dhe ato të partnerëve tanë”, - u shpreh Presidenti i Këshillit European Charles Michel.

Gjatë takimit tre-ditor, udhëheqësit e G7 diskutuan një gamë të gjerë temash, duke përfshirë: Ukrainën dhe bashkëpunimin në politikën e jashtme; Adresimin e sigurisë së energjisë dhe ushqimit; Investimin në klimë dhe shëndet; Promovimin e partneriteteve për infrastrukturë dhe investime; Formësimin e ekonomisë globale; Avancimin e barazisë gjinore; Formësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Presidenca gjermane ftoi gjithashtu liderët nga Argjentina, India, Indonezia, Senegali dhe Afrika e Jugut për të marrë pjesë në disa sesione pune gjatë samitit.

Në fund të samitit, liderët miratuan një komunikatë, ku në lidhje me Ukrainën udhëheqësit e G7 ritheksuan dënimin e tyre për luftën e paligjshme dhe të pa-justifikueshme të agresionit të Rusisë kundër Ukrainës.

“Ne do të qëndrojmë me Ukrainën për aq kohë sa të duhet, duke ofruar mbështetjen e nevojshme financiare, humanitare, ushtarake dhe diplomatike në mbrojtjen e saj të guximshme të sovranitetit dhe integritetit territorial të saj”, -thuhet në Komunikatën e liderëve të G7.

Mbështetja financiare nga G7 në vitin 2022 arrin në më shumë se 2.6 miliardë euro ndihmë humanitare.

Vendet e G7 janë gati të japin ose kanë premtuar dhe dhënë 28 miliardë euro ndihmë buxhetore.



Tryezë e rrumbullakët: Bashkëpunimi në politikën e jashtme dhe të sigurisë

Udhëheqësit e G7 janë të përkushtuar fuqishëm për të mbështetur rindërtimin e Ukrainës nëpërmjet një plani dhe konference ndërkombëtare rindërtimi. Vendet e G7 do të vazhdojnë të vendosin sanksione të rënda dhe të qëndrueshme ndaj Rusisë për të ndihmuar në përfundimin e kësaj lufte.

“Ne mbetemi të palëkundur në angazhimin tonë ndaj koordinimit tonë të paprecedentë mbi sanksionet për aq kohë sa është e nevojshme, duke vepruar në unison në çdo fazë dhe do të reduktojmë të ardhurat e Rusisë, duke përfshirë edhe nga ari”, -deklaratë nga Komunikata e liderëve të G7.

Për sa i përket Sigurisë së energjisë dhe ushqimit nën ndikimin e luftës së Rusisë kundër Ukrainës, e cila po përkeqëson në mënyrë dramatike sigurinë energjetike dhe aksesin në ushqim në nivel global, udhëheqësit e G7 u angazhuan për të ndërmarrë veprime të menjëhershme për të siguruar furnizimin me energji dhe për të reduktuar rritjet e çmimeve.

Kjo përfshin eksplorimin e masave shtesë si kufizimet e çmimeve.

“Ne riafirmojmë angazhimin tonë për të hequr gradualisht varësinë tonë nga energjia ruse, pa kompromentuar qëllimet tona klimatike dhe mjedisore”,

-thuhet në Komunikatën e liderëve të G7, në lidhje me sigurinë e energjisë dhe ushqimit.

Vendet e G7 do të rrisin gjithashtu sigurinë globale të ushqimit dhe përmes Aleancës Globale për Sigurinë Ushqimore: “Ne do të ofrojmë një shtesë prej 4.5 miliardë dollarësh për këtë qëllim, do t'i qëndrojmë angazhimeve tona për të mbajtur të hapura tregjet tona ushqimore dhe bujqësore dhe për të rritur përpjekjet për të ndihmuar Ukrainën të prodhojë dhe eksportojë.”

Ndërsa për Çështjet ekonomike udhëheqësit e G7 mbeten të përkushtuar për të minimizuar ndikimin e luftës në nivel global, si dhe ndikimin e saj në ekonomitë dhe popullsinë e tyre.

Vendet e G7 do të ndihmojnë në stabilizimin dhe transformimin e ekonomisë globale duke trajtuar rritjen e kostove të jetesës për qytetarët.

“Ne do të koordinojmë sigurinë tonë ekonomike, do të forcojmë qëndrueshmërinë e zinxhirëve të furnizimit dhe do të sigurojmë një fushë loje të barabartë”, thuhet në Komunikatën e liderëve të G7.

Udhëheqësit e G7 miratuan qëllimet e një Klubi të hapur dhe bashkëpunues ndërkombëtar për Klimën dhe mjedisin.

Ata do të punojnë me partnerë drejt

krijimit të tij deri në fund të vitit 2022.

Objektivat janë: drejtimi i veprimeve urgjente, ambicioze dhe gjithëpërfshirëse për t'u lidhur me rrugët 1,5°C dhe përsheptimi i zbatimit të Marrëveshjes së Parisit.

Udhëheqësit e G7 u angazhuan për: një sektor rrugor shumë të dekarbonizuar deri në vitin 2030; një sektor energjetik plotësisht ose kryesisht i dekarbonizuar deri në vitin 2035, duke i dhënë përparësi përsheptimit të largimit të energjisë së pandërprerë të qymyrit vendas.

Udhëheqësit e G7 shqyrtuan progresin e partneritetit të G7 për infrastrukturën dhe investimet në një të ardhme më të mirë.

Nëpërmjet partneritetit, ata synojnë të mobilizojnë 600 miliardë dollarë gjatë pesë viteve të ardhshme për të ngushtuar hendekun global të investimeve. "BE-ja mbështet plotësisht Partneritetin e G7 për Infrastrukturën dhe Investimet Globale. 46% e ndihmës globale për zhvillim vjen nga BE. Çdo vit, pothuajse 70 miliardë euro shkojnë për financimin e më shumë paqes, më shumë prosperitet dhe më shumë zhvillim", - deklaroi Presidenti i Këshillit European Charles Michel.

Udhëheqësit e G7 ranë dakord të rrisin bashkëpunimin e tyre globalisht. Duke u mbështetur në partneritetin e tyre ekzistues me Afrikën e Jugut, ata do të punojnë drejt Partneriteteve të reja të Tranzicionit të Drejtë Energjisë me: Indonezinë, Indinë, Senegalin, Vietnamin.

Në lidhje me COVID-19, udhëheqësit e G7 riafirmuan angazhimin e tyre për qasje të barabartë globale dhe ofrim të sigurt, efektiv dhe të përbalueshëm të: vaksinave, terapeutikëve, diagnostifikimit, mallrave të tjera thelbësore mjekësore.

"Për të kapërcyer pandeminë aktuale të COVID-19, ne do të bazojmë sigurimin tonë të mbi 1,175 miliardë dozave të vaksinës vitin e fundit", - thuhet në lidhje me vaksinat në Komunikatën e liderëve të G7.

Udhëheqësit miratuan gjithashtu paktin e G7 për gatishmërinë ndaj pandemisë. Ata u angazhuan për parandalimin, përgatitjen dhe përgjigjen ndaj pandemisë të ardhshme dhe sfidave shëndetësore.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve sigurisht ishin edhe Vlerat demokratike. Udhëheqësit e G7 do të bashkëpunojnë gjithashtu me shoqërinë civile dhe partnerët për: të forcuar qëndrueshmërinë e shoqërive tona, të promovuar të drejtat e njeriut online dhe offline, për të adresuar dezinformatat

dhe për të arritur barazinë gjinore.

Disa nga objektivat kryesore për BE-në gjatë samitit ishin: nënvizimi i veprimeve të BE-së për të mbështetur Ukrainën dhe për të sanksionuar Rusinë, sigurimi i informacionit në lidhje me aplikimin e Ukrainës për anëtarësim në BE dhe theksimi i përgjegjësisë së Rusisë për rritjen e çmimeve të ushqimit dhe energjisë dhe rritjen e inflacionit.

Për sa i përket klimës, BE theksoi nevojën për të rritur ambicien globale

të klimës, përsëritet nismën e Klubit Klimatik të propozuar nga presidenca e G7 dhe mbështeti partneritetet e tranzicionit të drejtë të energjisë.

BE gjithashtu theksoi nevojën për t'i dhënë fund pandemisë aktuale, diskutuan instrumentin e ardhshëm të pandemisë, demonstroi luftën e BE-së për barazi gjinore si dhe konfirmoi angazhimin e BE-së për të mbrojtur lirinë dhe integritetin e informacionit në sferën dixhitale.

Deklaratë e përbashkët e Presidentit von der Leyen dhe Presidentit Biden mbi Sigurinë Europiane të Energjisë

Pas pushtimit të mëtejshëm të Ukrainës, Rusia vazhdon të përdorë gazin natyror si një armë politike dhe ekonomike. Shtrëngimi energjetik i Rusisë ka ushtruar presion mbi tregjet e energjisë, ka rritur çmimet për konsumatorët dhe ka kërcënuar sigurinë globale të energjisë. Kjo u demonstrua së fundmi nga ndërprerjet akute të motivuara politikisht të furnizimeve me gaz në disa shtete anëtare të Bashkimit European. Këto veprime vetëm nënvizojnë rëndësinë e punës që Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European po bëjnë për t'i dhënë fund mbështetjes sonë në energjinë ruse. Ne po punojmë gjithashtu së bashku për të gjetur mënyra për të reduktuar më tej të ardhurat e Rusisë nga energjia në muajt e ardhshëm për të kufizuar më tej aftësinë e Rusisë për të financuar luftën e saj të paprovokuar në Ukrainë. Këto veprime janë hapa të rëndësishëm, të domosdoshëm dhe të menjëhershëm që mund të marrim, por ne gjithashtu e kuptojmë se sfida është e madhe. Për të përballuar sfidën dhe për të mbështetur përpjekjet e Europës, ne krijuam më 25 mars 2022 Task Forcën për Sigurinë Europiane të Energjisë. Që atëherë, Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European kanë bërë hapa të rëndësishëm drejt reduktimit të varësisë së Bashkimit European nga lëndët djegëse fosile ruse duke ulur kërkesën për gaz natyror, duke bashkëpunuar në teknologjitë e efikasitetit të energjisë dhe duke diversifikuar furnizimet me energji. Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European po marrin gjithashtu veprime vendimtare për të reduktuar kërkesën e përgjithshme për lëndë djegëse fosile në përputhje me Marrëveshjen e Parisit dhe objektivin tonë të përbashkët për emetimet neto zero jo më vonë se 2050.

Task Forca është takuar rregullisht për të diskutuar opsionet për të reduktuar kërkesën e Europës për gaz natyror dhe është takuar gjithashtu me palët kryesore të interesit për të promovuar vendosjen e pompave të nxehtësisë, termostateve inteligjentë dhe zgjidhjeve të përgjigjes ndaj kërkesës për energji. Ne do të inkurajojmë Shtetet Anëtare dhe kompanitë europiane dhe amerikane që të arrijnë një objektiv fillestar për vendosjen e të paktën 1.5 milionë termostateve inteligjente të kursimit të energjisë në familjet europiane këtë vit. Në ditët në vijim ne do të mblidhemi me Shtetet Anëtare dhe palët e interesuara për të diskutuar rekomandimet e politikave të zbatueshme për të përsheptuar vendosjen dhe prodhimin e termostatit inteligjent dhe pompës së nxehtësisë, në një përpjekje për të siguruar që furnizimi për zgjidhjet kryesore të efikasitetit të energjisë po rritet për të përmbushur kërkesën në rritje. Ne jemi gjithashtu partnerë për të diversifikuar furnizimet me energji në Europë. Ndërsa Rusia ka shkurtuar furnizimet me gaz natyror për disa shtete anëtare të BE-së, Shtetet e Bashkuara dhe prodhues të tjerë janë rritur. Që nga marsi, eksportet globale të LNG-së në Europë janë rritur me 75 për qind krahasuar me vitin 2021, ndërsa eksportet e LNG-së amerikane në Europë pothuajse janë trefishuar. Për të lehtësuar këto përpjekje, Komisioni European dhe Shtetet Anëtare, në përputhje me një mandat të dhënë nga Këshilli European në mars 2022, krijuan Platformën e Energjisë së BE-së për të koordinuar masat për të siguruar furnizime të besueshme dhe të diversifikuara me energji për BE-në, duke përfshirë përmes vullnetit të përbashkët, blerja e gazit të tubacionit, LNG-së dhe hidrojenit. Komisioni ka krijuar gjithashtu Platformën e parë Rajonale të Energjisë për Europën Juglindore për të mbështetur diversifikimin e gazit të rajonit të varur tradicionalisht nga furnizimet ruse. Shtetet e Bashkuara janë një partner kyç për diversifikimin e qëndrueshëm të furnizimeve me gaz në këtë rajon dhe shtete të tjera anëtare të BE-së me ndikim të madh, duke përfshirë mbështetjen e reduktimit të kërkesës dhe përsheptimin e teknologjive të pastra. Duke pasur parasysh ndikimin mjedisor të prodhimit dhe konsumit të LNG-së, Shtetet e Bashkuara dhe Komisioni European do të rrisin bashkëpunimin e tyre për të reduktuar emetimet e metanit, për të siguruar që tregtia e LNG-së BE-SHBA të jetë në përputhje me qëllimin e një matjeje, raportimi dhe verifikimi të pranuar ndërkombëtarisht standarde për emetimet e metanit gjatë punës për të reduktuar ajrimin dhe ndezjen në prodhimin e gazit natyror dhe rrjedhjen e metanit në transmetimin dhe zinxhirin e furnizimit me LNG. Ne gjithashtu do të vazhdojmë bashkëpunimin tonë për reduktimin e emetimeve të metanit në nivel global. Së fundmi, nisja e përbashkët me 11 vende të tjera të Rrugës së Energjisë Globale të Metanit do të avancojë si përparimin e klimës ashtu edhe sigurinë energjetike ndërkombëtarisht.

Koncepti i ri Strategjik, forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes, më shumë mbështetje për Ukrainën, ftesa për Finlandën dhe Suedinë

NATO njeh Rusinë si kërcënimin më të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Nërsa Spanja shënon këtë vit 40-vjetorin e anëtarësimit në Aleancë, liderët e vendeve të NATO-s u takuan në Madrid, në Samitin e tyre tre ditor nga 28 deri më 30 qershor 2022. Udhëheqësit e qeverive dhe vendeve të NATO-s morën vendime të gjera për të vazhduar përshtatjen e Aleancës në sesionin e parë të punës në Samitin e Madridit zhvilluar më 29 qershor. Aleatët miratuan Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, planin për Aleancën në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese. Vendosën gjithashtu për një ndryshim themelor në parandalimin dhe mbrojtjen, të mbështetur nga rritja e investimeve në mbrojtje dhe financimi i përbashkët, si dhe vendosën për më shumë mbështetje për Ukrainën, për një afat më të gjatë.

Aleatët ranë dakord më tej për të nisur Fondin e Inovacionit të NATO-s dhe për të vendosur objektiva për të ulur emetimet e gazit serrë të NATO-s. Më në fund, udhëheqësit e NATO-s morën vendimin e tyre historik, siç ishte ftesa për Finlandën dhe Suedinë, për tu bërë anëtarë të Aleancës.

Aleatët, mbështetje të vazhdueshme për Ukrainën

"Udhëheqësit e NATO-s sapo kanë marrë vendime për të transformuar dhe forcuar Aleancën tonë në këtë kohë kyçe për sigurinë tonë. Lufta e Presidentit Putin kundër Ukrainës ka shkatërruar paqen në Europë dhe ka krijuar krizën më të madhe të sigurisë në Europë që nga Lufta e Dytë Botërore. NATO është përgjigjur me forcë dhe unitet. Lideri dhe guximi i Presidentit Zelenskyy janë një frymëzim për të gjithë ne", -tha në daljen para shtypit Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive, kur informoi

mbi punimet e datës 29 qershor të Samitit. "Presidenti Zelenskyy e bëri të qartë se Ukraina mbështetet në mbështetjen tonë të vazhdueshme dhe mesazhi ynë për të ishte po aq i qartë. Ukraina mund të mbështetet tek ne, për aq kohë sa duhet", -tha ai. "Aleatët do të vazhdojnë të ofrojnë ndihmë të madhe ushtarake dhe financiare dhe udhëheqësit ranë dakord të forcojmë mbështetjen tonë, duke rënë dakord për një Paketë Gjithëpërfshirëse të Asistencës për Ukrainën. Kjo përfshin komunikime të sigurta, karburant, furnizime mjekësore dhe armaturë trupore. Pajisjet për të luftuar minat dhe kërcënimet kimike dhe biologjike dhe qindra sisteme portative anti-drone. Në planin afatgjatë, ne do të ndihmojmë Ukrainën të kalojë nga pajisjet e epokës sovjetike në pajisjet moderne të NATO-s, për të rritur ndërveprimin dhe të forcojë më tej institucionet e saj të mbrojtjes dhe sigurisë. E gjithë kjo tregon përkushtimin tonë për të ardhmen e Ukrainës dhe se angazhimi ynë është i palëkundur. Një Ukrainë e fortë dhe e pavarur është jetike për stabilitetin e zonës euroatlantike."

Transformimi i Forcës së Reagimit të NATO-s, numri i forcave shkon mbi 300 000

Krerët e shteteve dhe qeverive të NATO-s vendosën më 29 qershor gjithashtu për një ndryshim thelbësor në mbrojtjen dhe parandalimin e NATO-s, për t'i u përgjigjur realitetit të ri të sigurisë. "Ne do të forcojmë mbrojtjen tonë përpara. Ne do të rrisim grupet tona luftarake në pjesën lindore të Aleancës, deri në nivel brigade. Ne do të transformojmë Forcën e Reagimit të NATO-s dhe rritjen e numrit të forcave të gatishmërisë së lartë në mbi 300 000", -njoftoi mediet Stoltenberg. "Ne gjithashtu do të rrisim aftësinë tonë për të përforcuar, përfshirë: më shumë pajisje të para-pozicionuara dhe rezerva të furnizimeve ushtarake; më shumë aftësi të vendosura përpara, si mbrojtja ajrore; komandim

dhe kontroll i forcuar dhe planet e përmirësuar të mbrojtjes, me forca të paracaktuara për të mbrojtur aleatët specifikë", -tha ai dhe shtoi se: "Kjo është hera e parë që nga Lufta e Ftohtë që NATO ka plane të tilla me forca të paracaktuara. Këto forca do të punojnë me forcat e mbrojtjes në vend dhe do të familjarizohen me terrenin lokal, objektet dhe stoqet e para-pozicionuara, që të mund të përforcoheni edhe më shpejt".

Rritja e shpenzimeve të mbrojtjes, investim në aftësi moderne

Të bësh më shumë do të kushtojë më shumë. Aleatët u angazhuan për zotimin që bënë në 2014 për të shpenzuar të paktën 2% të PBB-së për mbrojtjen. Që nga viti 2014, aleatët europianë dhe Kanadaja kanë shpenzuar 350 miliardë dollarë shtesë. Nëntë aleatë tani arrijnë, ose tejkalojnë objektivin prej 2%. Nëntëmbëdhjetë aleatë kanë plane të qarta për ta arritur atë deri në vitin 2024 dhe pesë të tjerë kanë angazhime konkrete për ta përmbushur atë më pas. Dy për qind shihen gjithnjë e më shumë si dysheme, jo si tavan. Aleatët po investojnë gjithashtu më shumë në aftësitë moderne, duke kontribuar më shumë në dislokimet dhe stërvitjet e NATO-s. "Ne kemi rënë dakord të rrisim financimin e përbashkët të NATO-s. Për të financuar objektet kemi nevojë për përforcim si dhe për më shumë trajnime dhe më shumë stërvitje, komandim dhe kontroll, dhe angazhim me partnerët. Ne përballemi me një ndryshim rrënjësor në mjedisin tonë të sigurisë dhe konkurrenca strategjike po rritet në mbarë botën". Stoltenberg tha se: "aleatët e NATO-s reduktuan shpenzimet e mbrojtjes pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, por nëse ne reduktojmë shpenzimet e mbrojtjes kur tensionet janë në rënie, ne duhet të jemi në gjendje të rrisim shpenzimet e mbrojtjes kur tensionet po rriten dhe kur jetojmë në një botë më të rrezikshme". Prandaj fakti që

të gjithë aleatët e NATO-s kanë rritur shpenzimet është një mesazh për të gjithë aleatët, për kapacitetet, kontributet në misionet dhe operacionet e NATO-s.

Samiti miraton Konceptin e ri Strategjik të NATO-s

Krerët e shteteve dhe qeverive të NATO-s në takimin në Madrid në punimet e 29 qershorit 2022, miratuan Konceptin e ri Strategjik për Aleancën, ku përcaktuan prioritetet, detyrat kryesore dhe qasjet e Aleancës për dekadën e ardhshme. Koncepti përshkruan mjedisin e sigurisë me të cilin përballlet Aleanca, ripohon vlerat dhe përshkruan qëllimin kryesor të NATO-s për të siguruar mbrojtjen kolektive. Ai më tej përcakton tre detyrat kryesore të NATO-s për parandalimin dhe mbrojtjen; parandalimin dhe menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese.

"Ky është Koncepti i ri Strategjik. Ai që kishim, ishte rënë dakord në vitin 2010 dhe kjo është shumë e ndryshme nga ajo që ranë dakord atëherë", -nënvizoi shefi i NATO-s. "Ky koncept e bën të qartë se Rusia përbën kërcënimin më të rëndësishëm dhe të drejtpërdrejtë për sigurinë tonë. Në konceptin aktual, (të mëparshmin) ne deklarojmë se Rusia është një partner strategjik dhe ne nuk e përmendim Kinën me asnjë fjalë të vetme. Ndërsa në konceptin e ri, aleatët deklarojnë se politikatat shtrënguese të Kinës sfidojnë interesat, sigurinë dhe vlerat tona. Koncepti gjithashtu përcakton qëndrimin tonë të përbashkët për të luftuar terrorizmin, si dhe kërcënimet kibernetike dhe hibride. Koncepti Strategjik përditësohet afërsisht çdo dekadë dhe është dokumenti i dytë më i rëndësishëm i NATO-s. Ai ripohon vlerat e Aleancës, ofron një vlerësim kolektiv të sfidave të sigurisë dhe drejton aktivitetet politike dhe ushtarake të Aleancës. Versioni i mëparshëm u miratua në Samitin e NATO-s në Lisbonë në 2010.

Përshtatja e NATO-s dhe ndryshimi i klimës si një sfidë përcaktuese

Hapa të tjerë të rëndësishëm për të vazhduar përshtatjen e NATO-s u ndërmorën në Samit. "Ne po hapim Fondin e Inovacionit të NATO-s. Mbështetur nga aleatët, ai do të investojë 1 miliard euro në start-up-e dhe fonde që zhvillojnë teknologji të reja me përdorim të dyfishtë, si intelijenca artificiale. Si bashku me Përsheptuesin e Inovacionit të Mbrojtjes të NATO-s për Atlantikun e Veriut, ose DIANA, fondi i ri do të shfrytëzojë teknologjinë e re më të mirë për sigurinë transatlantike. Nga ana tjetër ndryshimi i klimës është një sfidë përcaktuese e kohës sonë. NATO është e përkushtuar të luajë rolin e saj në zbutjen e ndikimit në sigurinë e saj. Sot, ne ramë dakord për një metodologji të re për të hartuar emetimet ushtarake të gazeve serrë.

Ne ramë dakord për objektiva konkrete për të ulur emetimet e NATO-s. Synimi ynë është të ulim emetimet nga organet dhe komandat e NATO-s me të paktën 45% deri në vitin 2030 dhe të shkojmë drejt Neto Zero deri në vitin 2050. Ky është një hap i rëndësishëm për Aleancën tonë", -tha Stoltenberg. "Ne nuk mund të zgjedhim mes ushtrive të gjelbra apo të forta, duhet të jenë të dyja, -tha ai. -Pra, ne duhet të ruajmë efektivitetin dhe gatishmërinë tonë operacionale ndërsa vazhdojmë të përshtatem".

Adresimi i sfidave globale, partnerët Indo-Paqësor marrin pjesë në një Samit të NATO-s për herë të parë

Në një botë më të rrezikshme dhe konkurruese, NATO-s i duhet të punojë edhe më ngushtë me kombet dhe organizatat me të njëjtin mendim. Prandaj në Samitin e Madridit, liderëve aleatë iu bashkuan gjatë punimeve disa prej partnerëve më të afërt të NATO-s për të adresuar sfidat globale. Partnerët Indo-Paqësor Australia, Japonia, Zelanda e Re dhe Republika e Koresë morën pjesë për herë të parë në një Samit të NATO-s. Në takim morën pjesë edhe BE dhe Gjeorgjia, si dhe Finlanda dhe Suedia, ku dy të fundit në datën 29 qershor u ftuan të bëhen anëtarë të NATO-s. Sekretari i Përgjithshëm tha se NATO duhet të qëndrojë me partnerët e saj në mbarë botën për të ruajtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla në epokën e konkurrencës strategjike. "Ne shohim një partneritet strategjik të thelluar midis Moskës dhe Pekinit dhe vetëbesimi në rritje i Kinës dhe politikat e saj shtrënguese kanë pasojë për sigurinë e aleatëve dhe partnerëve tanë", -tha ai për mediat pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivel të krerëve të shteteve dhe qeverive me partnerët. "Kina po ndërton në mënyrë të konsiderueshme forcat e saj ushtarake, përfshirë armët bërthamore, ngacmimin e fqinjëve, kërcënimin i Tajvanit, investimi i madh në infrastrukturën kritike, përfshirë vendet aleate, monitorimi dhe kontrolli i qytetarëve të vet përmes teknologjisë së avancuar dhe përhapja e gënjeshtreve dhe dezinformatave ruse", -tha Stoltenberg. "Kina nuk është kundërshtari ynë, por ne duhet të jemi të qartë për sfidat serioze që ajo përfaqëson dhe ne duhet të vazhdojmë të qëndrojmë me partnerët tanë për të ruajtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Një sistem global i bazuar në norma dhe vlera, në vend të dhunës brutale. NATO do të rrisë bashkëpunimin me partnerët tanë Indo-Paqësor, përfshirë mbrojtjen kibernetike, teknologjitë e reja, sigurinë detare, ndryshimet klimatike dhe kundër-informimin, sepse këto sfida globale kërkojnë zgjidhje globale. Në takim u ra dakord të shtohet mbështetja politike dhe praktike për partnerët e tjerë në rrezik nga agresioni

rus, si me Bosnjën dhe Hercegovinën, Gjeorgjinë dhe Republikën e Moldavisë. "Ne do t'i ndihmojmë ata të ndërtojnë aftësitë e tyre dhe të forcojnë qëndrueshmërinë e tyre".

Vendim historik, ftesa për Finlandën dhe Suedinë për t'u bërë anëtarë të NATO-s

"Sot, liderët e NATO-s morën vendimin historik për të ftuar Finlandën dhe Suedinë të bëhen anëtarë të NATO-s. Marrëveshja e arritur mbrëmë (28 qershor) nga Turqia, Finlanda dhe Suedia i hapi rrugën këtij vendimi", -tha shefi i NATO-s. "Do të doja të falënderoja Turqinë, Finlandën dhe Suedinë që pranuan ftesën time për t'u përfshirë në negociatë për të gjetur një rrugë të bashkuar përpara. Kjo ka qenë punë e vështirë për shumë javë, me kontakte të shumta në nivele të ndryshme. Zyrtarët e lartë kanë pasur dy raunde bisedimesh në Bruksel nën kujdesin tim.

Dhe mbrëmë, ne u takuam me Presidentin Erdogan, Presidentin Niinistö dhe Kryeministrin Andersson dhe arritëm në marrëveshjen përfundimtare. Kjo është një marrëveshje e mirë për Turqinë. Është një marrëveshje e mirë për Finlandën dhe Suedinë dhe kjo është një marrëveshje e mirë për NATO-n", -deklaroi Stoltenberg. "Para së gjithash, vendimi për të ftuar Finlandën dhe Suedinë për t'u bërë anëtare tregon se dera e NATO-s është e hapur. Kjo tregon se presidenti Putin nuk ia doli të mbyllte derën e NATO-s. Dera e NATO-s mbetet e hapur dhe gjithashtu tregon se ne respektojmë të drejtën sovranë të çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij. Pra, ne, natyrisht, e respektojmë Finlandën dhe Suedinë kur vendosën të qëndronin jashtë NATO-s për shumë vite, por më pas i mirëpritëm dhe respektojmë vendimin e tyre për t'u anëtarësuar në NATO", -theksoi Sekretari i Përgjithshëm. Aleatët e NATO-s tashmë janë rritur dhe NATO ka rritur praninë e saj në rajonin Baltik, Nordik. "Sigurisht, kur ata të bëhen anëtarë, ne mund të bëjmë edhe më shumë së bashku. Ajo që ne do të sigurohemi me praninë tonë është se ne jemi në gjendje të mbrojmë të gjithë aleatët, përfshirë, natyrisht, Finlandën dhe Suedinë."

Ky është procesi më i shpejtë i anëtarësimit të një vendi ndonjëherë në NATO. Finlanda dhe Suedia aplikuan për anëtarësim në maj, dhe në fund të qershorit liderët i ftuan ata të bëhen anëtarë. "Pas nënshkrimit të Protokollit të Anëtarësimit është ratifikimi në tridhjetë parlamente të vendeve aleate dhe mesazhi në sallë ishte se në të gjithë Aleancën ekziston një vullnet i fortë për të punuar me parlamentet në mënyrë që ata të mund të bëjnë ratifikimin sa më shpejt të jetë e mundur", -njoftoi Stoltenberg, lidhur me procedurat e mëtejshme në vendet aleate të NATO-s.

Udhëtim të mbarë në shekullin XXI

ANJEZA MUSOLLARI,
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE

Po lundrojmë nëpër dallgët e shekullit të XXI, herë përplasemi fuqishëm me ajsbergët e padukshëm dhe herë vozitim mbi qetësinë e rreme të detit tinëzar.

Shpesh herë pyesim veten pse u gjetëm në këto ujëra?

Vetë ne, qeniet humane po tjetërsojmë gjithçka që kishte një emër, një formë, një vlerë.

Sipas Sokratit "çdo shoqëri e krijon modelin e njeriut sipas vetes së saj". Shoqëria që lamë pas krijoi modelin e njeriut, në kushte e rrethana historike, me ndjesi e identitet të shtuar kombëtar. Është shoqëria, janë marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore që përcaktojnë shkallën kulturore e të sjelljes së individit.

Një shoqëri e përparuar dhe e moralshme krijon individë të kulturuar e të sjellshëm, raporti shoqëri-individ është reciprok. Në këtë raport, primar është interesi i përgjithshëm, që është bazë e jetës së shoqërisë dhe e çdo individ në veçanti. Vetëm nëpërmjet interesit të përgjithshëm, mund të plotësohen interesat personale dhe prirjet e veçanta të individit. Shoqëria dhe individ nuk janë fenomene të ndara.

"Në thelb, jemi qenie kolektive", -thotë V. Gëte. Njerëzit i bashkon karakteri shoqëror i pronësisë, territori, ndërgjegjja kombëtare, gjuha, traditat, idetë dhe botëkuptimi se sa mentaliteti i një individ, i cili mbart në vetvete dhe prirje egoiste, individualiste, që po të shumohen shkojnë në dëm të jetës publike e të shoqërisë në tërësi. Në këtë raport përcaktuese mbeten marrëdhëniet në prodhim dhe karakteri i pronësisë.

Është shoqëria, janë marrëdhëniet në prodhim që përcaktojnë sjelljen e individit. Në të kundërt, shoqëria kthehet në anarki, siç është shoqëria e sotme shqiptare. Shoqëria, në bazë të ligjësive objektive, nxjerr normat juridike dhe një sërë normash morale, universale të pranuar nga shoqëria. Individ nuk mund të merret i shkëputur nga marrëdhëniet shoqërore. Njeriu është i prirë të jetojë në shoqëri se është pjesë e saj dhe kjo e shtyn atë të zbatojë rregullat ligjore e morale.

Njeriu është produkt i mjedisit në të cilin rritet dhe edukohet. Teoria e përhapur aq shumë në ditët e sotme të së "drejtës" së individit, tenton ta shkëputë individin nga shoqëria. Liritë dhe të drejtat e tij t'i shkëpusë nga ato të shoqërisë deri dhe t'ia kundërvënë



me pretendimin e "lirisë" së individit dhe të drejtave të tij, që realisht bien ndesh me të shoqërisë, ku ai është pjesëtar. Individ nuk ka vetëm të drejta, por dhe detyra, që rrjedhin nga marrëdhëniet në shoqëri.

Njeriu është qenie sociale. Ndarja e të "drejtës" së individit nga e drejta universale, njerëzore, çon dhunshëm në kundërvënien e individit ndaj shoqërisë e familjes, që është qeliza bazë e shoqërisë, e cila trashëgon virtyte dhe traditat më të mira të qytetarisë shqiptare, që u shfaqën dukshëm para viteve '90. Traditat e mira, ruajnë dhe konsolidojnë identitetin e një kombi. Nga e shkuara trashëgojmë gjithë të mirat: identitetin kombëtar, bekimin dhe dashurinë familjare që është jetësore. Familja është e shenjtë, në kuptimin më të mirë të fjalës. Ajo është e shenjtë se krijon trashëgiminë gjinore. Të jep dashurinë e fëmijëve, rrit solidaritetin shoqëror, dashurinë ndaj prindërve, miqve e ndaj njëri-tjetrit. Fëmijët lumturohen e gëzohen me dashurinë e prindërve të tyre. Në familje merret edukata e parë.

"Edukata e mirë, është lulja e jetës". Mikpritja dhe bujaria, janë nga cilësitë më të mira që ka krijuar dhe edukuar familja shqiptare. Këto, krahas cilësive të tjera, siç është atdhedashuria, liria, ruajtja e gjuhës dhe e identitetit kombëtar janë vlera të shtuara në shekuj, që mbart kombi shqiptar. Nga këto nocione, "liria" në kuptimin e lirisë themelore, është më e hershme. Ajo pothuajse ka lindur bashkë me njeriun. Liria ka në themel barazinë e kushteve materiale, të drejtën bazike për të jetuar, për të pasur një shtëpi dhe për t'u arsimuar. Nuk ka liri abstrakte. Liria është domosdoshmëri jetësore, por ajo nuk është e pakufizuar, veçanërisht kur flitet për

liri individuale. "Liria pa kufi, -thotë shkrimtari i madh francez Albert Kamy, -është e kundërta e lirisë". "Masa të jetë kurdohërë, - thotë Horaci, - gjithçka ka një kufi".

Por si po projektohen jetët tona në këtë mes shekulli të XXI?

Jeta është një mundësi për të fituar përjetësinë e lumtur ose atë të shëmtuarën, dhe kjo varet nga ne, pasi secili mbetet peng i veprës së tij.

Jeta është një provim, me sprovë që shpesh të ulin ose të ngrenë lart, kjo varet nga çelësi i gjithë suksesit i cili është durimi.

Jemi të ndërgjegjshëm që jeta nuk është një vijë e drejtë, e as fushë më lule, ajo shpesh është një vijë e lakuar për të sfiduar qenien tonë.


Jeta njerëzore në këtë shekull 'të çuditshëm', nga forma dhe përmbajtja, të jep përshtypjen e një studioje projektimi ku ravigëzohet me majën e një lapsi jeta e gjithkujt.

Nëse prania fizike merret si fakt për të dëshmuar jetën, atëherë pa asnjë dyshim mund të shkruhet trashë e me shkronja të mëdha, se ne jetojmë dhe gjallojmë në shekullin XXI. Se jetojmë në këtë shekull, si prova ndihmëse mund të merren edhe makinat, kompjuteri, avionët, librat, letra, celulari Stacionimi i plotë është i pamundur apo shumë i vështirë, por në vija të trasha, simbolikisht, mund të vizatohet.

Çfarë i ndodhi këtij shekulli të sëmure, që prishi balancat e jetës?

Orekset territoriale, sëmundje e trashëguar nga historia, apo grykësi bulimike?

Shpesh historianët përpiqen të sjellin në kujtesën tonë: çfarë historikisht ka ndodhur dhjetëra e qindra vjet më parë. Por çuditërisht për brezin e ri kjo duket e njohur, e jetuar, 'pa interes', sepse thjesht ndryshojnë emërtimet e atyre që kanë shkaktuar këto ngjarje historike, aktualiteti është i njëjtë. Lebra, kolera, malaria vite më parë, sot Covid-19, të gjitha në paralel, 'vdekjeprurëse', transformuese (armë shkatërrimi në masë). Ndër shekuj uria gllabëruese e territoreve ka nisur në epokën e gurit dhe deri në vitin 2022 të shek. XXI. Raca 'homosapience' grykësinë e paska tipar dallues sado transformimi të plotë fizik (njeriu i sotëm), kësaj tendence nuk iu larguam dot, madje po kthehet në një trend botëror. Numri më i madh i fëmijëve, që jetojnë në zonat e konfliktit, është në Afrikë (170 milionë), ndërsa dendësia më e lartë është regjistruar në Lindjen e Mesme, Afganistani, Iraku, Mali, Nigeria, Republika e Afrikës Qendrore, Republika Demokratike e Kongos, Somalia, Sudani i Jugut, Siria dhe Jemeni mbeten dhjetë vendet me numrin më të madh të shkeljeve serioze të të drejtave. Fatkeqësisht, në këto vende regjistrohet numri më i madh i vrasjeve dhe i gjymtimeve, i dhunës seksuale, i rekrutimit dhe i përdorimit të fëmijëve nga forcat e grupet e armatosura. Europa ka hyrë në luftë. Ushtarakisht lufta zhvillohet mes një agresori dhe një vendi nën agresion, ndërsa në të gjitha aspektet e tjera, ku aspekti ekonomik është themelori, lufta zhvillohet mes të gjitha vendeve që refuzojnë kategorikisht agresionin dhe agresorin.



Zhvillimi teknologjik një hap para, apo hendek mes brezave?

Sot jemi dëshmitarë të shpejtësisë së madhe në avancime dhe ndryshime në fushën e shkencës, teknologjisë, kulturës dhe shoqërisë si dhe arritjes së informacioneve të tepërta që askush nuk mund të ballafaqohet me to.

Pa dyshim, kjo shpejtësi mahnitëse e ndryshimeve të shkaktuara nga teknologjia, krijon strese të rënda, çorientim dhe kaos në individë dhe shoqëri.

Çdo popull ka tregimet dhe mitet e veta rreth së ardhmes. Njerëzit gjithmonë e kanë ndier të nevojshme të dinë se ku do shkojnë, çfarë do të jetë ardhmëria e tyre e afërt si dhe ajo e largëta. Në shoqërinë e sotme teknologjike shkencëtarët, filozofët dhe shkrimtarët janë ata të cilët mundohen të imagjinojnë të ardhmen. Vizionet dhe parashikimet e tyre ndahen në dy doktrina, atë optimiste dhe atë pesimiste. Optimistët besojnë që progresi i plotësuar me hulumtime shkencore do të vazhdojë të bëjë jetën tonë më të mirë duke mposhtur tërë problemet. Pesimistët, në të kundërtën, besojnë që problemet përcjellin vetë njerëzimin, dhe teknologjia vetëm sa i shton ato, duke i liruuar forcat e errëta njerëzore që mund të dalin jashtë kontrollit përgjithmonë.

Shkencëtarët kishin një ëndërr: të ndërtojnë një robot që është i përsosur, të mendojë, të mësojë e madje edhe të dashurojë sikur qeniet njerëzore. Megjithatë, në thellësinë e imagjinatës së tyre qëndronte frika se një ditë roboti do të marrë pushtetin mbi humanët dhe do të humbë qëllimi i vërtetë i jetës sonë, duke u bërë robër të asaj që dikur ndërtoam. Fatkeqësisht, kjo nuk është më pjesë e imagjinatës së ndonjë shkrimtari fantastiko-shkencor por ky është realiteti që na rrethon (epoka e teknologjisë informative), koha kur njerëzit posedojnë aq shumë fuqi por pak dituri se si ta përdorin atë.

Udhëtimi ynë në këtë shekull "të çmendur" vlerash

"Shekulli ku rrobat vendosin për vlerën e një personi dhe të kesh para është më e rëndësishme sesa të kesh miq të vërtetë apo edhe familje.

Shekulli ku fëmijët janë në gjendje të braktisin dhe të përbuzin prindërit e tyre.

Këtu ku dashuria është një projekt."

Vozitni njerëz, por kujdesuni për llojin tuaj, për të ardhmen, pa luftëra, për jetën, dhuratën e shenjtë pa kthim, për buzëqeshjen e fëmijëve edhe në këtë marrëzi mes shekulli XXI!

Teknologjia e sistemeve kundër dronëve

Dronët, edhe kërcënim ndaj të cilëve duhet të mbrohem

Dronët po përdoren gjithnjë e më shumë në të gjithë sektorët pasi mund të fitojnë imazhe të gatshme për t'u përdorur shpejt dhe mund të arrijnë vende ku njerëzit nuk mund të arrijnë. Megjithatë, dronët mund të jenë gjithashtu një kërcënim nëse nuk përdoren me kujdesin e duhur.

UAV-të, të cilat ishin vetëm një çështje e kuriozitet, janë bërë shpejt pjesë kritike e misionëve ushtarakë dhe operacioneve me zbatim të ulët. Ne po shohim gjithashtu komercializimin e dronëve, se si ata po zgjerojnë shtrirjen e tyre në kompanitë e naftës dhe gazit, agjencitë e lajmeve, agjencitë e anketimit, agjencitë për mbrojtjen e burimeve të tokës dhe ujit etj. Megjithatë, ulja e kostos së dronëve dhe aksesit i lehtë për publikun ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm dronësh të lidhur me incidente në mbarë globin. Kjo ka çuar në evoluimin e teknologjisë kundër dronëve. E njohur gjithashtu si teknologjia kundër UAS, C-UAS ose kundër UAV, është një sistem që është krijuar posaçërisht për të gjurmuar dhe përgjuar dronët.

Në lidhje me llojet e teknologjive moderne që përdoren aktualisht, inxhinieri indian Pawan Vashisht, menaxher i përgjithshëm i "Systems Engineering" ka shqyrtuar disa lloje të sistemeve kundër dronëve.

Elektronika gjithnjë në zhvillim dhe teknologjitë e komunikimit kanë bërë që dronët të jenë gjithnjë e më të vegjël e me peshë më të lehtë, ndërsa rritet efikasiteti i tyre në drejtim të kapacitetit të ngarkesës, shpejtësisë, udhëzimit dhe navigimit, manovrueshmërisë dhe diapazonit. Këto zhvillime, megjithëse në shumë mënyra të dobishme, gjithashtu paraqesin disa kërcënime, jo vetëm për sigurinë e publikut por edhe për sigurinë e infrastrukturave kritike, objektet dhe institucionet e mbrojtjes, rrjetet e komunikimit dhe Institucionet e ligjit dhe rendit. Elementet antisociale dhe grupet kryengritëse përdorin dronë të avancuar për të kryer misione terroriste, kontrabandë, mbikëqyrje ajrore në zona të kufizuara/të siguruara dhe tubime publike si ngjarje sportive, mitingje politike, etj. Sulmi i tufës së UAV-ve është një tjetër kërcënim potencial, ku formacioni e bën atë jashtëzakonisht sfiduese për agjencitë e sigurisë që t'i pengojnë ato në një mjedis të mundimshëm.



Sistemi Rafael Drone Dome kombinon një grup radarësh 360 gradë për të gjitha kushtet e motit, një sensor radiofrekuece dhe një sensor elektro-optik dhe infra të kuqe, duke rritur mundësinë e zbulimit të kërcënimeve. Imazhi: Rafael

Siç tregohet në foto, dërgesat mbarë-botërore të dronëve të konsumit janë rritur në mënyrë të qën-




Figure 1 : Growth of Drones over the years

drueshme gjatë pesë deri në gjashtë vitet e fundit. Në vitin 2025 këto shifra pritet të jenë 4.1 miliardë. Me rritjen e popullsisë së dronëve, incidentet e pafavorshme gjithashtu do të rriten në mënyrë eksponenciale dhe është thelbësore për çdo qeveri të mbrojë kufijtë, pasuritë dhe njerëzit e saj nga këto kërcënime të mundshme. Nëse nuk kontrollohen, këto kërcënime mund të rezultojnë në humbje të shumë jetëve dhe implikime të

mëdha financiare për shtetin. Të gjithë faktorët e diskutuar më sipër kërkojnë C-UAS të avancuara me aftësi zbulimi të shpejtë dhe teknologji të sofistikuara bllokimi dhe neutralizimi.

Sistemet kundër dronëve - Teknologjitë kryesore

Sistemet kundër dronëve, të njohura ndonjëherë edhe si sisteme anti-dronë ose C-UAS, mund të jenë pasivë (thjesht duke parë ose dëgjuar) ose aktivë (duke dërguar një sinjal dhe duke analizuar atë që kthehet) dhe mund të performojnë disa funksione duke përfshirë:

- Zbulimin
- Identifikimin dhe Klasifikimin
- Gjetjen dhe gjurmimin
- Gjenerimin e sinjalizimeve dhe/ose aktivizimin e një sistemi bllokimi

Të gjitha funksionet e mësipërme nuk ndodhin ose aktivizohen në të njëjtën kohë, megjithatë, këto janë një zinxhir funksionesh që kryejnë pothuajse në kohë reale pasi të zbulohet një dron.

Ka disa teknologji që ndihmojnë në zbulimin e një droni, bazuar në distancën, lartësinë, llojin, etj., më të zakonshmet janë Radarët, sensorët optikë dhe sensorët akustikë. Këto sisteme jo vetëm që zbulojnë dronët në zonën e mbikëqyrjes, por gjithashtu zbulojnë zogj, balonat apo objekte të tjera fluturuese/lundruese dhe objekte lëvizëse në tokë. Këtu del në pah identifikimi dhe klasifikimi i objekteve. Sistemi identifikon objekte të ndryshme dhe klasifikon dronët nga rrëmuja e madhe. Sistemet e avancuara C-UAS shkojnë një hap më tej për të identifikuar edhe dronin e zbuluar duke kapur modelin, markën, gjurmën dixhitale të gishtit, firmën e radarit, adresën MAC (Kontrolli i Aksesit në Media) etj., duke e bërë të lehtë aktivizimin ose vendosjen e një kundërmase të përshtatshme.

Është e mrekullueshme të zbulosh, identifikosh dhe klasifikosh një dron, megjithatë njohja e vendndodhjes së tij të saktë i mundëson sistemit të vendosë kundërmasa efektive. Sistemet e avancuara C-UAS jo vetëm që mund të lokalizojnë dronët me saktësi, por gjithashtu ofrojnë informacione të tilla si shpejtësia, drejtimi i fluturimit dhe ndihmojnë në gjurmimin e tyre në kohë reale.

Dronët kanë seksion kryq të radarit (RCS) dhe shpejtësi relativisht të ulët - këto karakteristika e bëjnë detyrën e zbulimit të vështirë, dhe më pas identifikimin dhe lokalizimin edhe më shumë. Mund të përdoren disa qasje për të zbuluar këto sisteme ajrore. Këto metoda ose teknologji mund të klasifikohen gjerësisht si:

- Analizuesit e radiofrekuencës (RF)
- Radarët
- Sensorë video/elektro-optikë (EO) (kamera) dhe
- Sensorë audio/akustikë (mikrofonë)

Asnjë nga sa më sipër nuk mund të zbulojë në mënyrë efektive një dron në mënyrë të besueshme. Një sistem efektiv i zbulimit të dronëve duhet të dizajnohet bazuar në diapazonin e mbulimit, këndin dhe mjedisin përreth. Një grup i shumëfishtë sensorësh me një zonë mbulimi të mbivendosur në një arkitekturë me

shtresa është mënyra më e mirë dhe efektive për zbulimin e dronëve. Për shkak të teknologjive me zhvillim të shpejtë të dronëve, shumica e agjencive ushtarake tani po përqafojnë këtë qasje të kundërmasave me shumë shtresa, të cilat ofrojnë raporte më të larta zbulimi në krahasim me sistemet tradicionale.

ANALIZAT E RADIOFREKUENCAVE (RF)

Pothuajse të gjithë dronët përdorin sinjale radio për komunikim, komandim dhe kontroll. Ata marrin komanda nga telekomandat dhe dërgon të dhëna të tilla si video, imazhe, telemetri (vendndodhje GPS/GNSS, statusin e baterisë) etj. përsëri në telekomandë/stacioni tokësor. Analizuesit RF përbëhen nga një ose shumë antena për të marrë sinjale dhe një procesor për të analizuar spektrin RF. Ato mund të përdoren në çdo lloj mjedisi, si urban, kodrinor, i zhurmshëm, pyjor, bregdetar, etj. për të rritur dhe garantuar sigurinë e hapësirës ajrore. Këto nën-sisteme RF janë krijuar për të zbuluar komunikimin radio midis një droni dhe kontrolluesit të tij tokësor. Disa analizues RF mund të identifikojnë prodhimin dhe modelin e dronit duke analizuar nënshkrimin e formës së valës, ndërsa disa mund të identifikojnë edhe adresat MAC të dronit dhe kontrolluesit nëse komunikojnë përmes WIFI. Analizuesit e avancuar RF mund të lehtësojnë gjithashtu hartimin në kohë reale të dronëve dhe telekomandimit. Ka disa përfitime nga përdorimi i analizuesve RF, si p.sh., kosto relativisht e ulët, zbulon shumë dronë në të njëjtën kohë, identifikon nënshkrimin e dronit dhe më e rëndësishmja funksionon në kohë reale. Duke vendosur disa analizues RF njëkohësisht, përdoruesi mund të lokalizojë dronët dhe kontrollorët e tij. Megjithatë ato janë pajisje pasive, asnjë licencë nuk garantohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit.

Megjithatë, analizuesit RF kanë disavantazhe. Nëse një dron nuk po përdor një nënsistem RF (për shembull, duke operuar mbi rrjetin celular 4G/5G ose dronë autonomë/të para-programuar), ai do të jetë plotësisht i padukshëm për një analizues RF. Për më tepër, analizuesit RF mund të zbulojnë gjithashtu pajisje të tjera të ndryshme RF, të tilla si ruterat WIFI, pajisje shtëpiake inteligjente, transmetues të klasës industriale, etj. në afërsi, duke i bërë ato më pak efektive në zonat e mbushura me RF. Prandaj, vetëm sensorët RF mund të mos jenë një zgjidhje e besueshme për zbulimin e dronëve.

RADARËT

RADARI është një tjetër teknologji e njohur për zbulimin e dronëve. Aktualisht, C-UAS të ndryshëm përdorin radarë 2D si dhe 3D për zbulimin dhe vendndodhjen e saktë të dronëve. Radarët 2D janë mjaft të mirë dhe mund të zbulojnë shumicën e llojeve të dronëve në treg. Megjithatë, ata nuk mund të japin informacion për lartësinë e objektivit. Në skenarin e jetës reale, gjurmimi në kohë reale, klasifikimi i saktë dhe sinjalizimi i saktë i sensorëve/nën-sistemeve të tjera në objektiv është një sfidë pa informacionin e lartësisë. Për shembull, një RADAR 2D ndoshta mund të zbulojë një dron që është 500 metra larg dhe 15 gradë në të majtë, por mund të jetë një dron ose një

objekt tjetër lëvizës në tokë. Nga ana tjetër, një RADAR 3D mund të sigurojë gjithashtu informacion shumë të rëndësishëm mbi lartësinë. Prandaj të dhënat nga një RADAR 3D janë më të lexueshme dhe më të përdorshme. Përveç kësaj, një RADAR 3D gjithashtu mund të drejtojë me saktësi Kamerën ose një "Jammer" drejt dronit të zbuluar.

Radarët me grup aktiv elektronik të skanuar (AESA) janë lloje radarësh me grupe me faza që përdorin antena të shumta në një grup dy-dimensional për të transmetuar të njëjtën formë valore të zhvendosur në fazë, duke përdorur parimin e formimit të rrezes.

Këta RADARË AESA funksionojnë më shumë si një sy njeriu, ku duhet të fshini retinën nga një cep në tjetrin për të vëzhguar të gjithë pamjen. Nga ana tjetër, radarët me shumë dalje me hyrje të shumëfishta (MIMO), mund të transmetojnë forma të ndryshme valore në të gjitha antenat, duke funksionuar më shumë si syri i mizës, ku ju merrni të gjithë pamjen menjëherë pa pasur nevojë për fshirje. RADARËT MIMO japin ritëm të mahnitshëm rifreskimi, i cili përmirëson në mënyrë dramatike zbulimin dhe gjurmimin, duke përfshirë tufat. Ndhmon gjithashtu në heqjen efektive të rrëmujës së tokës.

Një nga sfidat e përdorimit të RADARIT është se lartësia e ulët, shpejtësia e fluturimit dhe seksioni shumë i vogël i radarit (RCS) i bëjnë ato jashtëzakonisht të vështirë për t'u dalluar nga zhurma ose rrëmuja. Kjo mund të kapërcehet duke vendosur sensorë të tjerë në C-UAS.

SENSORËT VIZUAL DHE PËRPUNIMI I IMAZHIT

Kamerat me sensor elektro-optik (EO) (Plumb / PTZ / Termike / Ditë-Natë) të kombinuara me softuerin e përpunimit të imazhit të bazuar në Inteligjencën Artificiale (AI) mundësojnë zbulimin dhe klasifikimin vizual të dronëve. Bazuar në numrin dhe llojet e kamerave, sensori EO mund të mbulojë një fushë shikimi (FoV) nga 30 gradë deri në 360 gradë. Sistemet e bazuara në OE ofrojnë kamera të dedikuara për zbulim, klasifikim dhe gjurmim. Sensorët EO ofrojnë një dëshmi vizuale të pranishmë të dronit në rajonin e mbulimit. Këto sisteme mund të bëhen plotësisht autonome, por diapazoni i tyre zakonisht kufizohet nga gjatësia fokale dhe aftësitë e zmadhimit optik të lentes së kamerës. Aktualisht, kamerat në treg ofrojnë një gamë zbulimi deri në 2-3 km, e cila mund të reduktohet më tej në bazë të kushteve klimatike si retë, pluhuri, shiu ose mjegulla.

SENSORËT AKUSTIKË

Sensorët akustikë janë një mikrofoni ose një grup mikrofonësh, të cilët zbulojnë tingullin e bërë nga droni dhe llogaritin drejtimin e tij. Këta sensorë mund të përdoren sa herë që pengohet linja e shikimit të radarëve. Sensorët akustikë kushtojnë relativisht më pak, gjë që e bën atë ekonomikisht të realizueshëm.

Disa grupe mikrofonash mund të përdoren për lokalizimin e përafërt të objektivit. Sensorët akustikë mund të mos jenë idealë për të gjetur objektivin, megjithatë, ata mund të ofrojnë drejtimin e dronit. Ata kanë disa kufizime të tjera si p.sh. jo efikasiteti në kushtet mjedisore me zhurmë dhe diapazoni i shkurtër i zbulimit

(Max 300 - 500 metra), etj.

Pajisje të tjera kundërmasash ndaj dronëve

Këto kundërmasa mund të grupohen si: Duke shkatërruar fizikisht dronin, neutralizimi i dronit dhe marrja e kontrollit të dronit

Është e rëndësishme të theksohet se, megjithëse teknologjia është e disponueshme, rregulloret aktuale në shumicën e vendeve ndalojnë përdorimin e ndonjë prej teknologjive të mëposhtme për t'u përdorur për neutralizimin e dronëve. Ndonjëherë bëhen përjashtime për agjencitë ushtarake ose të zbatimit të ligjit.

"Dronegun"



Dronesield

"Dronegun" është zhvilluar nga kompania austriake "DroneShield". Ai bllokoi sinjalin midis dronit dhe pilotit të dronit. Është një pajisje në formë pushke që përdor bllokimin e frekuencës së radios dhe bllokimin GPS për të luftuar dronët. Sistemi thyen lidhjen midis dronit dhe pilotit të tij, aktivizon "rënie të sigurt" për të dërguar dronin në shtëpi dhe ka aftësinë për të bllokuar sinjalet.

"DroneCatcher"



"DroneCatcher" është një dron me shumë helika, i armatosur me armë rrjetë i projektuar nga "Delft Dynamics". Sistemi eliminon në mënyrë të sigurt dronët e paligjshëm nga ajri. Me përdorimin e sensorëve të shumtë në bord, arma e rrjetës mbyllet në objektin, droni më pas kapet me shpejtësi duke gjuajtur një rrjetë. Pas kapjes, DroneCatcher e çon dronin e kapur në një kablo në një vend të padëmshëm dhe e lëshon atje. Nëse droni i kapur është shumë i rëndë për t'u mbajtur, ai e lëshon atë me një parashutë ndihmëse për të siguruar ndikim të ulët në tokë.

"SkyWall 100"

"SkyWall 100" është një sistem i automatizuar i lëshimit të rrjetës që kap fizikisht një dron të paprekur me rrezik të ulët dëmtimi të dronit ose zonës përreth. Është projektuar nga OpenWorks engineering. Sistemi përdor ajrin e kompresuar për të nisur një predhë deri në dronin pasi operatori e ka shënjestruar atë duke përdorur Smart-Scope në bord. SkyWall100 mund të përdoret si një zgjidhje e pavarur e mbrojtjes së dronëve, por gjithashtu mund të integrohet me një sistem më të gjerë sigurie, duke përdorur modulën skylink, për të ofruar një paketë kundër dronëve shumë të aftë. Një sistem i vetëm SkyWall100 mund të mbrojë një zonë ose sisteme të shumta mund të vendosen nga njësitë celulare për të mbrojtur një vend të madh.

"SkyDroner"

"SkyDroner" zbulon, shpërqendron dhe çaktivizon dronin që të fluturojë në një zonë të mbrojtur. Sistemi përbëhet nga sensorë të shumtë për të monitoruar gamën e sinjaleve të radios dhe për të identifikuar karakteristikat e ndryshme të nënshkrimit të një droni. Sistemi monitoron aktivitetin e një droni brenda rrezes 1 km, identifikon llojet e dronëve dhe ofron gjurmim në kohë reale të rrugës së fluturimit duke përcaktuar vendndodhjen e dronëve dhe operatorëve të tij. Pas zbulimit, sistemi mund të shpërqendrojë një dron duke marrë përsipër frekuencat e komandës dhe kontrollit dhe më pas çaktivizon lidhjet e komunikimit me dronët.

Sistemi "Sky Fence"

Sistemi "Sky Fence" - "gardhi qiellor" është ndërtuar posaçërisht për sigurinë e burgut. Ai përfshin një numër të ndërprerësve të sinjalit, të krijuar për të bllokuar sinjalin e kontrollit të fluturimit të një droni dhe për të parandaluar fluturimin mbi instalimin dhe ndërprerjen e transmetimeve të tyre të navigimit.

Lazer me energji të lartë

Sistemi lazer kundër dronëve është një pajisje optike me fuqi të lartë që prodhon një rreze drite jashtëzakonisht të fokusuar ose rreze lazer. Lazeri mposht dronin duke shkatërruar strukturën dhe/ose elektronikën.

Kjo pajisje ndalon fizikisht dronin, por ka dhe efekte anësore negative si kosto të lartë, rrezik

dëmtimi kolateral, sistem me përmasa të mëdha madh, dhe mbetet kryesisht teknologji eksperimentale.

Zogjtë grabitqarë



Zogjtë janë përdorur për gjueti nga njeriu për mijëra vjet, por shqiponjat janë trajnuar edhe për të kapur sistemet e avionëve të vegjël pa pilot (SUAS) dhe dronët komercialë. Kjo zgjidhje përfiton nga instinktet natyrore të gjuetisë që përdoren nga shqiponjat. Kjo mund të jetë një zgjidhje e teknologjisë së ulët, por kërkon shumë fuqi punëtore për stërvitje (të paktën 1 vit për zog) dhe për mirëmbajtjen e zogjve grabitqarë.

Si përfundim një sistem efektiv dhe i besueshëm kundër dronëve duhet të ketë teknologji të zbulimit, identifikimit, klasifikimit, lokalizimit, gjurmimit dhe kundërmasave për çdo mot, së bashku me një softuer të hapur C2, i cili lejon integrimin e një shumëllojshmërie të gjerë sensorësh të palëve të treta. Futja e Inteligjencës Artificiale po mundëson shumë sistemet e zbulimit të dronëve duke rritur efikasitetin dhe duke reduktuar alarmet e rreme. Më tej, Algoritmet e Inteligjencës Artificiale sigurojnë inteligjencën e nevojshme për funksionimin autonom, duke reduktuar kështu varësinë nga njerëzit për të shkaktuar një kundërmasë. Një C-UAS i avancuar duhet të ketë një rreze zbulimi minimale prej 10 km, një kombinim të sensorëve të shumtë që përfshijnë kamera EO, radar, analizues RF, detektorë WIFI, sensorë akustikë dhe bllokues, një gamë të gjerë me lloje dronësh, softuer C2 të integrueshëm me sensorët COTS, së bashku me funksionimin e vazhdueshëm autonom.


Trashëgimia kulturore shqiptare, identitet kombëtar

Letërsia Shqiptare

Në kulturën e shqiptarëve ka lënë gjurmën e saj të thellë historia e tyre e brendshme dhe e jashtme. Pjesë e trevave të lashta ilirike, udhë kryqëzimi e qytetërimeve dhe e interesave gjeopolitike gjatë dyndjeve barbare e më pas, provincë e perandorive të Perëndimit dhe të Lindjes, të Romës e të Bizantit, pasi kishte bërë e ç'bërë gjatë shekujve, despotate e principata të pavarura, dhe pasi kishte formuar më së fundi shtetin e Skënderbeut, i cili u qëndroi për një çerekshkulli hordhive osmane.

Vendi ishte kthyer pas, në një fazë zhvillimi ekonomiko-shoqëror historikisht të kapërcyer. Rrjedhat normale të kulturës shqiptare, që ecte në një hap me humanizmin evropian, u ndërprënë. Pasoja e parë e pushtimit ishte hemorragjia e elitës intelektuale në Perëndim. Prej saj u shquan figura, që bënë emër në botën humaniste, si historiani M. Barleti (1460-1513), që botoi në Romë më 1510 një histori të Skënderbeut, e cila u përkthye thujse në të gjitha gjuhët e Europës, ose M. Beçikemi (1408-1526), Gj. Gazulli (1400-1455), L. Tomeu (1456-1531), M. Maruli (shek. XV), M. Artioti (1480-1556) e të tjerë, që u dalluan në fusha të ndryshme të shkencës, të artit e të filozofisë.

Ndërkaq, në vend jeta kulturore u fashit, monumentet e kulturës materiale e shpirtërore u zhdukën nën rrënojat e shkatërrimit të luftërave; gjysmëhëna e uli kryqin dhe gati dy të tretat e popullatës në fund të shek. XVII ishin konvertuar në fenë islame. Por ky ndryshim drastik i strukturës fetare nuk pengoi që Shqipëria të



ishte përherë një nga provincat më të paqeta të Perandorisë dhe as që kultura shqiptare të mbijetonte edhe në kushtet e një pushtimi disa-shekullor, nën tryshninë e islamit e të botës kulturore të orientit, që pati një ndikim të thellë e të gjithanshëm në të, veçse pa arritur të shtypë natyrën shqiptare të kulturës vendëse.

Qëndresa në fushën e kulturës u shpreh në radhë të parë përmes lëvritimit të shqipes në lëmë të botimeve të teksteve kishtarë, kryesisht të qarkut konfesional katolik në veri, por edhe ortodoks në jug. Reforma protestante gjallëroi shpresat e zhvillimit të gjuhës e të traditës letrare vendëse kur prifti Gj. Buzuku solli në shqip liturgjinë katolike, duke dashur të bëjë për shqipen atë që bëri Luteri për gjermanishten.

"Meshari" i Gj. Buzukut, botuar prej tij më 1555, mbahet deri më sot,

si e para vepër e shqipes së shkruar. Niveli i përpunuar i gjuhës dhe ortografia e stabilizuar duhet të jetë rezultat i një tradite më të hershme të shkrimit të shqipes, traditë që nuk njihet. Por ekzistojnë disa dëshmi fragmentare më të hershme se vepër e Buzukut, të cilat flasin për shkrimin e shqipes të paktën nga shek. XIV: E para dëshmi që njihet është e vitit 1332, e dominikanit frëng Gulielm Adale, kryepeshkop i Tivarit, i cili në një relacion latinisht shkruan se shqiptarët kanë në përdorim në librat e tyre shkronjat latine edhe pse gjuha e tyre është fare e ndryshme nga latinishtja. Me rëndësi të veçantë janë: Një formulë pagëzimi (Unte paghesont premenit Atit et Bizit et spertit senit) e vitit 1492, shkruar shqip brenda një teksti latinisht, nga peshkopi i Durrësit Pal Engjëlli; një fjalor me glosa shqip i vitit 1497, i

gjermanit Arnold fon Harf, i cili pat kaluar si udhëtar në Shqipëri dhe një fragment nga Ungjilli i Shën Mateut, po shqip, por me shkronja greqisht, i shekullit XIV.

Shkrimet shqip të këtyre shekujve s'duhet të kenë qenë vetëm tekste fetare, por dhe kronika historike, për të cilat flet humanisti M. Barleti, i cili në librin e tij "Rrethimi i Shkodrës" (1504) pohon se ka pasur në dorë kronika të tilla të shkruara në gjuhën e popullit (in vernacula lingua).

Me gjithë pengesat që krijoi Kundër-reforma për lëvrimin e gjuhëve nacionale në literaturën kishtarë, ky proces nuk u ndërpre. Gjatë shek. XVI-XVII u botuan në shqip katekizma "E mbësuar me krishterë" (1592) e L. Matrëngës, "Doktrina e krishterë" (1618) dhe "Rituale romanum" (1621) të P. Budit, shkrimtari i parë i prozës dhe i poezisë origjinale shqipe, një apologji për Gjergj Kastriotin (1636) nga F. Bardhi, i cili botoi edhe një fjalor e lëndë folklorike, traktati teologjik-filozofik "Çeta e Profetëve" (1685) i P. Bogdanit, mendja më universale e mesjetës shqiptare.

Vepra e Bogdanit është një traktat teologjik-filozofik që trajton me origjinalitet, duke shkruar të dhëna nga burime të ndryshme, çështje kryesore të teologjisë dhe një histori biblike të plotë, si dhe probleme të komplikuar të skolastikës, të kozmogonisë, astronomisë, pedagogjisë, etj. Bogdani solli në kulturën shqiptare frymën humaniste dhe vlerësoi rolin e dijes e të kulturës në jetën e njeriut; ai me veprën e tij të shkruar me një shqipe e stil të përpunuar, shënoi një kthesë në historinë e letërsisë shqipe.

Gjatë shekullit XVIII njohu një gjallërim më të madh literatura e qarkut kulturor konfensional ortodoks e mysliman. Një anonim prej Elbasanit sjell në shqip copa të ungjillit, T. H. Filipi, po prej Elbasanit, "Dhjatën e Vjetër dhe të Re".

Këto përpjekje u shumuan në shekullin e ardhshëm, me botimin më 1827 të tekstit integral të "Dhjatës së Re" nga G. Gjirakastri dhe me korpusin e madh të përkthimeve kishtarë të K. Kristoforidhit (1830-1895), në dy dialektet e shqipes, botime që ndihmuan procesin e integritetit të tyre në një gjuhë letrare të njëjësuar dhe vunë bazat për krijimin e kishës kombëtare të shqiptarëve me liturgjinë në gjuhën e tyre.

Ndonëse në kahe të kundërt me këtë prirje, duhet përmendur edhe kultura e Voskopojës, e cila gjatë shek. XVIII u bë një vatër e madhe qytetërimi dhe metropol i gadishullit ballkanik, me një Akademi të shtypshkronjës dhe me personalitete si T. Kavalioti, Dh. Haxhiu, G. Voskopojari, veprat diturore, filologjike, teologjike e filozofike të të cilëve objektivist i ndihmonin shkrimin e njohjes së shqipes.

Edhe pse letërsia që u zhvillua në Voskopojë, ishte kryesisht në gjuhën greke, nevoja për t'i vënë gardh islamizmit, bën të domosdoshme edhe përdorimin e gjuhëve amtare, duke inkurajuar zhvillimin e kulturave kombëtare. Në shkollat e Voskopojës u përdorën dhe arumanishtja e shqipja për mësimin e greqishtes, kurse në shtypshkronjën e saj u shtypën edhe libra arumanisht.

Veprat e shkrimtarëve dhe ditëtarëve të Voskopojës kanë sjellë disa elemente të ideve të iluminizmit evropian. Më i shquari ndër ta, Teodor Kavaljoti është një erudit i kohës. Sipas dëshmive të profesorit gjerman Thunman, vepra e Kavaljotit, që mbeti e pabotuar, në pjesën më të madhe ka trajtuar çështje pothuajse nga të gjitha degët e shkencës filozofike. Në të ndjehet ndikimi i Platonit, Dekartit, Malëbranshit dhe Leibnicit.

Rezultat i ndikimit të islamit dhe të kulturës së pushtuesit, ishte formimi gjatë shek. XVIII i një shkolle poetike, ose i një letërsie të shkruar në gjuhën shqipe, por me alfabetin arab. Autorë të saj si: N. Frakulla, M. Kyçyku, S. Naibi, H. Z. Kamberi, Sh. e D. Frashëri, Sheh Mala, e të tjerë, trajtuan në veprat e tyre motive të huajtura nga letërsitë orientale, shkruan me vlludë e divane me një gjuhë të mbytur nga orientalizmat, lëvruan lirikën dhe epin religjioz. Kjo shkollë nuk pati jetë të gjatë dhe as ndikim të veçantë në zhvillimet e pastajme letrare. Për të plotësuar kuadrin e zhvillimit kulturor të Shqipërisë në shek. XVI-XVIII duhet shënuar, se pati nga autorë vendës vepra të shquara në fushë të arkitekturës dhe të pikturës ikonografike, ku u dalluan Onufri dhe i biri Nikolla (shek. XVI) dhe K. Shpataraku e D. Selenica (shek. XVIII) të cilët vazhduan traditën e artit fetar post-bizantin, por jo pa ndikime nga Rilindja evropiane. Në fushë të artit islam mund të përmenden kryesisht ndërtimet e kultit.

Shekulli XIX, shekulli i lëvizjeve nacionale në Ballkan, i gjente shqiptarët

pa një traditë të mjaftueshme të zhvillimit shtetëror, gjuhësor e kulturor unitar, me një mendësi individualiste dhe regjionaliste, të trashëguar nga psikologjia e bajrakut dhe e fisit, për pasojë me një vetëdije kombëtare të pazhvilluar, por me një shpirt rebelimi spontan. Në këtë situatë historiko-kulturore nisi të merrte jetë një lëvizje e organizuar mendore dhe letrare që mori emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare. Ajo u frymëzua nga idetë e romantizmit nacional dhe të iluminizmit, që u kultivuan në rrethet e inteligjencës shqiptare, e cila jetonte kryesisht në mërgim, në kolonitë e vjetra shqiptare në Itali dhe në ngulimet më të reja në Stamboll, Bukuresht, SHBA, Sofje e Kajro.

Ringjallja nacionale e shqipes si gjuhë e kulturës, organizimi i arsimit kombëtar dhe themelimi i letërsisë kombëtare, në rrafshin kulturor, si dhe krijimi i shtetit të pavarur, në rrafshin politik, këto ishin synimet e kësaj lëvizjeje prej së cilës lindi shkolla e romantizmit shqiptar. Ishte ky një romantizëm tipik ballkanik, i mbrujtur me frymën e çlirimit kombëtar, me nostalgjinë e mërgimtarit dhe me patosin retorik të evokimit të mesjetës shqiptare, domethënë të luftërave të Gjergj Kastriotit. Kjo shkollë letrare lëvroi kryesisht poezinë. Heroi i saj ishte njeriu etik, shqiptari luftëtar, e më pak njeriu tragjik. Nga motivet dhe format poetike, ajo ka lidhje të ngushta me traditën folklorike.

Gjurmimi i kësaj tradite dhe botimet në fushë të saj ("Rapsodi të një poeme arbëreshe" më 1866 nga De Rada, "Përmbledhje të këngëve popullore dhe rapsodi të poemave shqiptare" më 1871 nga Z. Jubani, "Bleta shqiptare" më 1878 nga Th. Mitko, etj.), ishin pjesë e programit kulturor të Rilindjes Kombëtare për afirmimin e identitetit etno-kulturor të shqiptarëve.

Dy janë përfaqësuesit më të mëdhenj të romantizmit shqiptar të shek. XIX: J. De Rada (1814-1903), lindur e vdekur në diasporën shqiptare në Itali e shkolluar atje dhe N. Frashëri (1846-1999), lindur në Shqipëri, i shkolluar në Zosimea të Janinës, por i mërguar dhe vdekur në Stamboll. I pari është poeti romantik shqiptar i rritur në klimën e romantizmit evropian, i dyti romantiku shqiptar që tret në poezinë e tij ndikimet e poezisë lindore, sidomos persiane, me frymën dhe shpirtin e poezisë së romantizmit perëndimor.

Kontributi shqiptar në panteonin e vlerave botërore

KARL GEGA

Karl Gega, figurë e shquar shqiptare e teknikës hekurudhore në shek. XIX, ndërtuesi gjenial i hekurudhës së famshme të Semmeringut. Karl Gega lindi në Venedik, më 10 janar 1802 dhe vdiq në Vjenë, më 14 mars 1860, duke vrarë veten nga dëshpërimi. Të parët e Karlit kishin mërguar në Venedik së bashku me shumë bashkatdhetarë të ikur nga Shqipëria Veriore, pas pushtimit osman.

Si individ, Karl Gega u zhvillua para kohe. Mbasi kreu një kolegji për filozofi e matematikë me rezultate të shkëlqyera, në moshën 15-vjeçare u

regjistrua në Universitetin e Padovës. Vetëm mbas një viti u diplomua në degën e inxhinierisë. Më 1819, kur sapo kishte mbushur 17 vjeç merr titullin "Doktor në matematikë".

Iu kushtua ushtrimit praktik të inxhinierisë në shërbim të hekurudhave të Mbretërisë Lombardo-Venete (krahinë e Perandorisë Austriake), duke u marrë edhe me trasimin e rrugëve, kanaleve dhe ndërtimin e godinave të mëdha. Ai punoi në hapjen e rrugës së madhe malore në provincën e Belunos. Gjatë periudhës 1824-30 në provincën e Trevi-

sos, në një pjesë rruge drejtoi punimet edhe nga ana hidraulike.

Nga 1830-1833 ishte inxhinier në Rovigo dhe pastaj deri në vitin 1836, u caktua në departamentin e ujërave pranë Drejtorisë së Buqësisë në Venedik. Në vitin 1840 u gradua dhe u bë zëvendës në Drejtorinë e Ndërtimeve për mbarë Tirolin. Aty projektoi rrugën malore që kalon nëpër Val Sugana, pastaj atë që kalon nëpër Oberinntal, tek Qafa e Finstermünzenit dhe bëri projektin e urës së varur mbi Etsh pranë Mores. Në vitin 1848, si inspektor i Drejtorisë së Përgjithshme të Ndërtimeve, drejton ndërtimin e hekurudhave të Jugut deri në Laihah.

Në këtë kohë bëri një udhëtim të gjatë studimi në Gjermani, Belgjikë, Francë e Angli dhe, me t'u kthyer, hyri përsëri në shërbimin e hekurudhave shtetërore dhe u mor me trasimin e linjës hekurudhore të Semmeringut, tunel i gjatë 1430 metra. Asokohe diskutohej lidhur me mundësinë e trasimit të një hekurudhe me aderencë të thjeshtë. Kësaj zgjidhjeje ai iu kushtua mbas një udhëtimi të ri në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Angli. Më 1849 u bë

drejtor i Seksionit të Ndërtimit të Hekurudhave dhe më 1850 drejtor i drejtorisë së përgjithshme për ndërtimin e hekurudhave shtetërore në Vjenë.

Zgjidhja e problemit të hekurudhës së Semmeringut nga Karl Gega u kundërshtua nga shumë specialistë, mbasi asokohe diskutohej shumë rreth vështirësive që lokomotiva të ngjitej në atë lartësi me kaderencë të thjeshtë, por eksperiencia provoi se ishte një gjë e mundshme, siç e kishte parashikuar ai, që lokomotiva me tren të përshkonte një pjerrësi 25‰ dhe rreze 180 metra. Në vitin 1860 përfundoi kjo linjë që është shembulli i parë i hekurudhave malore.

FERID MURATI

Ferid Murati lindi më 14 shtator të vitit 1936 në Whiting, Indiana, SHBA, nga Xhabir Murad Ejupi (i ati shqiptar) dhe Henrieta Bowman (e ëma amerikane). Ferid Murati është studiues shqiptaro-amerikan i medicinës, fitues i Çmimit Nobel për medicinë në vitin 1998.

Ai është diplomuar në Universitetin e Virxhinias, ku gjithashtu u emërua profesor në vitin 1970. Aty ka punuar deri në vitin 1981 para se të zhvendosej në Stanford.

Studimet e tij janë përqendruar në efektin e nitroglicerinës në trupin e njeriut. Ai ka punuar mbi këtë temë për vite të tëra bashkë me Robert Furchgott dhe Louis Ignarro. Të tre bashkë fituan çmimin Nobel në 1998. Një nga sukseset më të mëdha profesionale të Ferid Muratit është shpikja e Viagras, tashmë me famë në të gjithë botën. Murati dhe kolegët e tij zbuluan përparësitë vitale biologjike të NO gaz pa ngjyrë dhe erë, që i sinjalizon enët e gjakut të relaksohen, zgjerohen dhe kjo qon deri te aplikimi i pilulave kundër impotencës (Viagra). Kjo përmirëson qarkullimin e gjakut dhe e ul tensionin e gjakut.

Ky zbulim ka një rang të lartë aplikimesh, duke përfshirë këtu trajtimin e sëmundjeve të zemrës dhe mundësinë e frymëmarrjes më të lehtë të foshnjave të lindura para kohe.

Profesori universitar dhe hulumtuesi dr. Ferid Murati, është fitues i çmimeve dhe mirënjohjeve të shumta për hulumtime në sferën e mjekësisë. Arritja më e rëndësishme në veprimtarinë e tij shkencore dhe hulumtuese është



marrja e Çmimit Nobel për mjekësi dhe fiziologji në vitin 1998 për zbulimin lidhur me zbatimin e oksidit nitrik si molekulë sinjalizuese në sistemin kardio-vaskular:

LAURA MERSINI

Laura Mersini lindi në Tiranë, Shqipëri, si vajza e matemtikanit dhe ekonomistit të shquar Nexhat Mersini. Mersini u diplomua së pari në Universitetin e Tiranës, Shqipëri. Në 1994, ajo studioi në Universitetin e "Maryland College Park" për 8 muaj. Në vitin 1997, iu dha Master Shkencor nga Universiteti i Maryland. Në vitin 2000, përfundoi doktoraturën e saj në Universitetin e Wisconsin-Milwaukee.

Nga viti 2000 deri në vitin 2002, pasi mori doktoraturën e saj, Mersini ishte një studente post-doktorale në shkollën italiane "Scuola Normale Superiore di Pisa". Nga viti 2002 deri në 2003, Mersini mori një bursë post-doktorale në Universitetin e Sirakuzës. Në janar 2004, pranoi një pozicion si asistent profesor i fizikës teorike dhe kozmologjisë në Universitetin e Karolinës së Veriut.

Në 2004-2006 në një seri punimesh ajo prezantoi teorinë e origjinës së universit nga multiversi dhe bëri një sërë parashikimesh, duke përfshirë zbrazëtinë gjigante, që është në gjendje të testojë teorinë. Asaj iu dha mandati në vitin 2008 dhe u promovua si profesoreshë e asociuar në vitin 2009 dhe profesoreshë e rregullt më vonë.

Më 11 tetor 2010, ajo u shfaq në një program të BBC-së të titulluar "Çfarë ndodhi përpara Big Bang-ut" (së bashku me Michio Kaku, Neil Turok, Andrei Linde, Roger Penrose, Lee Smolin dhe fizikanë të tjerë), ku ajo propozoi teorinë e saj të universit si një funksion valor në multiversin e peizazhit. Puna e Mersinit mbi teorinë e multiversit diskutohet në epilogun e një biografie të botuar së fundmi të Hugh Everett III. Parashikimet e saj u testuan me sukses kohët e fundit nga eksperimenti satelitor "Planck". Në shtator 2014, Mersini pretendoi të demonstronte matematikisht se, duke pasur parasysh supozime të caktuara rreth mureve të zjarrit të vrimave të zeza, teoritë aktuale të formimit të vrimave të zeza janë të meta. Ajo pohoi se rrezatimi "Hawking" bën që ylli të hedhë masë në një shkallë të tillë që nuk ka më densitetin e mjaftueshëm për të krijuar një vrimë të zezë. Me Stephen Hawking, ajo organizoi një konferencë historike në 2015 në Stokholm për të diskutuar këto tema themelore.

NIKO QAFOKU

U diplomua me rezultate të shkëlqyera në Universitetin Bujqësor të Tiranës në vitin 1984 në Fakultetin e Agronomisë (sot Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit). Pas diplomimit u emërua asistent pedagog në katedrën e Tokave dhe Ushqimit Bimor. Ai punoi në këtë Fakultet si pedagog, përgjegjës katedre dhe zv. Dekan për kërkimin deri në vitin 1992. Në vitin 1990 mbrojti Doktoratën (atëherë Kandidatura e Shkencave) në fushën e të ushqyerit të bimëve.

Në vitin 1994 fiton një Bursë Fulbright dhe Shpërngulet Shtetet e Bashkuara ku vazhdoi studimet njëkohësisht në Doktoratë në Shkencën e Tokës dhe Master në Statistike, të cilat i mbrojti me sukses në vitin 1998.

Prej vitit 1998, Niko Qafoku punon në "Pacific Northwest National Laboratory", një nga institucionet më prestigjioze në botë në fushën e tokës dhe mjedisit. Në këtë institut Niko Qafoku ka arritur nivelin më të lartë të kërkuesit që ka ky institucion (Chief Scientist Level 5) dhe ishte udhëheqës i një grupi shkencëtarësh në fushën e gjeokimisë. Punimet e tij janë cituar mbi 3100 herë. Për punën shkëlqyer të bërë dr. Qafoku është nderuar me çmime të shumta kudo që ka punuar.

Në Universitetin e Georgias, ku edhe kreu studimet në vitin 1998, mori çmimin si "Pedagog i shquar", në vitin 2005, 2007 dhe 2009 merr çmimin për performancë të lartë të kërkimit në PNNL, në vitin 2009 si zv. kryeredaktor i "Soil Science Society of America Journal", mori çmimin për ekselencë në citim. Në Institutin ku punon ka marrë tre herë çmimin për Artikullin më të mirë të botuar (2015, 2016, dhe 2019) dhe është nderuar dy herë për Kontribut të jashtëzakonshëm (2014 dhe 2016).

Në vitin 2019 Niko Qafoku nderohet me çmimin "Jackson Soil Chemistry and Mineralogy Award, Soil Science Society of America". Në fjalën e tij për dhënien e këtij Çmimi shumë të rëndësishëm prof. Hochella, ish-president i shoqatës e tha që: "Dr. Qafoku njihet si një nga eksperimentuesit më të mirë të kolonave të tokës në botë... Lidhur me nanoshkencën e tokës, njohuritë e tij janë të rralla dhe të thelluara e bile edhe revolucionare në fushën e tij. Janë të paktë shkencëtarët e tokës, kudo në botë, që kanë njohuri kaq të thelluara në nanoshkencë sa Dr. Qafoku".

Po në vitin 2019 për arritjet e tij në punën shumëvjeçare, laboratorit ku punon, e nderoi me çmimin "Laboratory Fellow" që është çmimi më i lartë që mund të japë ky institucion prestigjioz. Njoftimi thekson gjithashtu se, PNNL u jep titullin "Laboratory Fellow" ose "Battelle Fellow", atyre shkencëtarëve kërkues që kanë arritur majat e fushës së tyre, e që kanë fituar njohje ndërkombëtare nga kolegët, por edhe atyre që, njëkohësisht, demonstrojnë vazhdimisht krijimtari dhe prodhimtari të lartë në punën e tyre, në nivelet më të përsosura shkencore të profesionit të vet.

Dr. Qafoku është nderuar nga "Shoqata Amerikane e Shkencës së Tokës" me çmimin "Fellow of Soil Science Society of America" që është çmimi më prestigjioz që jep "Shoqata e Shkencës së Tokës" në SHBA. Ky titull i jepet 0.3% të anëtarëve të kësaj shoqate me rreth 6000 anëtarë. Niko Qafoku është i pari shkencëtar shqiptar që merr një titull të tillë.

Megjithëse është larguar prej gati 30 vitesh, Niko Qafoku asnjëherë nuk është shkëputur nga Shqipëria dhe Universiteti ku ai u diplomua. Në vitin 2003 Niko Qafoku themeloi Insti-



tutin "Alb-Shkenca", institut që bashkon studiues shqiptarë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe diaspora. Ky institut ka organizuar deri më sot 14 konferenca shkencore, ku kanë kontribuar me qindra studiues shqiptarë nga vende të ndryshme të botës dhe njëkohësisht ofron AKTET - Revista shkencore e Institutit "Alb-Shkenca" (ISSN 2073-2244). Në vitin 2014, Niko Qafoku ka marrë titullin "Profesor" nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

EDOR KABASHI

Edor Kabashi, shkollën fillore dhe të mesme e ka përfunduar në Durrës, ndërsa në vitin 1995 së bashku me familjen e tij emigruan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Studioi për biologji dhe psikologji në "Mount Saint Mary's College" në Emmitsburg, Maryland, SHBA.

Më vonë studimet i vazhdoi në Francë e më pas në Montreal në Kanada, ku u diplomua në biologji në vitin 2000. Në këtë vend Edori në vitin 2006 mori gradën doktor në neurologji dhe neurokirurgji.

Ai mori çmimin nga Presidentit Bill Clinton si një nga studentët më të mirë të Amerikës.

Në vitet 2008 dhe 2011 fitoi çmimin "Brain Star" nga Instituti i Kërkimeve në Fushën e Shëndetit Mendor, në Kanada.

Prej vitit 2011, ai drejton grupin kërkimor në departamentin e sëmundjeve neuro-degenerative, në Institutin e Neuro-shkencës në Paris, Francë.

38-vjeçari nga Durrësi u nderua si shkencëtar i mirë i grup-moshës nën 40 vjeç falë punës shkencore të tij në fushën e gjenetikës, në specializimin e ngushtë të sëmundjes së ALS-së -Skleroza Amiotrofike Laterale.

"Çmimi ENCALS për Hulumtuesit e Rinj ka për qëllim identifikimin e shkencëtarëve më të aftë dhe më të zgjuar dhe jepet për kërkime në çështje të pazgjidhura në lidhje me sëmundjen ALS", -shkruhet ndër të tjera në motivimin e çmimit për dr. Kabashin.

KLEJDA BEGA

Klejda Bega, një nga shkencëtarët më në zë sot në fushën e fizikës. Ashtu si qindra studiues të tjerë, udha e saj drejt hulumtimit duket krejt e rastësishme. Për të ishte idhull frymëzimi Mari Kyri. Klejda ishte vetëm 9 vjeçe kur i ra në dorë një biografi e shkencëtares së famshme shkruar me shumë dashuri nga e bija Iv Kyri.

Arsimin tetë vjeçar e kreu në shkollën "Naim Frashëri" dhe arsimin e mesëm në shkollën "Dhaskal Todri".

Më pas zhvendoset në Tiranë në gjimnazin "Sami Frashëri". Por, falë dhuntive që zotëron, fiton të drejtën për të përfunduar "Riverside School" në Zvicër. Në klasën e tetë dhe në vitin e dytë në gjimnaz, Klejda mori pjesë në olimpiadat kombëtare dhe ballkanike të matematikës, ku u nderua me çmimin e parë në Shqipëri në vitin 1990-1992 si dhe çmimin e tretë në Ballkan po në këtë vit edhe pse ishte shumë më e vogël se konkurrentët e tjerë. Ekselencia e saj tërheq vëmendjen e mësuesve ndërsa aplikon për të studiuar në universitete të famshme në botë.

Fiton bursë që mundëson përfundimin e studimeve të larta në "California University Technology" në Pasadena, një universitet nga më të njohurit në glob, sidomos për fizikë. 33 pedagogët e këtij universiteti kanë marrë çmimin Nobel në këtë fushë. Ajo u diplomua nga Caltech për fizikë me mesataren më të lartë të mundshme. Në vitin 1999 fillon doktoraturën për fizikë të thërmijave. Eksperimentin për tezën e doktoraturës e kreu në laboratorin e fizikës në "Stanford University", rezultatet e të cilit u botuan në revista shkencore mes të cilave në "Physical Review Letter". Në vazhdimësi të karrierës fitoi një bursë nga "Shoqata Amerikane e Fizikës" që të kryente punë kërkimore në "Columbia University" në New York në fushën e fizikës atomike dhe specifikisht në optikë kuantike. Krahas kësaj ajo u ftua lektore në "Columbia University", ku jep një kurs të detyruar me titullin "Kufijt e Shkencës". Pas përfundimit të shkollës së lartë ndërmerr një nga vendimet më të guximshme të jetës. Të kryejë eksperimente dhe zbulime e të mbrojë doktoraturën.

Pas përfundimit të doktoraturës i ofrohet një vend si lektore në "Columbia University". Jep një lëndë e cila është ekskluzivitet i "Columbia University". Më pas atë e kanë kopjuar edhe universitete të tjera. Universiteti ka disa lëndë të tilla që e dallon atë nga të tjerët.

Çmimi Nobel është shpërblimi më i madh për çdo zbulues. Por Klejda është mjaft modeste edhe nëse do të ndodhë që mund të vijë ajo ditë: "Edhe pse çmimi Nobel është arritja më e madhe e fushës tënde në realitet ai ka të bëjë me faktin të jesh në vendin e duhur, në kohën e duhur, me eksperimentin e duhur e të jesh edhe gjallë. Dhe ju e dini; ka mjaft fizikantë që e kanë marrë këtë çmim pasi ata kanë vdekur". Në fillim Shqipëria, pastaj Zvicra e aktualisht Amerika. Klejda i përket njerëzve të epokës së globalizmit, të shoqërisë së dijes.

WILLIAM GREGORY

William Gregory lindi në Lockport, Nju Jork, në një familje shqiptaro-amerikane dhe u pagëzua në kishën ortodokse shqiptare të Shën Elias. Paraardhësit e të cilit kanë emigruar nga Shqipëria në fillim të shekullit të kaluar. I zgjedhur nga NASA në janar 1990, Gregory u bë astronaut në korrik 1991. Detyrat teknike të Gregorit përfshinin: Laboratorin e Integritetit të Avionikës Shuttle (SAIL); Përfaqësuesi i zyrës së astronautëve për Landing/Rollout, T-38 Flying Safety; Personeli i Mbështetjes së Astronautëve të Qendrës Hapësinore Kennedy (ASP); komunikues i anijes kozmike (CAPCOM) në kontrollin e misionit; Përfaqësuesi i zyrës së astronautëve për operacione takimi dhe afërsie; dhe Shefi i Degës së Operacioneve të Anijeve Hapësinore. Ai fluturoi me STS-67 (1995) dhe ka 400 orë në hapësirë.

Gregory doli në pension nga Forcat Ajrore dhe u largua nga NASA në verën e vitit 1999. Ai shërbeu si Zëvendës President i Zhvillimit të Biznesit për Qwaltec, Inc. në Tempe, Arizona, dhe aktualisht është një pilot linja ajrore për një transportues mallrash me bazë në SHBA.

Gregory shërbeu si pilot STS-67 në misionin e kërkimit astronomik me shtatë persona në bordin e "Space Shuttle Endeavour". Duke u nisur nga "Qendra



Hapësinore Kennedy", më 2 mars 1995 dhe duke u ulur në "Edwards" AFB më 18 mars 1995, ekuipazhi vendosi një rekord të ri të kohëzgjatjes së misionit prej 16 ditësh, 15 orë, 8 minuta dhe 46 sekonda, ndërsa përfundoi 262 orbita dhe udhëtoi gati shtatë milionë milje.

MIREL SHARRËXHI

Shkencëtari nga Shqipëria ka lindur më 28 mars 1967 në qytetin e Korçës. Ka mbaruar shkollën e mesme për teknologji-kimike në qytetin e Elbasanit dhe më pas studimet e larta në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degën Kimi Industriale. Gjatë viteve të tranzicionit ai nuk mundi ta ushtronte profesionin në Shqipëri, pasi dihet situata e industrisë kimike. Në vitin 1997 emigron në SHBA. Fillon punë si kimist analitik në kompaninë "Emerson and Cumming". Në vitin 2000, profesor Oliver Peoples i ofron një punë të përkohshme në kompaninë e sapoformuar "Metabolix", me qendër në Cambridge, Massachusetts. Pas tre muajsh, duke parë përkushtimin e tij, ai i ofroi punë të përhershme si kimist analitik. Në vitin 2007 mbaron "Masterin" në degën e Kimisë në Universitetin e Massachusettsit dhe konsolidon pozitën si drejtues i grupit analitik në kompani. Një produkt që zëvendëson qeset plastike dhe një sërë nënproduktesh të naf-tës, si ndotësit më të mëdhenj të mjedisit, është "pagëzuar" me emrin e kimistit shqiptar, i cili është edhe shpikësi i tij. Kjo do të ketë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit, pasi çdo vit i gjithë planeti ndotet nga miliarda tonelata lëndë plastike.



BILAL GOLEMI

Mjek veterinar, mikrobiolog i shquar në fushën veterinare e mjekësore. Në Stamboll kreu shkëlqyeshëm studimet e larta në mjekësinë veterinare. U specializua për mikrobiologji në institutin "Paster" në Paris. Bashkëpunëtor i dy shkencëtarëve francezë me famë botërore Ramon e Dyma, ku shpalosi talentin e tij e duke marrë gradën Doktor i Shkencave në moshën 27-vjeçare. Më 1928 kthehet në Atdhe. Me emrin dhe veprën e tij janë të lidhur ngritja dhe organizimi i shërbimit veterinar, themelimi i të parit laborator bakteriologjik veterinar, importimi i racave të kafshëve, ngritja e të parave stacione shkencore të përmirësimit racor. Prodhimi për herë të parë në vend i vaksinave kundër disa sëmundjeve të bagëtive. Ai ishte sa shkencëtar aq edhe njeri i thjeshtë, i dashur, patriot e përparimtar, që gëzonte simpati e dashuri të jashtëzakonshme nga njerëzit



brenda e jashtë vendit. Shkon në Turqi, ku e prisnin me padurim institucionet shkencore. Më 1952 emërohet sekretar i përgjithshëm i Institutit Qendror Veterinar në Ankara, po këtë vit zgjidhet ekspert i Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetësisë (OMS). Studimet e tij patën jehonë të madhe në Europë e Botë. Më 1952, për studimet e tij shkencore në mikrobiologjinë veterinare, qeveria franceze e dekoroi me medaljen "Legion d'honneur - Merite agricole". Kreu mbi 50 studime e kërkime shkencore, mori pjesë në studime e ekspozita ndërkombëtare, bashkëpunoi me shumë institute nga të gjitha anët e botës, duke u bërë kështu një figurë e shquar në forumet ndërkombëtare të shëndetësisë. Më 15 mars të vitit 1955, pushoi zemra e këtij shkencëtari të shquar e atdhetari të madh, në moshën më të pjekur e më produktive.

Në nderim të veprës së tij Institutit të Studimeve Veterinare të Shqipërisë iu dha emri "Institut Dr. Bilal Golemi".

ESI DOMI

E reja shqiptare që punon në një nga institutet kërkimore prestigjioze në Suedi, ka marrë Çmimin Ndërkombëtar si Kërkuese e re në Neuroshkencë, çmim ky që jepet në mbështetje të shkencëtarëve të rinj.

Ajo është me prejardhje nga Elbasani, ndërsa është doktorante në Universitetin Spitalor të Linköping-ut në Suedi. Kërkuese Shkencore (RTDa) në Universitetin e Camerino-s, Itali.

Në vitin 2006 deri 2011 studioi për Farmaci (Farmakologji); Nga viti 2011 deri 2015 u arsimua në Shkenca Farmaceutike, në Universitetin e Camerino-s, Camerino, Marche, Itali.



DETINA DHE ARGITA ZALLI

Dy motra binjake nga Patosi i Fierit, që u larguan nga Shqipëria fare të vogla, sot janë doktore shkencash, njëra në Universitetin Harvard të Bostonit, tjetra në Kolegjin Universitar të Londrës, ku japin leksione dhe merren me kërkime shkencore.

Ato emigruan drejt Mbretërisë së Bashkuar në vitin 1999. Argita në fushën e Imunologjisë dhe Detina në fushën e Biologjisë Molekulare, që jetojnë e para në Londër dhe tjetra në Boston, ku, para dy vitesh, u pranua në Harvard duke u bërë post-doktorantja dhe pedagogia më e re e këtij universiteti.

Detina përveçse e angazhuar me kërkimet shkencore është edhe pedagoge e lëndës Facial Anatomy Development and Genetics, ndërkohë që Argita merret me kërkimet e fushës së saj të imunologjisë në Londër dhe pret që të ketë edhe ajo një lëndë të sajën, një arritje jo e vogël, në universitetet angleze, ku të tilla mundësi janë shumë të kufizuara.



Udhëtim nëpër SHQIPËRI

Në vitin 1990 popullsia e Shqipërisë shtrihej 70 për qind në fshat dhe 30 për qind në qytet dhe vendi ynë ishte gati një fshat i madh. Megjithatë edhe pse shifrat ishin kokëforte, Shqipëria numëronte 66 qytete. Një paradoks, në një Shqipëri me 3 milionë banorë dhe me raport skandaloz mes qytetit dhe fshatit. Në fakt qytetet që ishin zyrtarë të tillë linin shumë për të dëshiruar, si në infrastrukturë dhe shtrirje gjeografike.

Sot, me një transformim rrënjësor, qytetet shqiptare janë kthyer në atraksion turistik për vendas dhe të huaj.

TIRANË

Origjina e emrit: (Katër variantet) "Tiranë" mendohet se vjen nga fjala "Theranda", e përmendur në burimet e lashta greke dhe latine, që vendasit e quanin Te Ranat, meqë fusha ishte formuar si rezultat i materialeve të ngurta që sillnin ujrë nga malet përreth. "Tirana" vjen nga "Tirkan". Tirkan ka qenë një kështjellë në shpat të Malit të Dajtit. Edhe sot e kësaj dite ekzistojnë rrënojat e kësaj kështjelle të lashtë që daton në fillimin e shekullit I para Krishtit. Kjo mendohet të ketë qenë kështjella që historiani bizantin Prokop, (shek.VI), e quan Kështjella e Tirkanit.


Emri "Tirana" vjen nga greqishtja e vjetër, "Tyros" që do të thotë bulmet. Mendohet se ky variant ka mbetur ngaqë në fushën e Tiranës bëhej tregtimi i bulmetrave nga barinjët e zonave përreth.

Emri **Tiranë** vjen nga **Teheran**, kryeqytet i Iranit, në kujtim të një fitoreje të korrur nga Sulejman Pasha, (themeluesi i qytetit) në krye të ushtrisë turke gjatë fushatës në Persi.

Me siguri dihet që për herë të parë emri i Tiranës përmendet në vitin 1418 në një dokument të Venedikut.

Themeluar: në 1614 nga Sulejman Pashë Bargjini.

Gjurmët më të vjetra: Tirana u themelua si qytet më 1614, por toka mbi të cilën u ndërtua ka gjurmë më të hershme banimi. Nga faktet e gjetura në rrënojat e një kështjelle ka mundësi të bëhet fjalë mbi një kështjellë të cilën Prokopi von Cae-



sarea në shekullin e gjashtë e ka quajtur "Tirkan".

Shpallet kryeqytet më 20 shkurt 1920.

Objektet kryesore: Të gjitha institucionet shtetërore më të rëndësishme të shtetit, Kështjella e Petrelës, Kalaja e Pezës, Xhamia e Ethem Beut në qendër të Tiranës, Muzeu Kombëtar, Muzeu Arkeologjik, Galeria e Arteve.

DURRËS

Origjina e emrit: Durrachium

Emra të mëparshëm: Epidamus

Themeluar: në vitin 627 para Lindjes së Krishtit.

Pushtuar: në 314 para Krishtit nga Aleksandri i Maqedonisë dhe në vitin 229 para Krishtit ai u pushtua nga romakët, më pas nga otomanët, serbët dhe italianët.

Objekte kryesore: Amfiteatri, Forumi bizantin, Muzeu Arkeologjik ku janë të paraqitura periudhat greke dhe romake, Torra Veneciane, Xhamia e Fatihut, Monumenti i Rezistencës, Muzeu Etnografik etj.

Karakteristika:

-Durrësi mund të krahasohet me qytetet më të mëdha të Mesdheut të lashtë dhe mesjetar. Qyteti Durrach u ndërtua nga ilirët taulantë,

dallëndyshasit në shekujt XIII-XI para Krishtit, Banorët e parë të Durrachut, para ilirëve të quajtur protoilir, pellazgë, ngritën në rrethinat e këtij qyteti, vendbanimet e para parahistorike.

-Në afërsi të Shkëmbit të Kavajës është zhvilluar beteja e famshme mes Çezarit dhe Pompeut.

-Në vitin 1200, pas një cunami, qyteti nuk është banuar për 6 vjet.

-Ka qenë kryeqytet.

-Ka portin më të madh në Shqipëri.

LEZHË

Origjina e emrit: Lisus

Themeluar: 669 para Lindjes së Krishtit

Në vitin 1300 ndërtohet kalaja e qytetit

Deri në vitin 1398 qyteti ishte në dorë të familjes feudale të Dukagjinasve, të cilët më pas ia lëshuan Venedikut.

Ngjarje kombëtare: Më 2 Mars 1444, u mbledh "Kuvendi i Lezhës" nën drejtimin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Kuvendi formoi një lidhje politike-ushtarake të princërve shqiptarë, duke formuar një ushtri shqiptare prej 10 mijë trupash kundër rrezikut osman.

KORÇË

Origjina e emrit: Gjoriçë, Goriçë. (Por edhe sot asnjë studiues nuk ka një ide të qartë se nga vjen emri i qytetit të Korçës).

Gjurmët e vjetra: Zona e Korçës e ndodhur në kufi me Mbretërinë Ilire dhe Epirin është banuar që nga mi-
jëvjeçari i katërt p.e.s.

Themelimi: Qyteti modern i Korçës u formua në shekullin XV kur Iljaz Bej Mirahorie zhvilloi Korçën sipas urdhrit të Sulltan Mehmeti II. Nën pushtimin osman Korça me emrin "Göricë" ishte sanxhak i vilajetit të Manastirit.

Data me rëndësi kombëtare: Është hapur shkolla e parë shqipe në këtë qytet që daton në vitin 1887, shkolla e parë në Shqipëri për vajza, si dhe liceu Francez i ndërtuar në vitin 1917.

VLORË

Origjina e emrit: Aulona

Gjurmët më të hershme: Shekulli i 6-të para lindjes së Krishtit. Duke qenë një nyje e rrugëve tokësore e detare, i njohur për verën, ullinjë e kripën, u bë porti kryesor i Ilirisë pas rënies së Apolonisë e Orikumit.

Data me rëndësi kombëtare: Më 28 Nëntor 1912 u shpall Pavarësia e Shqipërisë, Lufta e Vlorës, 1920.

Pushtuar: nga normanët më 1081, 1205 nga Venediku, më pas nën sundimin e Hohenshtaufëve gjermanë dhe më 1272 në mbretërinë e Arbërisë. U pushtua nga osmanët më 1417, italianët, gjermanët.

Objektet kryesore: Kalaja, porti, etj.

ELBASAN

Origjina e emrit: Në shekullin e 2-të para Krishtit njihej me emrin Skampa dhe më vonë Skampini. Elbasani u themelua nga Sulltan Mehmeti II në shekullin XV. Iu vu ky emër sepse ishte një ndër trevat e para të pushtuara nga osmanët, ELI-BASAM (vura dorë).

Themeluar: nga osmanët në shekullin e 15-të

Ndërtimi i kalasë së qytetit: më 1466 për 25 ditë dhe për të punuan 150 mijë njerëz.

Gjurmët më të hershme: Historia e trevave të Elbasanit e ka zanafillën e saj në shekullin II p.e.s. me vendbanimet e hershme ilire. Nga të dhënat arkeologjike besohet se emri i parë i Elbasanit ka qenë Mansius që do të thotë vend-qëndrim.

Data me rëndësi kombëtare: Më 2-9 shtator 1909 u thirr Kongresi i Elbasanit, ndër vendimet më kryesore të të cilit qe hapja e Shkollës

Normale.

Pushtuar nga: romakët, turqit, italianët e gjermanët.

Objektet kryesore: Kalaja, banjat turke, stadiumin "Elbasan Arena".

GJIROKASTËR

Origjina e emrit: Qyteti e ka marrë emrin sipas fjalës greke argjend, Argyrokastron, që lidhet me ngjyrën e përhimë të mureve, rrugëve dhe çative prej guri, të cilat vezullojnë si argjend kur lagen nga shiu. Një shpjegim tjetër lidhet me emrin e një fisi vendas që jetonte pranë Gjirokastrës: Argjirët. Për herë të parë emri i Gjirokastrës përmendet në shekullin XIII. Kështjella e Gjirokastrës mendohet të jetë filluar nga prijësi shqiptar Gjin Bue Shpata, i cili i dha dhe emrin qytetit, Gjirokastrë. Zgjerimet e kështjellës janë bërë nga Ali Pashë Tepelena, dhe nga qeveria e Zogut, e cila më pas e konvertoi pjesën veriore të kalasë në burg.

Objektet kryesore: Në Gjirokastrë gjendet kalaja më e madhe e Shqipërisë. Aty mund të vizitoni Muzeun e Armëve, i cili gjendet brenda në kala, Muzeun Etnografik, i cili gjendet në shtëpinë ku ka lindur ish-diktatori komunist Enver Hoxha si dhe muzeun e ri në shtëpinë e shkrimtarit me famë botërore, Ismail Kadare.

1963: Shpallet Qytet-Muze.

2005: Shpallet Pasuri Botërore nga UNESCO.

BERAT

Origjina: Berati u përket qyteteve të rrallë ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë deri më sot. Dy çekanë guri e dajtojnë fillimin e jetës në të, para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P.Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek. VII-VI P.Kr. Këtu është zhvilluar një vendbanim para-qytetar, me punishtet e tij të qeramiks dhe me një jetë shoqërore të diferencuar. Në kufijtë e legjendës dhe të historisë, ky vendbanim thuhet të ketë qenë Orestia dhe lashtë, i quajtur kështu ngaqë aty banonin një fis i pellazgëve, orestët, i pari i të cilëve ishte Orestis, i biri i Agamemnonit.

Themelimi: 313-310 para Krishtit si qytet-kështjellë i Dasaretisë, i quajtur Antipatrea.

Emrat që ka përdorur: Antipatrea, Albanorum Oppidum, Pulheriopolis.

Gjurmët e para: 2600 para Krishtit.

Pushtuar nga: grekët, maqedonasit, bullgarët, osmanët,

1961: Shpallet Qytet Muze.

2008: Shpallet Pasuri Botërore nga UNESCO

Objektet kryesore: I gjithë qyteti, Kalaja, Ura e Goricës, etj.

SHKODËR

"Një njeriu të zakonshëm, të ardhur nga qyteti ortodoks i Manastirit, Shkodra i duket fillimi i Europës" – Ismail Kadare.

Origjinë e emrit: Skodrin, ose vendi ku shkon Drini, Skutari.

Themelimi: Mes shekullit të 5-të dhe 6-të para Krishtit.

Gjurmët e vjetra: Paleoliti (guri i vjetër), Neoliti.

Ka qenë kryeqytet i mbretërisë ilire në 181 Para Krishtit.

Pushtuar: Në vitin 168 nga Roma, sllavët, bullgarët, Venediku, turqit, serbët, malazezët, italianët, gjermanët.

Objektet kryesore: Kalaja e Rozafës, Muzeu Historik, Fototeka Marubi, etj.

KAMZA

Deri në vitin 1990: Një qendër e banuar e Ndërmarrjes Bujqësore të Tiranës

Pas vitit 1990: Popullohet me të ardhur nga qytete dhe fshatra të ndryshëm.

Sot: Një nga bashkitë dhe qytetet me dendësinë më të madhe në vend.

Karakteristikë: Një zonë periferike e Tiranës që pret të sistemohet falë një plani urbanistik.

KONISPOL

Qytet i ndërtuar si fillim për të rinjtë aksionistë që hapën tarraca për agrume.

Fillimet: Në vitet '70.

Karakteristikë: Kultivimi i agrumeve dhe zonë plazhi.

KSAMIL

U ngrit si qytezë bregdetare gjatë periudhës komuniste. Në nëntor 1966 Enver Hoxha porositi që në këtë vend të bukur dhe të virgjër të ngrihej një qendër e prodhimit të agrumeve dhe ullirit. Kështu "lindi" Ksamili, vetëm 5 km larg Butrintit, përballë ishujve piktoreskë, në gadishullin e Heksamilit, (gjashtë milje nga Butrinti). Peizazhit të bukur të detit dhe kodrave i shtohen dy ngjyrat jetësore, e kaltra dhe e blerta, që e hijeshojnë edhe më tepër gjirin e Ksamilit, i cili ndodhet pothuaj përballë ishullit më të madh të Jonit, Korfuzit.

KRASTË

Qytet i ri minatorësh në rrethin e Matit. Ka qenë pjesë e fshatit Gjon të Martaneshit. Ndërtimi filloi më 1970 me ngritjen e minierës së Kromit në Batër. Më 1974 u vendosën banorët e parë. Më 1979 u shpall qytet.

Në rrugën e një tradite

Shkodra, qytet i skajit verior të vendit, buzë liqenit të gjerë me të njëjtin emër, do afirmohej në shek. XX si kryeqyteti i fotografisë shqiptare. Këtu punuan pararendësit Pjetër Marubi (1834-1904), Kel Marubi (1870-1940), Kolë Idromeno (1860-1939). Shan Pici (1904-1976) është një nga emrat më të shquar të pasardhësve, i cili mësoi pranë Kel Marubit. Pas disa vitesh punë përgatitore, Shan Pici shkrepri fotografinë e parë në studion e mjeshtrit të vet. Ishte 18 vjeç. Dy vjet më vonë, më 1924, hapi studion e tij me emrin "Peci". Si ndihmës kishte të vëllezërit, Ndrek dhe Tefë. Ndonëse realizonte portrete në studio dhe momente nga jeta e përditshme në Shkodër, ai interesohej veçanërisht për mënyrën e fotografimit të sporteve dhe të sportistëve. Kryesisht, ai do të zhvillonte një shije të posaçme për peizazhet e rrethinave dhe për jetën e vështirë të malësorëve. Në veri të Shkodrës, vëmendjen ia tërhiqnin krahina e Dukagjinit dhe bukuria e egër e bjeshkëve shqiptare. Duke ndjekur rrugën e më të moshuarve, ai dokumentoi jetën e Shkodrës gjatë viteve 1930, të familjeve të qytetit që vinin të pozonin bashkë me fëmijët e tyre. Ai botoi kartolina të shumta, të cilat i shpërndante përmes librarisë shkodrane Nikshiqi.

Në vitin 1949 fotografët do ta humbin pavarësinë. Pici u përpoq ta vijonte veprimtarinë e tij në bashkimet e kooperativave shtetërore, por me kushtëzime të një natyre tjetër. Pikërisht në këtë vit, 1949, fotografët shkodranë u përjetësuan së bashku përpara objektivit dhe janë rreth Gegë Marubit, Shan Pici me Dedë Jakovën, brezi i mëvonshëm Pjetër Raboshta e Angjelin Nënshati. Koleksionet e negativave të këtyre pesë fotografëve ruhen sot në fototekën Marubi të Shkodrës. Shan Peci doli në pension në vitin 1962. Nikolin Pici, i biri i Shanit ka ndjekur gjurmët e babait të tij.



Nikolin Pici, gjurmë në fotografinë ushtarake shqiptare

Rruga drejt fotografisë

Mjeshtri i fotografisë Nikolin Pici lindi në Shkodër, më 24 tetor 1940. Familja Pici kishte traditë familjare, sepse i përkiste brezit të fotografëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shek. XX. Nikolini duke qenë djali i fotografit të njohur shkodran Shan Picit, e mësoi artin e fotografisë nga babai në moshën 14 vjeç. Nikolin Pici u bë pjesë e familjes së madhe të fotografëve shkodranë dhe bëri emër në studion fotografike "Pici". U rrit, mësoi dhe u edukua në odën e burrave të shquar shkodranë, që quhej "Oda e territ". Prej kësaj ode dolën në dritë imazhe të fiksuara me personazhe nga më të ndryshmet të njerëzve të thjeshtë shqiptarë. Kur fëmijët, për vetë moshën e tyre, luanin në lagje dhe në ambiente të tjera futboll, Nikolini mori leksionet e para të fotografisë bardh e zi pranë babait të tij.

Dhoma e errët e laboratorit bënte

pjesë në programin ditor të Nikolinit fëmijë. Ishin leksionet e para të fotografisë bardh e zi, puna e përditshme me babanë për të fotografuar njerëz në studio dhe në terren në realizimin e peizazheve të ndryshme në natyrë. Puna e kujdesshme e babait krijoi pasionin për fotografinë tek Nikolini djalosh, duke ruajtur në jetë dhuntinë prej artisti.

Fotografoi për vite ushtinë shqiptare

Nikolin Pici pasi përfundoi akademinë shkodrane për foto, një ditë u bë pjesë e grupit të fotografëve të Laboratorit Fotografik Qendror të Ushtrisë Shqiptare. Në këtë grup bënë pjesë fotografë të tjerë të shquar si Petrit Ristani, Agron Kruti, Kosta Bej, Bujar dhe Alma Duka, të cilët kishin mësuar nga nxënësi i Gegë Marubit të madh, Rrok Berisha.

Misioni i tyre ishte që të doku-

mentonin veprimtarinë e stërvitjeve dhe të jetës në repartet e Ushtrisë Shqiptare. Ky staf fotografësh dhe laborantësh u bë pjesë e Laboratorit Qendror Fotografik të Ushtrisë Popullore. Ata lanë monument "Ditarin fotografik" të ushtrisë shqiptare të pas Luftës së Dytë Botërore, jetën intensive të saj, mësimet treguese, stërvitjet, qitjet luftarake, edukimin dhe mësimin e një ushtrie që stërvitej për mbrojtjen e vendit, paradat ushtarake dhe mjaft portrete të ushtarakëve shqiptarë.

Nikolini u bë pjesë e këtij stafi që në moshën 18-vjeçare. Në vitet 1959-1961, Pici ishte ushtarak-fotograf dhe realizoi fotografitë e para dokumentare të ushtrisë popullore dhe pas 9 vjetësh (1961-1970) punë intensive me aparatën e tij, duke dhënë prova të mëdha artistike, kaloi fotograf i revistës ushtarake "10 Korriku" e cila ishte e ilustruar (1970-1990). Gjatë viteve 1983-1990, Nikolini vazhdoi punën në Laboratorin Fotografik të Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me mjeshttrin tjetër të fotografisë, Alqi Golloshi. Të dy së bashku mbuluan shërbimin fotografik të gazetës "Luftëtari". Nikolin Pici shërbeu në Forcat e Armatosura të Shqipërisë për 31 vite. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm janë krenarë me emrin e tij, të brezave të fotografëve që shërbyen me përkushtim dhe lanë të dokumentuar në foto vetë jetën dhe moshën e ushtrisë. Ai kujtohet me respekt dhe nga Ministria e Kulturës e Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë, ku Nikolini punoi në vitet 1990-2000. Emrin Nikolin Pici e gjen në mjaft botime të rëndësishme të ushtrisë shqiptare dhe të historisë së arteve pamore në Shqipëri.

Dokumentoi stërvitjet e ushtrisë

Pas kryerjes të shërbimit ushtarak në vitin 1961 u bë pjesë e stafit profesionist të Laboratorit Qendror Fotografik të Ministrisë së Mbrojtjes. Në arkivin e laboratorit fotot e Nikolin Picit zënë një vend të rëndësishëm. Në mijëra fotot negativ e diapozitiv të dokumentuar shikon syrin e një

profesionisti dhe fotografi serioz. Nëpërmjet fotove të tij, gjen imazhe nga stërvitjet e strukturave të ndryshme të Forcave të Armatosura shqiptare, veprimtari kulturore e artistike, gjendet gjithë jeta ushtarake. Në brendësi të kuadratit të dokumentimit fotografik dhe të orientit të saktë ushtarak, fotografi, mjeshtër Pici ka gjetur hapësira dhe këndvështrimeve të spikatura dhe ka sjellë emocione realiste. Në fotografitë e tij gjenden portrete ushtarësh, marinarësh e pilotësh në detyra luftarake, në stërvitje dhe në kohën e lirë. Të gjitha fotot e tij pasqyrojnë mjaft bukur energjitë, vullmin, entuziazmin, burrërinë dhe bukurinë ushtarake e njerëzore.

Pici, gjatë punës në sektorin e botimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, ka realizuar dhe vepra të tjera fotografike në gjininë e peizazhit dhe portretit. Tradita familjare e lëvrimin të fotografisë bardh e zi, ka lënë gjurmë tek Nikolin Pici. Ai arriti që me mjaft kujdes të kërkonte dhe të gjente bukurinë e "lojës" së dritë-hijes në natyrë. Në fotot peizazh të Nikolin Picit brenda tyre gjen magjinë e "të veçantës" fotografike, si bukurinë, delikatesën e imazhit dhe emocionet që të përcjell. Duke ruajtur me kujdes "talentin" në fotografitë klasike, ai kërkoi dhe solli me objektivin e tij bukurinë artistike të detajit, dhe duke i dhënë fotografisë emocione në përsosmëri.

Në shërbimet e shpeshta dhe në vende nga më të bukurat, të largëtat, ku ishin vendosur repartet ushtarake shqiptare, Pici ka fiksuar, përveç imazheve të ushtarakëve të veçantë, të gërshetuar edhe me magjinë e bukurisë të natyrës shqiptare. Veprat fotografike të Nikolin Picit kanë brenda tyre qetësi dhe dritë që jep në bukurinë e imazhit të fiksuar.

Edhe sot imazhet në fotot e Nikolin Picit iu ngjajnë sekuencave të filmave amerikanë në luftën në Kore dhe në Vietnam. Momenti që përcjellin të ndaluar në kohë, emocionet që ndjen kur shikon foton prej letre në bardhezi. Këto janë foto, janë imazhe të bëra në stërvitjet dhe mësimet treguese të strukturave të ndryshme të Forcave të Armatosura shqiptare, janë

portrete të ushtarakëve këmbësorë, pilotë, marinarë, tankistë, artiljerë, xhenierë etj.

Pas la gjurmë të historisë së ushtrisë

Mjeshtri Nikolin Pici është pjesë e grupit fotografik klasik shqiptar të viteve 1960-1990. U formua në studion e babait dhe ruajti me fanatizëm traditën e mjeshtërve të fotografisë shqiptare të tillë si: Marubi, Radovani, Ristani. Jakova, Nënshati, Golloshi, Kallfa, Veseli. Ai ka qenë mik, shok dhe koleg me Alqi Golloshin, Petrit Kumin, Refik Veselin, Petrit Kumin, Besim Fushën dhe Leon Çikën.

Fotografitë e tij, gjithashtu, ishin pjesë e mediave të kohës si revista "Ylli", "Shqiptarja e re", "Shqipëria sot" etj. Në vitin 1982, hapi ekspozitën e tij me 130 vepra fotografike me temë nga ushtria shqiptare. Si fotograf i Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë dha një kontribut në përvojën me dokumentimin e veprimtarive artistike dhe në botimet e galerisë si në katalogët "Ikona Shqiptare" (2001), "Monografi", "Thoma Thoma", (1997), revista "Pamorart" etj.

Ylli Drishti studiues dhe kurator arti ka theksuar se Nikolin Pici me fotografitë e tij ka kontribuar në albumet e botuara nga Ministria e Mbrojtjes deri në vitet 1990 dhe më tej në botime të tjera të veçanta për artin ikonografik.

Foto të tij në botime janë albumet "25 vjet Ushtri Popullore", "Marshon Shqipëria Socialiste", "Ushtria Popullore në artet figurative", "Ikona Shqiptare" (2001) dhe "Ikona bizantine dhe pas bizantine në Shqipëri" (2007) me autor Yll Drishtin.

Artistët e fotografisë shqiptare gjejnë tek vepra e Nikolin Picit trashëgiminë e pasur dhe shumë planëshe. Fotografia shqiptare ka fiksuar në memorien e saj fotografin e pasionuar dhe qytetarin korrekt Nikolin Pici, i cili është pjesë e historisë së plejadës së mjeshtërve të fotografisë shqiptare të shek. XX. Mjeshtri i fotografisë ushtarake Nikolin Pici edhe sot është figurë shembullore e njeriut të kompletuar.



“MIQËSI NËPËRMJET SPORTIT” (FRIENDSHIP THROUGH SPORT)

KAMPIONATI I FUTBOLLIT NË FORCAT E ARMATOSURA, 2022

Forca Tokësore fiton kupën e kampionatit të futbollit në FARSH

Në mjediset e Garnizonit “Skënderbej”, në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia përfundimtare e Kampionatit të Futbollit të Forcave të Armatosura për vitin 2022, në të cilën morën pjesë tetë ekipet më të mira të futbollit në FA, duke filluar nga Forca Tokësore, Forca Ajrore, Forca Detare, Akademia e Forcave të Armatosura, Komanda Logjistike, ASNI, Policia Ushtarake dhe AISM.